



ASKUND TË MIRËPRITUR

NDALONI KTHIMIN ME FORCË
TË ROMËVE NË KOSOVË

AMNESTY
INTERNATIONAL



Amnesty International është një lëvizje globale prej 2,8 milion përkrahësish në më shumë se 150 vende dhe territore të botës, të cilët zhvillojnë fushata për t'i dhënë fund abuzimeve të rënda të të drejtave të njeriut.

Vizioni ynë është që gjithsecili të gëzojë të gjitha të drejtat e mbrojtura nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe standarde të tjera të të drejtave të njeriut.

Ne jemi një organizatë e pavarur nga çdo lloj qeverie, ideologjie politike, interesi ekonomik apo besimi fetar – dhe mbështetemi financiarisht kryesisht nga anëtarësimet dhe donacionet publike.

**AMNESTY
INTERNATIONAL**



Botime të Amnesty International

Botuar për herë të parë në vitin 2010 nga
Amnesty International Publications
International Secretariat
Peter Benenson House
1 Easton Street
London WC1X 0DW
United Kingdom
www.amnesty.org

© Amnesty International Publications 2010

Indeksi: EUR 70/011/2010 Albanian
Gjuha origjinale: Anglisht
Printuar nga Amnesty International,
Sekretariati Ndërkombëtar, Mbretëria e Bashkuar

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Ky botim mbrohet nga e drejta e autorit, por mund të riprodhohet në çdo lloj mënyre, pa asnjë lloj tarife, për qëllime avokacie, fushatash apo mësimdhënieje, por jo për rishitje.

Mbajtësit e së drejtës së autorit kërkojnë që çdo përdorim i tillë të regjistrohet tek ta, për qëllime të vlerësimit të ndikimit të tij. Për ta kopjuar në rrethana të tjera, ose për ta ripërdorur në botime të tjera, ose për ta përkthyer a përshtatur, duhet marrë paraprakisht leje me shkrim nga botuesit dhe mund të aplikohet një tarifë.

Foto e kopertinës: Një djalë rom luan në një shtëpi të pabanuar në fshatin Plementinë në Kosovë, 2009. Disa romë i kanë kthyer në këtë komunitet nga Gjermania. *Kopertina e pasme sipër:* Romë të kthyer me forcë në Kosovë nga Gjermania, pranverë 2010. Kur arrijnë në Kosovë ata shpesh nuk sjellin gjë tjetër veç teshave të trupit.

Poshtë: Romë të kthyer me forcë në Kosovë nga Gjermania në aeroportin e Prishtinës, pranverë 2010.

Fotot: © CharlotteBohl/Romawood 2010

PËRMBAJTJA

1.	Hyrje	3
2.	Pak sfond.....	6
3.	Nevojat për mbrojtje ndërkombëtare.....	8
3.1	Dhunë ndër-etnike në vazhdimësi	12
4.	Kthimi dhe riintegrimi	16
4.1	Kthimi vullnetar dhe i detyruar	16
4.2	Strategjia për riintegrimin e personave të riatdhesuar.....	20
5.	Mos-sigurimi i kushteve për kthimin dhe riintegrimin e qëndrueshëm të pakicave	25
5.1	Diskriminim i përhapur dhe sistematik	26
5.2	Dokumentacioni: e drejta për një identitet ligjor	29
5.3	Rreziku i mbetjes pa shtetësi	31
5.4	E drejta për arsim	34
5.5	E drejta për kujdes shëndetësor	36
5.6	E drejta për banim të përshtatshëm	39
5.7	E drejta për punësim	43
5.8	Kthime të qëndrueshme?	45
6.	Kritika ndërkombëtare	47
7.	Kosova dhe BE-ja	51
7.1	Marrëveshjet e ripranimit	52
8.	Kthimet e detyruara në Serbi	60
9.	Përfundime dhe rekomandime	63

1. HYRJE

“I bëj thirrje urgjentisht BE-së që të ndalojë deportimin”, thotë Shefketi; “Ata që duan të kthehen më mirë të hidhen prej katit të dhjetë poshtë”, shprehet F.B.; “Ne po vuajmë këtu dhe nuk duam të vuajmë edhe të tjerët”, thotë Nazrim Stola.¹

“Policia erdhi pa asnjë paralajmërim rreth orës 3.30 të mëngjesit. Familja hapi derën. Aty përçark kishte pesë policë. Më vunë prangat, më hipën në një automjet dhe më çuan në aeroportin e Baden Baden-it. Më kanë marrë ashtu siç isha – më vonë ONM-ja (Organizata Ndërkombëtare e Migrimit) më dha 300 euro. Në kufirin ndërkombëtar në aeroport më regjistruan, më dhanë 50 euro, dhe më çuan në një hotel për dy ditë.” Irfani, një burrë rom i deportuar me forcë nga Gjermania në maj 2010; familja e tij, përfshirë edhe bashkëshortja, vazhdojnë të jenë në Gjermani.

“Kthimi nuk është thjesht një akt teknik administrativ. Ai do të thotë që njerëzit, ndër ta edhe familjet, që kthehen, të priten dhe të riintegrohen me dinjtet dhe siguri. I bëj thirrje autoriteteve gjermane që të ndalojnë çdo kthim tjetër të detyruar në Kosovë, sidomos të romëve, për sa kohë që gjendja e atjeshme nuk garanton një jetë të sigurt dhe të qëndrueshme për personat e kthyer.” Thomas Hammarberg, Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, 15 Dhjetor 2009.

Amnesty International është e shqetësuar për kthimet e detyruara të pjesëtarëve të komuniteteve të pakicave në Kosovë nga Evropa Perëndimore.² Organizata beson se romët, ashkalinjtë, egjiptasit dhe serbët (dhe shqiptarët që kthehen në situata ku ata përbëjnë pakicë) mund të jenë të rrezikuar nga persekutimi ose lëndimi serioz. Nën dritën e kësaj, Amnesty International gjykon se kthimi i tyre i detyruar mund të shkelë parimin e *moskthimit mbrapsht (non-refoulement)*.³

Këto kthime të detyruara po kryhen mbi bazën e marrëveshjeve dypalëshe të ripranimit, të nënshkruara midis autoriteteve të Kosovës dhe vendeve anëtare të Bashkimit Evropian (BE) dhe Zvicrës. Gati 10 000 romë janë të rrezikuar të kthehen me forcë në Kosovë vetëm nga Gjermania.

¹ Intervista të Amnesty International romë dhe ashkali të kthyer, Kosovë, qershor 2010.

² Në përkthimin e këtij raporti në shqipe, Amnesty International përdor emrin Kosovë/Kosova, siç përdoret nga shqiptarët. Në anglishte, dhe në praktikën e Kombeve të Bashkuara përdoret termi “Kosovo”. Toponimet janë dhënë në shqipe dhe në serbishte.

³ Parimi i moskthimit mbrapsht (*non-refoulement*) ndalon dëbimin, heqjen, ekstradimin, deportimin ose çdo kthim tjetër të një personi në çfarëdo mënyre, në një vend ose territor ku ai ose ajo përballet me një rrezik real persekutimi ose lëndimi fizik. Ky parim përvijohet në Konventën e vitit 1951, që lidhet me Statusin e Refugjatëve (Konventa e KB-së) dhe në shumë instrumente të tjera ndërkombëtare. Përveç kësaj, parimi i moskthimit konsiderohet gjerësisht si një normë e së drejtës ndërkombëtare në përgjithësi.

Amnesty International mendon se në Kosovë nuk ekzistojnë ende kushtet për kthimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të pakicave, me gjithë masat që ka marrë kohët e fundit qeveria e Kosovës, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e kushteve për pritjen dhe riintegrimin e personave të kthyer. Ndryshimet që kanë ndodhur në terren në Kosovë, pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë në vitin 2008 nuk janë – për sa i takon komuniteteve të pakicave – as themelore e as të qëndrueshme. Po kështu, gjendja e tanishme, por edhe në periudhën afatgjatë, paraqitet e paqëndrueshme dhe e pasigurt.⁴ Amnesty International mendon se është e nevojshme të vazhdojë mbrojtja ndërkombëtare për persona si romët, ashkalinjtë, egjiptasit, serbët dhe shqiptarët (kur këta kthehen në situata ku përbëjnë pakicë).

Duke pasur parasysh se, sot për sot, pak vende e kanë shprehur publikisht se kanë ndërmend të kthejnë serbët në Kosovë, ky raport përqendrohet kryesisht në kthimin e detyruar të romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve, për të cilët Amnesty International ka shqetësimin e veçantë se mund të përballen me një rrezik të vërtetë persekutimi ose lëndimi serioz pasi të kthehen. Për më tepër, organizata është e brengosur se disa romë, ashkali dhe egjiptas përballen me një rrezik të vërtetë *de jure* dhe *de facto* të mbetjes pa shtetësi, duke e bërë rrezikun edhe më të shumëfishtë.

Amnesty International nxit shtetet të respektojnë parimin e *moskthimit mbrapsht*; ajo bën thirrje për vendosjen e një moratoriumi për kthime të tilla të detyruara; dhe kërkon vazhdimin e mbrojtjes ndërkombëtare për romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit,⁵ serbët dhe shqiptarët (aty ku këta kthehen në situata ku përbëjnë pakicë) dhe për individë të tjerë të rrezikuar që identifikohen në këtë raport.

Përveç kësaj Amnesty International rekomandon që pjesëtarët e këtyre grupeve të pakicave dhe individët e tjerë të rrezikuar, që mund të kenë të drejtën e mbrojtjes ndërkombëtare nga BE-ja, të kenë qasje në një procedurë të shpejtë, të drejtë dhe efektive, me të gjitha masat mbrojtëse procedurale, për të përcaktuar nëse kanë apo jo të drejtën për mbrojtje ndërkombëtare, përfshirë edhe statusin e refugjatit. Organizata është e brengosur se pa një përcaktim të individualizuar të statusit të tyre, shumë njerëz nga këto grupe mund të rrezikohen të kthehen mbrapsht (*refoulement*).

Më tej, Amnesty International mendon sot se autoritetet kosovare nuk kanë as burimet financiare, as kapacitetin, dhe as vullnetin politik të sigurojnë kthimin e qëndrueshëm dhe riintegrimin e komuniteteve të pakicave.

⁴Kosova shpalli pavarësi të njëanshme nga Serbia në shkurt të vitit 2008, dhe deri në 1 shtator 2010 ajo ishte njohur nga 69 vende anëtare të Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, ajo ende mbetet pjesë e Serbisë nën Rezolutën 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Në korrik të vitit 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, në mendimin e saj këshillues, vendosi se shpallja e pavarësisë nuk ishte e paligjshme sipas së drejtës ndërkombëtare.

⁵ Komuniteti rom zakonisht flet gjuhën serbe dhe jeton kryesisht në zonat dhe enklavat serbe, kurse ashkalinjtë në përgjithësi flasin shqip dhe jetojnë në zonat e banuara nga shqiptarët. Megjithatë, në praktikë, shumë komunitete përbëhen si nga romët ashtu edhe nga ashkalinjtë, ose nga persona që nuk e quajnë veten si pjesë të një grupi të caktuar. Shumë familje janë me origjinë të përzier. Popullata e egjiptasve, më e vogël në numër, e dallon veten si nga romët ashtu edhe nga ashkalinjtë.

Përveç nevojës së romëve dhe të tjerëve për mbrojtje të mëtutjeshme, organizata mendon se numri i atyre që mund të kthehen me detyrim nga vendet anëtare të BE-së dhe nga Zvicra, është tepër i madh për kapacitetet që disponojnë autoritetet kosovare për të siguruar kushtet e për kthimin dhe riintegrimin e qëndrueshëm të tyre.

Amnesty International mendon se, në qoftë se dhe për sa kohë që autoritetet e Kosovës nuk do të jenë në gjendje të sigurojnë mbrojtjen, respektimin, dhe plotësimin e të drejtave themelore të komuniteteve të pakicës pa diskriminim, kthimi dhe riintegrimi i tyre i qëndrueshëm nuk do të mund të realizohet.

2. PAK SFOND

Gjatë dhe pas luftës së Kosovës së vitit 1999, me mijëra njerëz të të gjitha kombësive e lëshuan Kosovën; shumë serbë e romë shkuan në Serbi, kurse të tjerë kërkuan mbrojtje ndërkombëtare në vendet anëtare të BE-së dhe të Këshillit të Evropës.⁶ Në mars 2004, serbë, romë dhe ashkali u detyruan përsëri ta lëshojnë Kosovën pas shpërthimit të dhunës ndër-etnike midis shqiptarëve dhe serbëve, e cila preku edhe shumë komunitete të romëve dhe ashkalinjve.⁷

Shumë prej atyre që e lëshuan Kosovën pas vitit 1999, në fillim u lejuan të qëndrojnë në vendet anëtare të BE-së mbi bazën e ligjeve kombëtare që u siguronin atyre një lloj mbrojtjeje të përkohshme.⁸

Përveç personave që e lëshuan Kosovën pas vitit 1999, shumë prej atyre që po i kthejnë me forcë, faktikisht e kishin lëshuar Kosovën në fillimet e viteve '90, kur shpërtheu lufta në

⁶ Në mars të vitit 1999, pas dështimit të bisedimeve ndërkombëtare për zgjidhjen e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë midis forcave serbe dhe shqiptarëve të Kosovës, NATO filloi një fushatë bombardimi kundër ish Republikës Federative të Jugosllavisë, që përfundoi më qershor 1999. Gjatë kësaj periudhe, më shumë se 677 000 persona me kombësi shqiptare u detyruan ta lëshojnë Kosovën, ose u zhvendosën brenda vendit, dhe u kthyen kur forcat serbe u larguan nga Kosova, në zbatim të Marrëveshjes së Kumanovës. Pas kthimit të shqiptarëve në Kosovë, shkeljet e të drejtave të njeriut të serbëve, romëve dhe të pjesëtarëve të grupeve të tjera etnike u përshkallëzuan. Shumë prej tyre u kidnapuan ose u vranë. Pjesa më e madhe e serbëve shkuan nëpër enklavat serbe ose në Serbi. Pjesëtarë të komunitetit shqiptar të Kosovës dogjën shtëpitë e romëve dhe i dëbuan me forcë komunitetet romë, të cilat i konsideronin si aleatë të serbëve. Me mijëra romë, ashkali, dhe egjiptas (RAE) e lëshuan Kosovën për të kërkuar mbrojtje nga persekutimi. Ata shkuan edhe në Serbi dhe në vendet e rajonit; të tjerë shkuan në vende të BE-së dhe në Zvicër. Gjatë sulmeve, disa qindra burra romë u kidnapuan nga njerëz të armatosur që mendohet se ishin pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Që prej asaj kohe, këta romë nuk janë parë më dhe shumica e autorëve të këtyre krimeve nuk kanë dalë ende para drejtësisë. Shih Amnesty International, *Burying the Past: Impunity for enforced disappearances and abductions in Kosovo* (Varrosja e së shkuarës: Pandëshkueshmëri për zhdukjet me forcë dhe rrëmbimet në Kosovë,) Indeks EUR 70/007/2009, qershor 2009.

⁷ Amnesty International: *Serbia dhe Montenegro (Kosovo/Kosova), The March Violence: KFOR and UNMIK's failure to protect the rights of the minority communities* (Serbia dhe Mali i Zi [Kosova], Dhuna e marsit: KFOR-i dhe UNMIKU nuk mbrojnë të drejtat e komuniteteve të pakicave), Indeks EUR 70/016/2004, korrik 2004, shih, për shembull, f. 14-18, 24.

⁸ Mbrojtja e Përkohshme (MP) u vendos nga shumë vende anëtare të BE-së në fillimin e viteve '90, si një lloj mbrojtjeje e përkohshme për personat që i iknin konflikteve të armatosura në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kroaci, dhe më vonë u zbatua edhe gjatë krizës së Kosovës. MP shpesh ofronte një lloj mbrojtjeje në shkallë grupi, si një alternativë ose zëvendësuese e së drejtës për të kërkuar azil përmes vendimeve individuale, siç kërkohet nga Konventa për Refugjatët e vitit 1951. Secila qeveri miratoi përkufizimin e vet të MP-së, ku përfshiheshin instrumentet, statuset e dhëna, standardet e mbrojtjes dhe qasjen në të drejtat themelore.

shtetin që më parë njihet si Republika Socialiste Federative e Kosovës (RSFJ). Të tjerë e kishin lëshuar Kosovën në vitet '80, së bashku me mijëra jugosllavë të tjerë nga zona me varfëri ekonomike, për të kërkuar punë në vendet e BE-së.

Pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë në shkurt 2008 (e cila u mbështet nga shumica e vendeve anëtare të BE-së), autoritetet kosovare janë vënë nën një trysni në rritje nga vendet e BE-së për të pranuar të kthyerit. Ndër ta nuk përfshihen personat të cilët e kishin fituar azilin më parë, por ata të cilëve iu refuzua kërkesa për azil sipas Konventës për Refugjatët të vitit 1951 dhe protokollit të saj të vitit 1967, dhe të cilët, për pasojë, autoritetet në vende të ndryshme anëtare të BE-së i konsiderojnë se nuk kanë të drejtë qëndrimi. Megjithatë, shumica e tyre janë persona nga Kosova, të cilëve u ishte dhënë një lloj mbrojtjeje ose leje qëndrimi i përkohshëm. Ky status i mbrojtjes së përkohshme, që individët e fituan mbi bazën e të qenit pjesëtarë të një grupi të caktuar, pa një analizë të rasteve të tyre individuale, tani po iu hiqet nga qeveritë pritëse, të cilat tani e konsiderojnë “të sigurt” kthimin e pjesëtarëve të këtyre grupeve të veçanta në Kosovë.

Amnesty International mendon se heqja pa dallim e statusit të mbrojtjes së përkohshme një grupi njerëzish (në këtë rast romët), pa vendosur masat e duhura mbrojtëse, mund t'u mohojë individëve që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare qasjen në një proces që vendos për nevojat e tyre individuale. Duke u nisur nga kushtet që ekzistojnë në Kosovë për romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit, si dhe për individë të tjerë të rrezikuar të përmendur në këtë raport, Amnesty International mendon se kthimi i tyre me detyrim në Kosovë, pa një mundësi të përshtatshme për të kundërshtuar largimin mbi bazat e mbrojtjes ndërkombëtare, mund të përbëjë kthim mbrapsht (*refoulement*).

3. NEVOJAT PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE

Në nëntor të vitit 2009, Agjencia për Refugjatët e KB-së (UNHCR) nxori vlerësimin më të fundit për nevojat për mbrojtje ndërkombëtare të personave nga Kosova sipas Konventës së vitit 1951 dhe Protokollit të saj të vitit 1967, si dhe në bazë të instrumenteve të tjera ndërkombëtare dhe rajonale që lidhen me to.⁹ Në këtë dokument të 2009-ës të titulluar *UNHCR's Eligibility Guidelines for Assessing the International Protection Needs of Individuals from Kosovo* (Kriteret përzgjedhëse të UNHCR-së për vlerësimin e nevojave për mbrojtje ndërkombëtare për individët nga Kosova),¹⁰ UNHCR-ja bën një listë të atyre grupeve që i konsideron se i plotësojnë kriteret për të pasur mbrojtje ndërkombëtare në vazhdimësi, si rezultat i një rreziku të veçantë persekutimi ose lëndimi serioz në Kosovë, përfshirë edhe përmes diskriminimit kumulativ. Ndër këto grupe përfshiheshin sidomos serbët dhe romët, si dhe individët nga grupet e tjera etnike të përshkruara më poshtë.

UNHCR-ja gjithashtu rekomandoi që, "Të gjitha kërkesat nga azil-kërkuesit nga Kosova duhet të shqyrtohen mbi bazën e meritave individuale, mbi bazën e procedurave të drejta dhe efikase për përcaktimin e statusit të refugjatëve".¹¹ Përveç kësaj, UNHCR-ja theksoi nevojat për mbrojtje të një numri grupesh të veçanta, duke thënë që: "UNHCR-ja mendon se grupet e përmendura në këtë seksion përballen me një rrezik të veçantë persekutimi ose lëndimi të rëndë në Kosovë, përfshirë edhe përmes akteve diskriminuese kumulative. Lista e mësipërme nuk duhet të interpretohet si shteruese [...]". Sipas UNHCR-së, ndër këto grupe përfshihen serbët dhe shqiptarët në situata ku ata përbëjnë pakicë, si dhe romët:

"Serbët e Kosovës dhe shqiptarët e Kosovës që banojnë në zona ku ata përbëjnë pakicë, dhe romët e Kosovës që banojnë në çdo pjesë të Kosovës, vazhdojnë të përballen me kufizime serioze në lirinë e lëvizjes dhe ushtrimin e të drejtave themelore njerëzore, përfshirë edhe diskriminimin shoqëror dhe ndonjëherë edhe administrativ, që do të kufizonte sidomos aftësinë e tyre për të ushtruar të drejtat e tyre politike, shoqërore dhe ekonomike. Për më tepër, ka të dhëna për kërcënime dhe dhunë fizike të ushtruar kundër këtyre komuniteteve.

⁹ Ky është dokumenti i fundit i një serie dokumentesh që shprehin qëndrimin e UNHCR-së, të lëshuara gjatë 10 viteve të fundit, dhe që parashtrojnë nevojat për mbrojtje ndërkombëtare të personave nga Kosova. Për dokumentet e mëparshme, shih, për shembull, Komisioneri i lartë i KB-së për Refugjatët, *UNHCR Position on the Continued Protection Needs of Individuals From Kosovo*, (Qëndrimi i UNHCR-së për nevojat për mbrojtje të mëtejshme të individëve nga Kosova,) 1 prill 2002, që mund të gjendet në: <http://www.unhcr.org/refworld/docid/3cd108544.html>

¹⁰ UNHCR, *UNHCR's Eligibility Criteria for Assessing the International Protection Needs of Individuals from Kosovo*, (Kriteret përzgjedhëse të UNHCR-së për vlerësimin e nevojave për mbrojtje ndërkombëtare për individët nga Kosova) HCR/EG/09/01, nëntor 2009, që këtu e tutje do t'i quajmë shkurt, *Kriteret Përzgjedhëse*, <http://www.unhcr.org/refworld/docid/4af842462.html>

¹¹ UNHCR, *Kriteret Përzgjedhëse*, f. 17.

“Pakicat ashkali dhe egjiptase, për shkak të karakteristikave të tyre racore dhe etnike, mund të ngatërrohen me romët e Kosovës. Ashtu si edhe romët e Kosovës, pakicat e ashkalinjve dhe të egjiptasve shpesh nuk kanë dokumente identifikimi dhe për këtë arsye gjenden në rrethana të vështira për sa i përket qasjes në shërbimet sociale, kujdesit shëndetësor dhe arsimit. Kërkesat për azil nga pjesëtarë të këtyre komuniteteve duhet të shqyrtohen me kujdes, për të vlerësuar nëse ekziston nevoja për mbrojtje të mëtijshme ndërkombëtare, mbi bazën e rrezikut të persekutimit për shkak të racës ose kombësisë reale ose të perceptuar”.¹²

Përveç kësaj, UNCHR mendon se grupet e mëposhtme mund të përballen me diskriminim, që mund të kthehet deri në persekutim ose lëndim të rëndë, edhe sepse autoritetet e Kosovës nuk janë në gjendje, ose nuk janë të gatshme, t'i mbrojnë ata:

- Persona në martesë të përziera etnike dhe persona me kombësi të përzier;
- Personat që mendohen se kanë pasur lidhje me autoritetet serbe pas vitit 1990;¹³
- Viktimat e trafikimit dhe ato të dhunës në familje; dhe personat kërkesat e të cilëve bëhen mbi bazën e orientimit seksual.¹⁴

Përveç kategorive të rrezikuara, të identifikuar nga UNHCR-ja, Amnesty International është e mendimit se edhe grupet e mëposhtme mund të rrezikohen të përballen me persekutim ose me lëndim të rëndë në Kosovë, edhe si rezultat i akteve diskriminuese kumulative dhe/ose si rezultat i pamundësisë së autoriteteve të Kosovës për t'u dhënë atyre mbrojtjen dhe kujdesin e duhur.

Viktimat e krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës që pretendohet të jenë kryer nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Në Kosovë vazhdon të mbizotërojë mos-ndëshkueshmëria. Nga shkeljet e së drejtës ndërkombëtare humanitare që ndodhën gjatë viteve 1998-1999, vetëm një numër relativisht i vogël janë hetuar ose ndjekur penalisht. Mungesa e një sistemi efektiv për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe nivelet e larta të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë mund të bëjnë që viktimat e krimeve kundër njerëzimit dhe të krimeve të luftës, dhe/ose dëshmitarët e këtyre krimeve, të jenë të rrezikuar nga persekutimi dhe lëndimi serioz,

¹² UNCHR, *Kriteret Përgjydhëse*, f. 17-18

¹³ UNCHR mendon se persona të tillë mund të përballen me “diskriminim dhe keqtrajtim në Kosovë, që mund të përbëjë persekutim, mbi bazën e opinionit politik real ose të perceptuar. Ndonëse në disa raste atyre mund t'u ofrohet mbrojtje nga autoritetet, mungesa e besimit tek gjyqësori dhe fakti që organet drejtuese nuk kanë siguruar që “shteti ligjor” të mbrojë individët, ceken si problemet kryesore, dhe kërkimi i drejtësisë përmes autoriteteve shpesh është i pasuksesshëm”, UNCHR, *Kriteret Përgjydhëse*, f. 19.

¹⁴ “Viktimat e trafikimit (dhe familjet e tyre) mund të vazhdojnë të rrezikohen nga keqtrajtimi ose ndonjë lloj tjetër shpagimi nga trafikuesit ose bashkëpunëtorët e tyre, nga të cilët autoritetet mund të mos jenë në gjendje t'i mbrojnë. Përveç kësaj, ato mund të mos pranohen nga familja ose komuniteti i tyre. Shumica e rasteve të dhunës në familje nuk raportohen tek autoritetet, pjesërisht sepse gratë nuk besojnë se do merret ndonjë veprim mbi bazën e ankimit të tyre”, UNCHR, *Kriteret Përgjydhëse*, f. 20.

përfshirë edhe prej personave privatë, nga të cilët Amnesty International mendon se autoritetet e Kosovës nuk mundën ose nuk duan të ofrojnë mbrojtje. Përveç kësaj, viktimat e dhunës seksuale si krim lufte ka të ngjarë të stigmatizohen në komunitetet e veta.¹⁵

*Personat nga të gjitha komunitetet që vuajnë nga Sindroma e Stresit Pas-Traumatik, dhe sëmundje të tjera serioze që nuk mund të trajtohen siç duhet në Kosovë.*¹⁶ Autoritetet e Kosovës, në Strategjinë e Riintegritimit 2010, e kanë pranuar që disa sëmundje serioze nuk mund të trajtohen në Kosovë;¹⁷ UNHCR-ja është shprehur gjithashtu se këta persona mund të kenë të drejtën e një mbrojtjeje plotësuese.¹⁸ Shtetet duhet t'i shqyrtojnë siç duhet rastet e personave, kërkesat e të cilëve për mbrojtje për arsye të nevojave shëndetësore janë refuzuar si rezultat i pragjeve shumë të larta që janë vendosur për vërtetimin e rrezikut nga persekutimi ose lëndimi serioz, por që, pavarësisht nga kjo, kanë nevoja mjekësore kritike. Në këto rrethana, Amnesty International i nxit shtetet që të shqyrtojnë nëse largimi i këtyre personave është një ndërhyrje proporcionale dhe për rrjedhojë, e ligjshme, në të drejtën e këtyre aplikantëve për t'iu respektuar jeta e tyre private.¹⁹

¹⁵ Amnesty International beson se viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut nuk duhet të gjenden në rrethana ku nuk u njihen nevojat e tyre afatgjata, ndër të cilat edhe të drejtat e tyre për kompensim dhe rehabilitim, edhe kur ata nuk rrezikohen më nga persekutimi.

¹⁶ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka sqaruar se në rastet kur në vendin e origjinës mungojnë mundësitë e mjaftueshme për trajtimin e një sëmundjeje serioze, [mund të jepet mbrojtje plotësuese ose dytësore. Sipas Gjykatës, dërgimi i një personi të sëmurë rëndë në një vend ku atij ose asaj do t'i mungojë ndihma e përshtatshme mjekësore, në raste të jashtëzakonshme, mund të përbëjë trajtim çnjerëzor në kundërshtim me Nenin 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Shih, në veçanti, *Bensaid kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. i Aplikimit 44599/98, 33 EHRR 10, 6 shkurt 2001, që gjendet në: <http://www.unhcr.org/refworld/docid/3deb8a1e4.html>.

¹⁷ "Për shkak të kushteve të tanishme (mungesa e pajisjeve, strukturat e pamjaftueshme) disa shërbime shëndetësore tretësore (kirurgjia e zembrës, onkologjia, politraumalogjia, transplantet, çrregullimet mendore, etj.) nuk mund të ofrohen në Kosovë", *Strategjia e Riintegritimit, 2010*, f. 13. Qeveria e Kosovës vazhdon të prezumojë kundër kthimit të personave me "paaftësi mendore", "Qeveria e Kosovës duhet të negociojë me vendet pritëse që të mos kthejnë personat me paaftësi mendore. Në marrëveshjet dhe kushtet e ripranimit duhet të përfshihet një dispozitë e veçantë.", *Strategjia e Riintegritimit, 2010*, f. 24. Shih edhe Seksionin 5.5. (Persona me probleme mendore dhe pa përkujdes familjar), *Strategjia e Riintegritimit 2007*, f. 27.

¹⁸ Kjo mbrojtje plotësuese mund të jepet në përputhje me Direktivën 2004/83/EC (Direktivë Kualifikuese) sipas Nenit 15(b), UNHCR, Kriteret Përzgjedhëse, f. 23-24. Direktiva e Këshillit 2004/83/EC e datës 29 prill 2004, për standardet minimale për kualifikimin dhe statusin e shtetasve të vendeve të treta, ose të personave pa shtetësi, si refugjatë ose si persona që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare për shkaqe të tjera, si dhe përmbajtjen e mbrojtjes së dhënë, <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32004L0083:EN:HTML>

¹⁹ Amnesty International ka dijeni për disa raste ku, personat që kanë nevojë për trajtim mjekësor i cili nuk ofrohet në Kosovë, janë kthyer me forcë nga disa vende, ndër të cilat edhe Franca dhe Gjermania, pa iu dhënë së pari mundësia e një vendimi individual për nevojat e tyre për mbrojtje. Për shembull, një

Në këto kategori shtesë, kërkesat për mbrojtje mund të bëhen mbi bazën e Konventës së Refugjatëve të vitit 1951²⁰, se ata do të përballen me persekutim, ose mbi bazat e një rreziku real të lëndimit serioz pas kthimit në Kosovë,²¹ ose se kthimi i tyre do të ishte në një mënyrë tjetër një shkelje e të drejtave të njeriut.

Amnesty International mendon se çdo person, të cilit i është hequr statusi i mbrojtjes së përkohshme dhe që përballlet me mundësinë e kthimit në Kosovë, ka të drejtën e një procedure të shpejtë, të drejtë, dhe efektive, me anë të së cilës ai mund të kundërshtojë kthimin për arsye azili ose për arsye të tjera të mbrojtjes ndërkombëtare dhe/ose të të drejtave të njeriut.²²

Më 22 qershor 2010, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE) miratoi një rezolutë për Kosovën, që u bënte thirrje të gjitha vendeve anëtare të Këshillit të Evropës “të mos kthejnë me forcë në Kosovë ata individë që ende mund të kenë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare sipas udhëzimeve përkatëse të Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për refugjatët.”²³ Në një rezolutë më vete për romët në Evropë, APKE gjithashtu u bëri thirrje vendeve anëtare të Këshillit të Evropës të “marrin masa të posaçme për t’u dhënë mbrojtje azil-kërkuesve romë që janë larguar për shkak të dhunës raciste, [...] dhe të mos i kthejnë romët në Kosovë deri sa UNHCR-ja të ketë konfirmuar se situata atje është përmirësuar në shkallë të mjaftueshme për sa i përket sigurisë dhe qasjes në të drejtat sociale [Theksim i AI]”.²⁴

Amnesty International mendon se çdo kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare duhet të merret në shqyrtim mbi bazat e meritave të veta individuale. Siç ka raportuar edhe Këshilli i

djalë 15 vjeçar me kombësi shqiptare u kthye me detyrim në Kosovë nga Franca më 2 maj 2010; profesionistët e shëndetësisë në Kosovë kërkuan më 17 maj 2010 që ai të lejohej të merre trajtim mjekësor jashtë shtetit.

²⁰ Konventa e vitit 1951 lidhur me Statusin e Refugjatëve dhe Protokolli i vitit 1967 lidhur me Statusin e Refugjatëve, <http://www.unhcr.org/3b66c2aa10.html>

²¹ Shih mbrojtja dytësore, “Direktiva e Këshillit 2004/83/EC e 29 prillit 2004, për standardet minimale për kualifikimin dhe statusin e shtetasve të vendeve të treta, ose të personave pa shtetësi, si refugjatë ose si persona që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare për shkaqe të tjera, dhe përmbajtjen e mbrojtjes së dhënë, Gazeta Zyrtare L 304, 30/09/2004 f. 0012 – 0023”. Me qëllim që të sigurohet kthimi i sigurt dhe me dinjitet, Amnesty International mendon se duhet kryer një vlerësim i të drejtave të njeriut, përpara kthimit, për të shqyrtuar qasjen e të kthyerve në të drejtat e tyre ekonomike, shoqërore dhe kulturore.

²² Një proces i tillë duhet të shoqërohet me masa mbrojtëse, si ndihma e duhur ligjore, përfaqësimi i përshtatshëm ligjor në të gjitha fazat e procedurës ligjore, pavarësia dhe paanshmëria e organit vendimmarrës.

²³ Botim i përkohshëm, *The situation in Kosovo and the role of the Council of Europe, Resolution 1739 (2010)* (Situata në Kosovë dhe roli i Këshillit të Evropës, Rezoluta 1739 (2010)paragrafi 16.1, <http://assembly.coe.int/Mainf.asp?link=/Documents/AdoptedText/ta10/ERES1739.htm>

²⁴ Botim i përkohshëm, Rezoluta 1740 (2010), Situata e romëve në Evropë dhe veprimtaritë e Këshillit të Evropës në lidhje me të, paragrafi 15.12, <http://assembly.coe.int/Mainf.asp?link=/Documents/AdoptedText/ta10/ERES1740.htm>

Evropës, “Për sa i përket Kosovës në veçanti, situata e ndryshuar në terren, për shkak të shpalljes së njëanshme të pavarësisë, nuk eliminon rrezikun e persekutimit, lëndimit serioz, ose diskriminimit kumulativ që mund të pësojnë disa grupe.”²⁵

3.1 DHUNË NDËRETNIKE NË VAZHDIMËSI

“Situata në Kosovë ka qenë relativisht e qëndrueshme, megjithëse, siç e pamë edhe kohët e fundit në fillim të korrikut, vazhdon të mbetet mundësia për destabilizim, sidomos në Kosovën Veriore. Përparimi i pamjaftueshëm drejt pajtimit të komuniteteve dhe çështjet e pazgjidhura që e pengojnë këtë pajtim, së bashku me zhvillimin e ngadalshëm ekonomik, vazhdojnë të paraqesin rrezik për trazira shoqërore.” Lamberto Zannier, Përfaqësues i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së, gusht 2010.²⁶

Më 2 korrik 2010, një doktor boshnjak u vra dhe dhjetë serbë u plagosën nga një mjet shpërthyes, ose disa mjete shpërthyes (që mendohet se ishte granatë dore), gjatë një demonstrate në Mitrovicë. Më 5 korrik, Petar Miletic, një deputet serb në Kuvendin e Kosovës u qëllua me armë zjarri dhe u plagos para shtëpisë së tij në Mitrovicë.

Si serbët, ashtu edhe shqiptarët janë të rrezikuar nga sulme të tilla. Më 8 shtator 2010, për shembull, në zona të përziera etnike si lagjja Kodra e Minatorëve/Mikronaselje në Mitrovicën e Veriut, një person me kombësi shqiptare, Hakif Mehmeti, u vra nga persona të panjohur. Të nesërmen, më 9 shtator, ndodhi një shpërthim afër një konvikti në Mitrovicë; cak i këtij sulmi mendohej të ishte një polic serb që banonte aty afër.²⁷

Megjithëse situata e përgjithshme e sigurisë mbetet relativisht e qetë, frikësimet ndër-etnike vazhdojnë të krijojnë një perceptim rreziku për pjesëtarët e komuniteteve të pakicave, i cili ushqehet nga incidente sporadike të dhunës. Shumica e incidenteve të dhunës ndër-etnike ndodhin në Mitrovicën e Veriut ose përfaqësojnë sulmet kundër personave ose pronave janë më të shpeshta se kudo gjetkë në Kosovë. Sulme janë raportuar edhe kundër refugjatëve ose personave të zhvendosur brenda vendit që janë kthyer: serbët që u kthyen vullnetarisht në marsin e 2010-ës në fshatin Zhaq/Žač në komunën e Istogut, kanë qenë objekt i sulmeve të vazhdueshme, ndër të cilat edhe raste kur kundër tyre është qëlluar me armë automatike. Deri në qershor, katër familje të kthyer ishin larguar.

Në vitin 2009 u raportuan një numër incidentesh edhe në komunën e Gjilanit/Gnjilane, ku jeton një komunitet i vogël i pakicës serbe në një zonë me shumicë shqiptare: në gusht, një çift të moshuarish serbë u gjendën të vrarë me armë zjarri në banesën e tyre në Partesh/Parteš afër Gjilanit/Gnjilane; motivi për vrasjen e Bogdan dhe Trajanka Petkoviqit mbetet i panjohur dhe autorët e krimit nuk janë nxjerrë para drejtësisë.

Një numër incidentesh të tjera ka pasur në Gjilan/Gnjilane dhe Ferizaj/Uroševac, kur romët janë sulmuar ose janë ngacmuar.

²⁵ APKE, Komisioni i Çështjeve Politike, Dok. 12281, *The situation in Kosovo and the role of the Council of Europe*, (Situata në Kosovë dhe roli i Këshillit të Evropës) 7 qershor 2010, paragrafi 95.

²⁶ Proces verbali i mbledhjes 6367 të Këshillit të Sigurimit të KB-së, E martë, 3 gusht 2010, 3 pasdite New York, S/PV.6367.

²⁷ *BBC Monitoring Service*, 8 dhe 9 shtator 2010.

Më 13 gusht 2009, një program televiziv në gjuhën rome (Yekhipe) në Radio Televizionin e Kosovës, transmetuesi shtetëror, raportoi një varg sulmesh kundër romëve nga persona me kombësi shqiptare në Gjilan/Gnjilane, javën e fundit të korrikut 2009. Në fillim u raportua se të paktën katër romë, një prej tyre drejtues në komunitet, u keqtrajtuar fizikisht dhe u lënduan në incidente të veçanta, por nga shtatori, sipas Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së, numri ishte rritur në gjashtë.²⁸ Sipas Misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë, viktimat i kishin raportuar sulmet në polici dhe ishin filluar hetimet. Që nga shtatori i vitit 2009, Amnesty International ka kërkuar vazhdimisht informacion nga Policia e Kosovës për rezultatin e këtyre hetimeve, por ende nuk ka mundur të marrë vesh rezultatin.²⁹

Më 25 gusht 2009, 20 familje rome nga mëhalla Halit Ibishi në Ferizaj/Uroševac dorëzuan një peticion në Zyrën e Komuniteteve në Komunën e Ferizajt, i cili thoshte se familjet ishin ngacmuar me fjalë dhe fizikisht në disa raste, nga 17 deri 22 gusht, nga "persona të panjohur." Ata kërkuar mbrojtje nga Policia e Kosovës dhe autoritetet e komunës. Sipas informacionit që kemi, policia ka filluar një hetim për këto akuza.

Sulmet mbi ashkalinjtë, të raportuara publikisht, janë të rralla, por në qershor 2010, Sekretari i Përgjithshëm i KB-së raportoi se një grua ashkalie ishte plagosur me 7 mars, kur dikush qëlloi me armë nga jashtë brenda në shtëpinë e saj në zonën e Prishtinës/Priştina. "Sipas një përfaqësuesi të komunitetit, pak javë përpara incidentit, familja e gruas kishte marrë një letër kërcënuese, që u kërkonte ta lëshonin shtëpinë".³⁰

Megjithatë, siç vë në dukje edhe UNHCR në *Kriteret Përzgjedhëse*, sulmet mbi komunitetet rome dhe mbi individët rrallë i raportohen autoriteteve, sepse romët mendojnë se nuk do të ndërmerret ndonjë veprim edhe nëse raportojnë, ose se do të përballen me hakmarrjen e autorëve.³¹ Sulme bëhen ndonjëherë edhe kundër komuniteteve të tjera të pakicave.³²

Shumica e krimeve të raportuara me bazë etnike, vazhdojnë të mos ndëshkohen, pavarësisht nga kombësia e viktimës apo e autorit të veprës penale. Shpesh krimet nuk raportohen dhe dëshmitarët nuk janë të gatshëm të prononcohen nga frika e hakmarrjes, gjë që çon në një

²⁸ *Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo* (Raport i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Përkohshëm Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë), S/2009/497, 30 shtator 2009, paragrafi 24, <http://daccess-ods.un.org/TMP/8724929.09431458.html>

²⁹ Shih njoftimin për shtyp nga Amnesty International dhe Human Rights Watch, *Kosovo: Investigate Attacks on Roma* (Kosova: Të hetohen sulmet mbi romët), 7 shtator 2009, <http://www.amnesty.org/en/for-media/press-releases/kosovo-investigate-attacks-roma-20090907>.

³⁰ *Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo* (Raport i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Përkohshëm Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë), S/2010/401, 29 korrik 2010, f. 5.

³¹ UNHCR, *Kriteret Përzgjedhëse*, f. 10-11.

³² Më 3 shtator 2009, për shembull, sipas Radio Televizionit të Kosovës, në kolegjin privat turk "Mehmet Akif" u në fshatin Banulle/Bandulić të komunës së Lipjanit/Lipljane u hodh një mjet shpërthyes. Nuk pati asnjë lëndim.

numër të vogël ndjekjesh penale.³³ Siç raportonte edhe Misioni i OSBE-së në Kosovë në fund të vitit 2009: “[...] në sistemet e sigurisë dhe të gjyqësorit, të metat kryesore lidhen me mungesat në klasifikimin, hetimin, dhe ndjekjen penale të krimeve me motive etnike, sepse mendimi që kanë komunitetet jo-shumicë, se nuk ka ndëshkim, nuk kontribuon në krijimin e besimit ndaj autoriteteve”.³⁴

SERBËT

Shumica e serbëve që e lëshuan Kosovën shkuan në Serbi, ku vazhdojnë të banojnë si persona të zhvendosur brenda vendit (PZHBV); të tjerë kanë kërkuar mbrojtje në vendet anëtare të BE-së. Amnesty International, UNHCR në *Kriteret Përzgjedhëse* dhe organizata të tjera ndërkombëtare (shih më poshtë) nuk mendojnë se në Kosovë ekzistojnë kushtet për kthimin e qëndrueshëm të serbëve.

Serbët mbeten të rrezikuar edhe në enklavat serbe dhe në zonat e përziera etnike në jug, ku rregullisht raportohen shpërthime të dhunës ndër-etnike ose incidente individuale që mund të kenë motive etnike, ose sulme mbi refugjatët e kthyer (siç u cek më lart). Përveç kësaj, serbët nuk gëzojnë liri të plotë të lëvizjes, përgjithësisht jetojnë brenda enklavave dhe, në disa raste, rrallë dalin jashtë komuniteteve të veta, përveç se kur u duhet të shkojnë, për shembull, në spital ose në shkolla të mesme e të larta në pjesën veriore të vendit.³⁵

Tri komunat veriore, Mitrovica e Veriut, Zubin Potok dhe Leposaviq/Leposavić (dhe enklavat serbe në jug) efektivisht mbeten nën kontrollin serb dhe i përgjigjen drejtpërsëdrejti Beogradit. Këto autoritete komunale nuk i njohin dhe nuk i zbatojnë ligjet dhe masat e tjera, si Strategjia e Ripranimit dhe Riintegrimit, e hartuar nga autoritetet e Kosovës (shih më poshtë). Sipas OSBE-së, asnjëra prej katër komunave të veriut nuk mbajnë statistika për personat e kthyer.³⁶ Në veri nuk janë marrë masa për të siguruar integrimin e të kthyerve, ku

³³ Amnesty International, *Varrosja e së kaluarës*, op. cit., f. 34-49. Për numrin e ulët të raportimeve të krimeve ndër-etnike, shih edhe International Crisis Group, *The Rule of Law in Independent Kosovo*, *Crisis Group Europe Report N°204*, (Shteti ligjor në Kosovën e pavarur, Raport nr. 204 i Grupit të Krizave Evropë), 19 maj 2010, f. 3,7 &19.

<http://www.crisisgroup.org/~media/Files/europe/balkans/kosovo/204%20The%20rule%20of%20Law%20in%20Independent%20Kosovo.ashx>

³⁴ Misioni i OSBE-së në Kosovë, Departamenti për të Drejta të njeriut dhe Komunitete, *Communities Rights Assessment Report*, (Raport i vlerësimit të të drejtave të komuniteteve), dhjetor 2009, f. 6; shih edhe f. 10-12. Në korrik 2008, OSBE-ja raportonte se ishin bërë vetëm 400 ndjekje penale nga 1 400 rastet e raportuara në polici pas dhunës etnike të marsit 2004. Shih edhe <http://www.hrw.org/en/news/2010/07/19/blood-and-justice-kosovo>

³⁵ Për një përshkrim të incidenteve të kohëve të fundit, shih paragrafët. 21-26, *Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo* (Raport i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Përkohshëm Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë), 29 korrik 2010.

³⁶ Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Zbatimi i Strategjisë për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në Komunitet e Kosovës* (Zbatimi i strategjisë së riintegrimit të personave të riatdhesuar në komunitet e Kosovës), 2009, f. 8.

më se 600 serbë, shumë prej tyre të moshuar, dhe romë, jetojnë në kampe për PZHBV-të. Për këtë arsye, Amnesty International është tejet e brengosur nga një raport i botuar nga Bordi i Migracionit Suedisë në 2009, i cili – duke u nisur nga fakti se romët vazhdojnë të vuajnë nga diskriminimi në Kosovë – sugjeron se ata mund të kthehen në mënyrë të qëndrueshme në enklavat serbe, të mbështetura nga autoritetet serbe.³⁷

Ka të dhëna që shumica e vendeve anëtare të shteteve të BE-së kanë rënë dakord, jo zyrtarisht, që të mos i kthejnë serbët në Kosovë, ndonëse statistikisht e UNHCR-së (shih Tabelën 1, më poshtë) sugjerojnë se një numër në rritje po i kthejnë me forcë. Më 3 nëntor 2009, për shembull, 16 serbë – shumica nga fshatrat Gjilanit/Gnjilane ishin në grupin prej 29 personash që do të ktheheshin me forcë nga Luksemburgu më 4 nëntor 2009. Por, sipas informacionit që mori Amnesty International, një familje serbe me pesë anëtarë nuk u kthye, pas ndërhyrjes së një Tribunali administrativ.

SHQIPTARËT ETNIKË, KTHIMI NË SITUATA KU ATA PËRBËJNË PAKICË

Për shqiptarët, kthimi në situata ku ata përbëjnë pakicë, mund të ketë pasoja serioze për sigurinë e tyre. Komunitete pakicash shqiptare ka në qytetin e Mitrovicës së Veriut, ku tensionet ndër-etnike janë të forta dhe ku nuk janë të rralla sulmet e serbëve mbi shqiptarët,³⁸ në komunat veriore nën drejtimin e serbëve, si dhe në disa prej enklavave të dominuara nga serbët në jug.

Në prill 2009 shqiptarët që donin të ktheheshin në fshatin Kroi i Vitakut/Brđani në Mitrovicën e Veriut, u penguan të rindërtonin shtëpitë e tyre nga serbët, të cilët demonstruan kundër kthimit të tyre. Shumë prej serbëve protestonin se as ata nuk mund të ktheheshin në shtëpitë e tyre në të njëjtin fshat. Për 10 ditë u qe e nevojshme të përdorej policia e EULEX-it dhe forcat e KFOR-it për të mbrojtur shqiptarët e kthyer, duke përdorur edhe gaz lotsjellës dhe granata mpirëse kundër protestuesve serbë. Një serb u lëndua; disa serbë u lënduan në demonstrata të ngjashme në tetor të 2008-ës. Në mes të majit, situata u zgjidh përmes një marrëveshjeje për t'i lejuar edhe serbët t'i rindërtonin shtëpitë e tyre në fshatin Kroi i Vitakut/Brđani; u ngrit një gardh me tela me gjemba midis ndërtimeve serbe dhe shqiptare, i cili patrollohej nga policë të armatosur të EULEX-it. Megjithatë, në mes të gushtit dhe në fillim të shtatorit 2009, shpërtheu përsëri dhuna midis serbëve dhe shqiptarëve të kthyer që po rindërtonin shtëpitë e tyre, ndaj edhe u shtua përsëri prania e policisë së EULEX-it³⁹. Por, nga qershori 2010, sipas Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së, "Trajtimi i kujdesshëm i veprimtarive të ndërtimit dhe i kthimeve në lagjen ndër-etnike të Kroit të Vitakut/Brđjani ka rezultuar deri më tani në një stinë paqësore ndërtimesh".⁴⁰

³⁷ Nga korriku 2009, më se 30 romë ishin deportuar, ndërsa afërsisht 30 të tjerë po prisnin të deportoheshin.

³⁸ Për sulmet kundër shqiptarëve në Mitrovicë në vitin 2010, shih Raport i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Përkohshëm Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, 29 korrik 2010, op. cit., paragrafët 21-26.

³⁹ Misioni i Policisë dhe Drejtësisë në Kosovë, i drejtuar nga BE-ja.

⁴⁰ Raport i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Përkohshëm Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, 29 korrik 2010, paragrafi 19.

4. KTHIMI DHE RIINTEGRIMI

4.1 KTHIMI VULLNETAR DHE I DETYRUAR

Riatdhesimi vullnetar (kthimi me dëshirë dhe vullnet të lirë në vendin e origjinës në siguri dhe me dinjitet) është zgjedhja që bëjnë vetë shumica e refugjatëve. Në rastin e të kthyerve, kjo ka të bëjë me rivendosjen e mbrojtjes së shtetit (për të shmangur nevojën e mbrojtjes ndërkombëtare) dhe, përmes procesit të riintegrit, me aftësinë për të pasur mjete jetese të qëndrueshme, qasje në shërbimet themelore dhe për t'u riintegruar plotësisht në komunitetet ve vendeve të origjinës. UNHCR, "Manual për veprimtaritë e riatdhesimit dhe riintegrit", 2004, f. 26.

Në dhjetë vitet pas konfliktit të armatosur, kthimet vullnetare të pjesëtarëve të komuniteteve të pakicave në Kosovë kanë qenë të ngadalshme. Në mungesë të kushteve për kthim të qëndrueshëm, UNHCR-ja, në një numër dokumentesh të njëpasnjëshme ku shpreh qëndrimin e saj, i ka këshilluar qeveritë të vazhdojnë t'u ofrojnë mbrojtje ndërkombëtare disa pakicave dhe grupeve të rrezikuara.⁴¹

Deri në vitin 2008, Zyra për Kthim dhe Komunitete e UNMIK-ut u përpoq të kufizonte numrin e personave të kthyer përmes Memorandumeve të Mirëkuptimit të nënshkruara me disa vende anëtare të BE-së. Pas transferimit të përgjegjësisë për ripranimet tek autoritetet kosovare, UNHCR-ja ka raportuar një rritje të numrit të kthimeve, në dukje vullnetare. Në vitin 2008, u bënë 714 kthime vullnetare të personave nga pakicat; në 2009-ën u raportuan 1 269 kthime, dhe në tetë muajt e parë deri në gusht 2010, UNHCR-ja raportoi se numri total i kthimeve vullnetare të pakicave ishte 1 138 persona (381 familje).⁴² Këto shifra nuk përfshijnë rreth 3 860 kthime të raportuara si vullnetare, të asistuara nga Organizata Ndërkombëtare e Migracionit (ONM), statistikat e së cilës nuk janë të ndara në bazë të etnicitetit.

Personat që kthehen vullnetarisht në Kosovë, pavarësisht nga etniciteti i tyre, përfshirë edhe ata që janë lajmëruar se duhet të largohen nga vendi pritës, mund të ndihmohen nga UNHCR-ja dhe nga Ministria për Komunitete dhe Kthim⁴³ dhe partnerët e tyre zbatues, ndër të cilët edhe Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP-ja), ose nga ONM-ja. Ata

⁴¹Për shembull, "Kthimi i këtyre pakicave [serbëve, romëve dhe shqiptarëve të Kosovës] duhet të bëhet vetëm mbi baza vullnetare, i bazuar në vendime individuale të mbështetura në informacion të plotë." Dokument i Qëndrimit të UNHCR-së për nevojat në vazhdimësi për mbrojtje ndërkombëtare të individëve nga Kosova *(qershor 2006), f. 2.

⁴² UNHCR, OCM Prishtinë, *Statistical Overview, Update as at end of August 2010* (Pasqyrë statistikore, përditësuar deri në fund të gushtit 2010).

⁴³ Ministria për Kthim dhe Komunitete (e cila drejtohet nga anëtarët serbë të Kuvendit të Kosovës), bashkërendon kthimin vullnetar të refugjatëve dhe të PZHBV-ve, dhe organizon projekte kthimi për komunitetet e pakicave. Ajo nuk merret me kthimet e detyruara; për këtë arsye, ajo nuk është përgjegjëse për asnjë nga aspektet e Politikës së Kthimeve dhe Riintegritit të diskutuar më poshtë.

që marrin pjesë në “kthimet e asistuar” mund të marrin ndihmë financiare për gjashtë muajt e parë, ndihmë në banim, dhe, në disa raste, për rindërtimin ose ndërtimin e shtëpive dhe qasje në programet për gjenerimin e të ardhurave. Ndonjë ndihmë mund të jepet edhe nga shteti dërgues.

Është e rëndësishme të bëhet dallimi midis “kthimeve të asistuar” vullnetare, dhe kthimeve vullnetare “spontane”, që shpesh bëhen nga individë dhe familje pa asnjë lloj asistence. Ndonëse të gjithë të kthyerit vullnetarë kanë të drejtën e asistencës nga UNHCR-ja, në rastin e kthimeve spontane, dhe në mungesë të lajmërimit paraprak nga shteti dërgues ose individit në fjalë, disa persona mund të kthehen pa asistencën e ndonjë agjencie vendore ose ndërkombëtare.

Sipas UNHCR-së, kthimet vullnetare duhet të kryhen vetëm me “pëlqimin e lirë dhe të informuar” të personit të kthyer.⁴⁴ Për këtë arsye, Amnesty International është mjaft e brengosur nga çka raportojnë të kthyerit dhe Agjencia e KB-së për Fëmijët (UNICEF), se një numër i të ashtuquajturve “kthime vullnetare” janë bërë nën kërcënimin e kthimit të detyruar. Sipas UNICEF-it, disa të kthyer të ashtuquajtur “vullnetarë” janë marrë nga banesa e tyre dhe janë çuar në një stacion policie për të nënshkruar dokumente ku thuhej se kthimi i tyre ishte “vullnetar”, dhe pastaj i kanë çuar drejt e në aeroport për t'i kthyer në Kosovë.⁴⁵

Nën dritën e gjithë sa më sipër, organizata është e brengosur se ndër personat të cilët janë kthyer “vullnetarisht” nën një trysni të tillë, mund të ketë pasur njerëz që përballeshin me një rrezik të vërtetë persekutimi ose lëndimi serioz pas kthimit në Kosovë.

“Më kanë detyruar të nënshkruaj për kthimin vullnetar. Më kërcënuan se do të më merrnin e do të më kthenin mbrapsht. Kështu që u ktheva vullnetarisht dhe ata më dhanë gjashtë muaj qira për një banesë në Prishtinë, por pas asaj, asgjë. Rreth 30 persona erdhën dhe më treguan informacionin, por nuk kishte asnjë mbështetje, veç njerëz që vinin të më takonin. Dy fëmijët i kam me aftësi të kufizuara [në të folur e të dëgjuar], prandaj kërkova edhe asistencë, por më thanë që nuk i përmbushja kriteret. Pastaj fëmijët u pranuan në një shkollë speciale në Prizren, por nuk kisha të holla t'i çoj atje. Nuk më del as për të ngrënë”.

N.N., kthyer nga Gjermania, intervistuar nga Amnesty International në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, qershor 2010.

⁴⁴ Këshilli i Bashkimit Evropian e ka përkufizuar “kthimin vullnetar” si “nisjen e asistuar ose të pavarur për në vendin e kthimit, mbi bazën e vullnetit të të kthyerit/kthyerës dhe të vendimit të tij/saj të informuar për t'u kthyer”... “e kryer në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga instrumentet gjegjëse ndërkombëtare”, 12 tetor 2005,

http://www.consilium.europa.eu/ueDocs/cms_Data/docs/pressData/en/jha/86570.pdf

⁴⁵ Verena Knaus & Peter Widmann, *Integration unter Vorbehalt. Zur Situation von Kindern kosovarischer Roma, Ashkali und Ägypter in Deutschland und nach ihrer Rückführung in den Kosovo* (Integrim me rezerva: Mbi gjendjen e fëmijëve kosovarë romë, ashkali dhe egjiptas në Gjermani dhe pas kthimit të tyre në Kosovë), Komiteti Gjerman i UNICEF-it e.V., 2010, (këtej e tutje: UNICEF, *Integration unter Vorbehalt* (Integrim me Rezerva), http://www.unicef.de/fileadmin/content_media/presse/Roma-Studie_2010/UNICEF-Studie_Roma_2010neu.pdf

UNHCR-ja ka llogaritur se, që nga viti 2008 janë kthyer me forcë në Kosovë nga Evropa Perëndimore 7 021 persona – si nga komuniteti shqiptar i shumicës, ashtu edhe nga pakicat; në vitin 2008 u kthyen rreth 2 550 persona; në 2009, 2 962; ndërsa deri në 31 gusht 2010 ishin kthyer me detyrim rreth 1 923 persona. Rreth një e treta e të kthyerve romë janë kthyer me detyrim.⁴⁶ Shifrat e mbledhura nga UNHCR-ja në vitet 2008-2010, tregojnë se një numër në rritje i romëve dhe serbëve po i deportojnë me forcë.

Kthimet e detyruara të komuniteteve të pakicave, marrë nga UNHCR, Pasqyrë statistikore, përditësuar deri në fund të gushtit 2010, D / Tabela: Kthimet e detyruara të pakicave nga vende të treta (kryesisht të Evropës Perëndimore) 2008-2010.				
	2008	2009 ⁴⁷	2010 (to 31 gusht)	Total
Serbë	2	47	23	72
Romë	54	127	217	398

⁴⁶ UNHCR, OCM Prishtina, *Statistical Overview, Update as at end of qershor 2010* (Pasqyrë statistikore, përditësuar deri në fund të gushtit 2010). Tabela E: *OVERALL RETURNS TO KOSOVO DURING 2008, 2009 and 2010* (Numri i përgjithshëm i kthimeve në Kosovë gjatë 2008, 2009, dhe 2010). Tregon kthimet vullnetare (romët): 2 962; Kthimet e detyruara: 1 185. Kjo ndarje nuk bëhet në dokumentin e UNHCR-së të gushtit 2010.

⁴⁷ Sipas shifrave që Amnesty International ka marrë nga UNHCR-ja, të paktën 193 persona që UNHCR-ja i konsideronte se kishin nevojë për mbrojtje të mëtejshme ndërkombëtare, janë kthyer në Kosovë me detyrim në vitin 2009. Ndër ta ishin rreth 47 serbë, 127 romë dhe 19 shqiptarë (të kthyer në situata pakice).

Ashkali ⁴⁸	236	184	52	495
Egjiptas	14	9	1	25
Shqiptarë (në rrethana pakice)	15	19	21	64

Këto shifra, dhe ato të cituara më poshtë, mbështeten në vëzhgimet e Ekipit Monitorues të Aeroportit të Prishtinës, partner zbatues i UNHCR-së, por - sipas UNHCR-së – këto duhet të konsiderohen si numër minimal.⁴⁹ Duke pasur parasysh se pak persona të kthyer (qoftë vullnetarë, apo të detyruar) të intervistuar nga Amnesty International, i kishin pritur në aeroport, ose mbanin mend të ishin regjistruar, organizata mendon se numri i të kthyerve mund të jetë shumë më i lartë.

Në kohën e shkrimit të këtij raporti, të kthyerve me detyrim nuk u është dhënë asistencë gjithëpërfshirëse nga qeveria e Kosovës e as nga organizatat ndërkombëtare ose OJQ-të vendore. Ndonëse qeveria e Kosovës ka përgjegjësinë t'u japë asistencë personave të kthyer në kthim dhe riintegrim, siç tregohet më poshtë nga Amnesty International, me gjithë ekzistencën e një mekanizmi për ripranimin e tyre në Kosovë, mungojnë masat për të siguruar riintegrimin e të kthyerve me detyrim, gjë që çon në shkeljen e të drejtave të tyre të njeriut.

⁴⁸ Numri më i madh i ashkalinjve dhe egjiptasve, që u kthyen në vitin 2008, ishte pas dokumentit të qëndrimit të UNHCR-së në vitin 2006 (rishikim i dokumentit të qëndrimit të marsit 2005) i cili thoshte, "Zhvillimet pozitive brenda mjedisit ndëretnik kanë pasur një ndikim të veçantë mbi pjesëtarët e komuniteteve ashkali dhe egjiptase në Kosovë. Për këtë arsye, UNHCR-ja nuk i përfshin më këto pakica ndër ato të rrezikuara".[...] "25. Nga ana tjetër, UNHCR-ja, duke marrë parasysh zhvillimet pozitive në situatën e sigurisë që kanë ndodhur vitin e kaluar në Kosovë, nuk mendon më se pakicat ashkali dhe egjiptase në përgjithësi kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare të mëtutjeshme. Prandaj, kërkesat për azil që vijnë nga këto komunitete etnike duhet të vlerësohen mbi bazën e Nenit 1 A (2) të Konventës së vitit 1951 dhe Protokollit të saj të vitit 1967. Megjithatë, në kushtet e tanishme politike dhe socio-ekonomike, kthimi i personave të këtyre dy grupeve, që janë përcaktuar se nuk kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, duhet të bëhet në një mënyrë graduale, për shkak të kapacitetit të vogël pranues të Kosovës, me qëllim që të mos shkaktohen faktorë destabilizues politikë dhe socialë në një kohë kur po zhvillohen bisedimet për statusin e ardhshëm të Kosovës", UNHCR's Position on the Continued International Protection Needs of Individuals from Kosovo (Qëndrimi i UNHCR-së për nevojat e mëtutjeshme për mbrojtje ndërkombëtare të individëve nga Kosova), qershor 2006, f. 1, f. 7. <http://www.unhcr.org/refworld/pdfid/449664ea2.pdf>

⁴⁹ Intervista të Amnesty International me UNHCR (Prishtinë), shkurt 2009 dhe qershor 2010.

4.2 STRATEGJIA PËR RIINTEGRIMIN E PERSONAVE TË RIATDHESUAR

“Nuk ka as mekanizma dhe as burime për t’u marrë me problemet. Kur kthehen nga Gjermania kanë 200 euro⁵⁰ në xhep, por asnjë shans për mjete të qëndrueshme jetese.” Mefail Mustafa, menaxheri i programit për komunitetet i OSBE-së, qershor 2010

Në vitin 2007 UNMIK-u dhe qeveria e Kosovës miratuan një “Strategji për riintegrimin e personave të riatdhesuar” (Strategjia); në prill 2008 u miratua Plani i Veprimit dhe Buxheti për zbatimin e Strategjisë.⁵¹ Sipas autoriteteve kosovare, Strategjia ka të bëjë me personat me origjinë nga Kosova që jetojnë në vende të tjera ku nuk kanë status ligjor ose të drejtë qëndrimi, shumica e të cilëve do të “riatdhesohen jovullnetarisht”.⁵²

Strategjia përcakton rolet dhe përgjegjësitë e autoriteteve të qeverisë së Kosovës për riintegrimin e të kthyerve, ku përfshihen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Ministria e Arsimit, dhe komunat. Ajo jep udhëzime dhe rekomandime për të gjitha aspektet e riintegrit, përfshirë edhe asistencën e pritjes fillestare; riintegrimin ligjor; transportin pas mbërritjes; banim të përkohshëm; qasje në shërbimet civile dhe dokumentacion; qasje në shërbimin shëndetësor, punësim, arsim dhe mirëqenia sociale; transport për pakicat;⁵³ grupet e rrezikuara; banim social dhe çështjet pronësore.

Përveç kësaj, në vitin 2009, u krijua një Zyrë e re për Kthim dhe Komunitete në zyrën e Kryeministrit, me rol bashkërendues, ku përfshihen edhe mbështetja e planeve komunale për kthim dhe riintegrim.

Shumë prej personave të kthyer me detyrim në Kosovë, sidomos ata të cilët vendi pritës i ka kthyer me anë të bastisjeve të policisë në orët e hershme të mëngjesit, shpesh kthehen veç me teshat e trupit e asgjë tjetër. Sipas Bekim Sylës, nga Qendra për Dokumentim e Romëve dhe Ashkalinjve (QDRA), personave të kthyer ka filluar t’u jepet ndihmë në aeroporti e Prishtinës (Sllatinë) vetëm që nga janari 2010. “Projekt 03”, një kompani private e kontraktuar nga Ministria e Brendshme ofron deri në shtatë ditë akomodim në hotele të vogla afër Aeroportit të Prishtinës dhe/ose transport për në vendin e origjinës të personit të kthyer.

⁵⁰ Kjo shumë të hollash ndryshon në varësi të llojit të programit të kthimit.

⁵¹ UNMIK-u dhe Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, Strategjia për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, miratuar nga qeveria e Kosovës më 10 tetor 2007.

⁵² Përkufizuar si: “Persona me status ligjor jashtë vendit janë ata persona që nuk kanë plotësuar ose nuk plotësojnë më kushtet përkatëse për të qëndruar në territorin e vendeve të tjera sepse: kanë hyrë ilegalisht; kanë tejkaluar kufijtë e qëndrimit ose u ka skaduar leja e qëndrimit; u është refuzuar kërkesa për azil politik; u është anuluar leja e qëndrimit për shkak të veprimtarive kriminale ose arsyeve të tjera (persona *non grata*).” Qeveria e Kosovës, *Strategjia për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (Strategjia për riintegrim)*, prill 2010.

⁵³ Për shkak se vazhdon të mungojë liria e lëvizjes, shumë pjesëtarë të pakicave nuk e përdorin transportin publik; Strategjia parashikon ofrimin e transportit për të kthyerit për t’i çuar në destinacionin e tyre në Kosovë.

Por, mbi bazat e intervistave me të kthyerit dhe me OJQ-të e romëve, jo të gjithë personat e kthyer priten në aeroport ose u jepet informacion.⁵⁴

Edhe ajo asistencë që jepet nuk është konsistente, dhe shpesh bëhet mbi baza *ad hoc*; për shembull, Amnesty International foli me dy të rinj romani, njëzet e ca vjeçarë, që ishin kthyer me të njëjtin avion nga Gjermania në maj 2010. Të dy i kishte marrë policia kundër vullnetit të tyre në orët e para të mëngjesit, por kur mbërritën në Kosovë, njërit i kishin dhënë gjashtë muaj qira dhe asistencë financiare; tjetri kishte marrë vetëm 350 euro nga Organizata Ndërkombëtare e Migrimit (ONM), megjithëse shtëpia e mëparshme e familjes së tij në Plemetinë, ku banonte, ishte krejt e rrënuar, pa dyer e pa dritare. Në fakt, shumica e të kthyerve romë dhe ashkali, që intervistoi Amnesty International, kishin marrë shumë pak ose aspak asistencë: Faik Berisha, një rom nga Fushë Kosova/Kosovo Polje, kishte jetuar në Gjermani për tetë vjet. Ai i tha Amnesty International se as ai, e as ndokush tjetër prej dhjetë pjesëtarëve të familjes së tij, nuk kishin marrë ndonjë ndihmë apo përkrahje. Nga ana tjetër, personat që kthehen nga katër Lande të veçanta gjermane, marrin ca ndihma financiare, ushqime, dhe u ofrohen projekte për gjenerimin e të ardhurave për gjashtë muaj nga URA2, një projekt riintegrimi i financuar nga shteti gjerman.

Në një intervistë me Amnesty International në shkurt 2009, Drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe Kontrollit të Kufijve pranoi që, me përjashtim të ministrisë së tij, ministritë e tjera përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve dhe asistencës për personat e kthyer, nuk i kishin fondet e nevojshme për t'i kryer këto përgjegjësi. Që nga ajo datë, është bërë e qartë se vetëm elementi i ripranimit në Strategji është funksional. Kjo u konfirmua në një intervistë të bërë në qershor 2010 me një zyrtar të Ministrisë së Brendshme, i cili pranoi se as MPMS, as Ministria e Qeverisjes Lokale, e as autoritetet komunale, nuk kanë marrë masa për të përmbushur përgjegjësitë e tyre sipas Strategjisë së Riintegritimit të 2007-s.

Florimin, një burrë ashkali, e kthyen nga Gjermania në Kosovë në prill 2010. Ai i tha Amnesty International, *“Kam jetuar në Gjermani për 20 vjet. Të pesë fëmijët e mi u lindën dhe kanë shkuar në shkollë atje. Unë kam punuar atje deri sa nuk kishim më të drejtën për të punuar, për shkak të gjithë të papunëve gjermanë. Na dhanë “Duldung”. Gruan dhe fëmijët i kthyen me 17 mars 2010, kurse unë qëndrova, punova në një ndërtim për një farë kohe. Pastaj vendosa të kthehem; erdha vullnetarisht. Jam me origjinë prej Vushtrrie [prej nga shqiptarët etnikë i dëbuan ashkalinjtë në vitin 2004], dhe ende kam pak tokë në një fshat aty afër, por atje nuk ka më ashkalinj.”*

Si i kthyer vullnetar, Florimi duhet të kishte marrë asistencë nga UNHCR-ja dhe Ministria për Kthim dhe Komunitete. Por, Florimi i tha Amnesty International, *“kam shkuar tek Ministria për Kthim dhe Komunitete dhe tek OSBE-ja, për t'u kërkuar të më regjistrojnë fëmijët në shkollë. Kam marrë një lloj ndihme për qiranë e banesës nga një OJQ gjermane, por kaq, asgjë më tepër”.*

Mungesa e asistencës së bashkërenduar u theksua në Vlerësimin që Ministria e Brendshme i bëri Strategjisë për Kthim dhe Riintegrim të vitit 2010. Sipas këtij vlerësimi, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), që u ngarkua me “përgjegjësinë kryesore të pranimit

⁵⁴ Deri në qershor 2010 nuk kishte fletushkë informative: OSBE-ja informoi Amnesty International që po punonin për të hartuar një fletushkë bashkë me ministritë përkatëse.

dhe integritit fillestar të personave të riatdhesuar”, nuk kishte krijuar “një metodologji të planifikuar mirë dhe të qëndrueshme”, kishte fonde të pamjaftueshme, dhe nuk kishte dërguar ekipe pritëse në kufi. Përveç kësaj, sistemet e MPMS-së për t’i regjistruar dhe përcjellë personat e kthyer, për t’u siguruar atyre qasje në shërbime, u vlerësua si “e paqartë, jo plotësisht transparente dhe e vështirë për t’u përcjellë”.⁵⁵ Më tej, sipas Ministrisë së Brendshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, që është përgjegjëse për t’u dhënë të kthyerve një paketë informacioni fillestare dhe për t’u siguruar atyre qasje në shërbimet lokale, kishte, sipas përshkrimit të një zyrtari të Ministrisë së Brendshme, “një metodë pune spontane”, nuk kishte buxhet për riintegrimin, dhe nuk kishte përmbushur përgjegjësitë e saj ndaj personave të kthyer me forcë.⁵⁶

Nazrim Stola kishte shkuar në Gjermani në vitin 1999; në shtator 2009 u kthye “vullnetarisht” në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, dhe jo në shtëpinë e tij të paraluftës, në Prishtinë. Sipas Nazrim Stolës, atij i kishin premtuar asistencë, por kjo ishte vetëm ndihmë me qiranë për gjashtë muaj dhe pak ndihmë për marrjen e dokumenteve. Ai i tha Amnesty International. “Një OJQ gati sa nuk më nxori me forcë nga zyra”.

Sipas Strategjisë për Kthim dhe Riintegrim, pas marrjes së vendimit për ripranim (shih më poshtë), komunat janë përgjegjëse për bashkërendimin me të gjitha autoritetet qendrore për t’u përgatitur për riintegrimin pa vonesë të personave të ripranuar në komunat përkatëse.

“Strategjitë komunale për kthimin, edhe kur miratohen, nuk zbatohen plotësisht. Udhëzimet dhe mbështetja autoriteteve qendrore mbeten të pamjaftueshme dhe mungesat e burimeve financiare vazhdojnë. Nuk ka sinergji midis kornizave të miratuara për kthimet vullnetare dhe kthimet me forcë. Personat e riatdhesuar nuk kanë qasje në banesa të përkohshme. Personat që kanë nevojë për trajtim mjekësor jo gjithmonë trajtohen. Nuk ka mekanizëm për monitorimin e riintegritit.” Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën, tetor 2009.⁵⁷

Mos-zbatimi i Strategjisë për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar nga komunat u kritikua rëndë nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në nëntor 2009. Ata panë se ndonëse disa komuna kishin miratuar strategjitë e kthimit, të pakta janë ato komuna që kishin marrë masa për të ndihmuar personat e kthyer. OSBE-ja raportonte se “Autoritetet lokale të Kosovës nuk përmbushin detyrimet e tyre” ndaj personave që kthehen në Kosovë. Megjithatë, ata ia vinin fajin qeverisë: “Qeveria e Kosovës miratoi një plan veprimi që përfshin një buxhet për zbatimin e Strategjisë për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, por nuk ka marrë masat për të njoftuar institucionet përkatëse komunale për përgjegjësitë e

⁵⁵ Për këtë dhe për të meta të tjera të mëdha, shih Qeveria e Kosovës, Ministria e Mbrojtjes, “Vlerësimi i mekanizmit për riintegrimin e personave të riatdhesuar: sigurimi i trajtimit më të mirë të mundshëm dhe respektimit të të drejtave të njeriut për të gjithë personat e riatdhesuar”, prill 2010 (prej këtej e tutje, *Vlerësimi i Riintegritit*), f. 12-13, marrë nga http://www.esiweb.org/pdf/schengen_white_list_project_final_assessment_of_mechanism_for_reintegration_of_repatriated_persons.pdf

⁵⁶ *Vlerësimi i Riintegritit*, f. 8.

⁵⁷ Komisioni i Komuniteteve Evropiane, *Kosovo Under UNSCR 1244/99 2009 Progress Report* (Raport Progresi Kosova nën UNSCR 1244/99 2009), SEC(2009) 1340, 14 tetor 2009, f. 19, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/ks_rapport_2009_en.pdf

tyre. Ende nuk ka burime në dispozicion për integrimin e personave të riatdhesuar.”⁵⁸ OSBE-ja raporto i se pak masa ishin marrë për zbatimin e Strategjisë dhe se nuk ishte marrë asnjë masë (përveç se nga OJQ-të) për të siguruar qasje në nivel komunal në procedurat e kërkuara për të regjistruar gjendjen civile apo vendbanimin. Masa nuk ishin marrë as në “fushat kyçe të shëndetësisë, arsimit, punësimit dhe banimit”. Për më tepër, autoritetet komunale nuk kanë caktuar fonde buxhetore, e as nuk janë krijuar mekanizmat referuese të përcaktuara në Strategji.⁵⁹

“Problemi është komuna – ata e dinë sa njerëz kanë nevojë për asistencë, por nuk ia kalojnë këto të dhëna Ministrisë dhe nuk kërkojnë asistencë ose burime.” M. M., Fushë Kosovë⁶⁰

Intervistat me përfaqësues romë të komunës së Fushë Kosovë /Kosovo Polje në qershor, e konfirmuan këtë shqetësim. “Fushë Kosova nuk ka as plan, as strategji e as fonde; megjithëse ka nënshkruar marrëveshjen me qeverinë, komuna nuk është në gjendje të merret me [kthimet]”, i tha një vëzhgues komunal nga një organizatë ndër-qeveritare Amnesty International, “Komuna mban një regjistër të të gjitha ankesave të [të kthyerve] por asgjë nuk bëhet; ata nuk ia kalojnë kërkesat Ministrisë së Arsimit ose Shëndetësisë.”

Amnesty International përshëndet faktin që në prill 2010, pas vlerësimit të procesit të riintegrimin nga Ministria e Punëve të Brendshme,⁶¹ është hartuar një Strategji e Rishikuar për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar. Kjo Strategji e 2010-ës – e mbështetur në vlerësimin që i bëri Ministria strategjisë së mëparshme – njehtë metat e periudhës së mëparshme dhe, bazuar në këtë analizë, u jep rekomandime dhe udhëzime më rigorozë ministrive dhe autoriteteve përgjegjëse komunale.

Strategjia për Riintegrimin e vitit 2010, për shembull, përfshin angazhime si: të gjithë personat do të priten dhe do të marrin informacion nga punonjës të institucioneve lokale, si edhe nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), në aeroport dhe në pika të tjera kufitare; personave të kthyer do t'u jepen informacion dhe broshura të përditësuara, përfshirë edhe një pasqyrë të shërbimeve në Kosovë dhe në komunën ku do të shkojnë. Përveç kësaj, MPMS duhet të mbajë të dhëna statistikore për të kthyerit (përfshirë destinacionin; gjendjen shëndetësore ose nevojat e veçanta; nevoja për transport ose banim të përkohshëm); ky informacion pastaj duhet t'u shpërndahet institucioneve përkatëse, ndër të cilat edhe komuna e destinacionit.

⁵⁸ Misioni i OSBE-së në Kosovë, Background Report, Human Rights, Ethnic Relations and Democracy in Kosovo (Raport informativ, të drejtat e njeriut, marrëdhëniet etnike dhe demokracia në Kosovë), (Verë 2007 – Verë 2008).

⁵⁹ Misioni i OSBE-së në Kosovë, Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete, *Zbatimi i Strategjisë për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në Komunitetet e Kosovës*, nëntor 2009.

⁶⁰ Intervistë e Amnesty International, qershor 2010.

⁶¹ Qeveria e Kosovës, Ministria e Brendshme, “Vlerësimi i mekanizmit për riintegrimin e personave të riatdhesuar: Sigurimi i trajtimit më të mirë të mundshëm dhe respektit për të drejtat e njeriut për të gjithë personat e riatdhesuar”, prill 2010.

Megjithatë, Amnesty International thekson se dhënia e kësaj asistence në praktikë do të varet nga kapaciteti i ministrive për të kryer përgjegjësitë e tyre dhe nga financimi i kësaj ndihme - që sot për sot nuk është i disponueshëm.

5. MOS-SIGURIMI I KUSHTEVE PËR KTHIMIN E QËNDRUESHËM DHE RIINTEGRIMIN E PAKICAVE

Në vitin 1999 bashkësia ndërkombëtare (përfshirë edhe Misionin e Përkohshëm Administrativ të KB-së në Kosovë [UNMIK] dhe KFOR-i i drejtuar nga NATO) morën detyrën e “sigurimit të kthimit të sigurt dhe të papenguar të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre në Kosovë”.⁶² Një dhjetëvjeçar më vonë, kjo vazhdon të jetë ende një aspiratë e paplotësuar.

E drejta e kthimit përcaktohet në standardet ndërkombëtare, ndër të cilat Neni 12 (4) i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP) dhe Neni 5 (d) ii i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (KNEDR). Ndonëse Kosova nuk është palë nënshkruese e këtyre konventave, të dyja janë përfshirë në ligjet që janë në fuqi në Kosovë.⁶³

Në vitin 2008, përgjegjësia për të kthyerit u transferua nga UNMIK-u tek qeveria e Kosovës. Megjithatë, pavarësisht nga miratimi i Politikës për Kthim dhe Riintegrim (që u miratua së bashku me UNMIK-un në nëntor 2007, dhe që më vonë u rishikua në prill 2010), dhe miratimi i Ligjit për Ripranimet më 25 qershor 2010, autoritetet e Kosovës nuk u kanë garantuar të drejtën e kthimit serbëve, romëve dhe pakicave të tjera, sepse vazhdojnë të mos sigurojnë kushtet për kthimin e tyre të sigurt dhe të qëndrueshëm.⁶⁴

⁶² Neni 11.k i Rezolutës 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për krijimin e një administrate ndërkombëtare në Kosovë; Rezoluta 1244 (1999), e miratuar nga Këshilli i Sigurimit në mbledhjen e tij të 4011-të më 10 qershor 1999, S/RES/1244 (1999), marrë nga <http://daccess-ods.un.org/TMP/6589749.html>; S/1999/779.

⁶³ ICCPR, Neni 12 (4): “4. Askush nuk duhet të privohet në mënyrë arbitrare nga e drejta për të hyrë në vendin e vet.”; Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor (KEDR), Neni 5: “Në përputhje me obligimet themelore të përcaktuara në Nenin 2 të kësaj Konvente, Shtetet Palë angazhohen të ndalojnë dhe të eliminojnë diskriminimin racor në të gjitha format e tij dhe të garantojnë të drejtën e të gjithëve, pa dallim race, ngjyre, ose origjine kombëtare ose etnike, për të qenë të barabartë para ligjit, sidomos në gëzimin e të drejtave të mëposhtme: ... (d) të drejta të tjera civile, në veçanti: (ii) E drejta për të lëshuar çdo vend, përfshirë vendin e vet, dhe për t’u kthyer në vendin e vet.” Për zbatueshmërinë e këtyre traktateve në Kosovë, shih Nenin 22 [Zbatueshmëria e drejtpërdrejtë e marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare] *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*.
<http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Constitution.of.the.Republic.of.Kosovo.pdf>

⁶⁴ Qeveria e Kosovës, Ministria e Brendshme e Kosovës, *Vlerësim i Mekanizmave për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar*, prill 2010; Ligji për Ripranim <http://www.assembly->

Në pjesët e raportit që vijojnë, Amnesty International do të tregojë që, pavarësisht se, ndër të tjerë, romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit mund të përballen me rrezikun e vërtetë të persekutimit pas kthimit në Kosovë; në fakt, kushtet për kthimin e tyre të qëndrueshëm mungojnë. Kjo analizë mbështetet në raportet e organizatave jo qeveritare (OJQ-të) lokale dhe ndërkombëtare dhe intervistat me zyrtarë dhe persona të kthyer, të kryera në qershor 2010.

5.1 DISKRIMINIM I PËRHAPUR DHE SISTEMATIK

Romët që jetojnë sot në Kosovë, por në veçanti romët e kthyer, përballen me çka UNHCR-ja i ka përshkruar si “veprime diskriminuese kumulative”.⁶⁵ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka kohë që konsideron se diskriminimi mund të përbëjë trajtim degradues, në kundërshtim me Nenin 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në veçanti, Gjykata përcakton se nëse një popullatë është e dënuar të jetojë në kushte poshtëruese, që shkelin vetë nocionin e respektit për dinjitetin njerëzor të anëtarëve të asaj popullate, një trajtim i tillë diskriminues përbën trajtim poshtërues sipas Nenit 3 të Konventës.⁶⁶

Ndonëse organizata është e vetëdijshme se qeveria e Kosovës nuk është në gjendje të sigurojë të drejtat bazë sociale dhe ekonomike për shumicën e qytetarëve të vet, komunitetet rome, ashkali dhe egjiptase janë më të marginalizuarat dhe më të pafavorizuarat në Kosovë. Ata përballen me diskriminim të përhapur dhe sistematik sa i takon qasjes së tyre në të drejtat civile, politike, sociale, ekonomike dhe kulturore. Po kështu, gratë dhe vajzat e këtyre komuniteteve përjetojnë diskriminim edhe më të madh për shkak të gjinisë së tyre.

Romët, në veçanti, përballen me diskriminim më të madh për shkak të asociimit të tyre me serbët e Kosovës. Duke qenë se shumica e tyre flasin serbishten (ose një version të gjuhës rome që i afrohet serbishtes) dhe jetojnë në zonat serbe të Kosovës, ata ende shihen si aleatë të komunitetit serb, madje edhe nga disa zyrtarë qeveritarë.⁶⁷

kosova.org/common/docs/ligjet/2010-208.pdf (kjo faqe interneti nuk është përditësuar qysh prej 1 shtatorit 2010, aty ai vazhdon të jetë i klasifikuar si projekt ligj).

⁶⁵ “UNHCR-ja mendon se grupet e cekura në këtë seksion përballen me rrezik të veçantë persekutimi dhe lëndimi serioz në Kosovë, përfshirë edhe përmes veprimeve diskriminuese kumulative.” UNHCR, *Kriteret Përzgjedhëse*, 2009, f. 17.

⁶⁶ Shkelja e Nenit 3 të KEDNJ-së mbështetet në Vendimin e Trupit Madhor Gjykses të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në rastin e *Qipros kundër Greqisë*. Shih edhe Minority Rights Group, *European states regularly force Roma to return to Kosovo, where they face widespread discrimination* (Grupi për të Drejtat e Pakicave, *Shtetet evropiane rregullisht i detyrojnë romët të kthehen në Kosovë ku ata përballen me diskriminim të përhapur*), 13 gusht 2009, <http://www.minorityrights.org/8075/minorities-in-the-news/european-states-regularly-force-roma-to-return-to-kosovo-where-they-face-widespread-discrimination.html>.

⁶⁷ Amnesty International është e brengosur për shprehjet e pamenduara raciste të disa zyrtarëve qeveritarë dhe personave të tjerë me kombësi shqiptare, që sugjerojnë se ndër personat e kthyer të komunitetit rom ka “kriminelë luftë” që nuk duhet të lejohen të kthehen në Kosovë. Ndonëse qëndrimi zyrtar i autoriteteve të Kosovës është që të nxisë kthimin e romëve, Amnesty International vëren me shqetësim të veçantë vërejtjet për rolin e romëve në konfliktin e 1999-s, të bëra nga një zyrtar i qeverisë

Sipas Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara, komunitetet rome, ashkali dhe egjiptase kanë dy herë më shumë gjasa të jenë në 15 përqindëshin e popullatës së Kosovës që jeton në varfëri të skajshme, se sa grupet e tjera etnike. Një hulumtim i vitit 2009, i botuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) thotë se - mbështetur në të ardhurat familjare - secili individ në këto komunitete jeton me më pak se 0,71 euro në ditë (21,37 euro në muaj).⁶⁸ Pak romë janë në gjendje të gëzojnë të drejtat bazë civile dhe politike, përfshirë edhe të drejtën për pjesëmarrje politike. Ata, dhe komunitetet e tjera të pakicave jo-serbe, nuk morën pjesë në bisedimet e vitit 2007 për statusin përfundimtar të Kosovës dhe në konsultimet për kushtetutën në vitin 2008.⁶⁹

Po kështu, ata nuk mund të gëzojnë të drejtën e lëvizjes së lirë; shumë pak prej tyre dalin jashtë komuniteteve ose enklavave ku jetojnë. Raportimet e sulmeve me bazë etnike kundër këtyre komuniteteve janë të pakta, por siç shprehet Komiteti Këshillues për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, “Ndonëse perceptimet dhe frika kontribuojnë në kufizimin e ushtrimit të së drejtës së lirisë së lëvizjes së personave që i përkasin disa komuniteteve të pakicave, tensionet e vazhdueshme ndër-etnike, të metat në hetimin e krimeve me motive etnike dhe fetare dhe barrierat gjuhësore, përbëjnë pengesa serioze për personat që i përkasin disa komuniteteve të caktuara të pakicave që të lëvizin lirisht.”⁷⁰

Romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve u mohohen gjithashtu edhe të drejtat themelore ekonomike, sociale dhe kulturore, të përcaktuara në Konventën Ndërkombëtare të të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (shih më poshtë në seksionet: e drejta për arsim, Neni 10, KNDESK), ndër të cilat arsimimi i të rriturve; e drejta për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit (Neni 12, KNDESK); e drejta për banim të përshtatshëm (Neni 11, KNDESK); dhe e drejta e punës (Neni 6, KNDESK) dhe Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor.⁷¹

në intervistën me Amnesty International në shkurt 2009. Për qëndrimin zyrtar të qeverisë, shih për shembull, <http://www.kosovotimes.net/interviews/590-kosovo-institutions-want-the-return-of-all-kosovo-serbs-and-others.html>

⁶⁸ Shih UNDP Kosovë, Raportet e Zhvillimit Njerëzor, <http://www.ks.undf.org/?cid=2,142>; Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS (SOROS), *Gjendja e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë*, 2009 f. 21, http://www.kfosweb.info/pdf/The%20Position%20of%20RAE%20Communities%20in%20Kosovo%20Baseline%20Survey_ENG.pdf

⁶⁹ Komiteti Këshillues për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Opinioni i Dytë për Kosovën, miratuar më 5 nëntor 2009, ACFC/OP/II(2009)004, 31 maj 2010, paragrafët 252-8, (këtej e tutje, Opinioni i Dytë për Kosovën) http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/3_FCNMdocs/PDF_2nd_OP_Kosovo_en.pdf

⁷⁰ Opinioni i Dytë për Kosovën, paragrafi 20, f. 6-7.

⁷¹ Ndonëse KNDESK nuk është ndër traktatet ndërkombëtare të cekura në Nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës si të zbatueshme drejtpërsëdrejti ë Kosovë, Neni 16. 3 thotë, “Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare”. <http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Constitution.of.the.Republic.of.Kosovo.pdf> Po kështu,

Megjithëse dispozitat dhe standardet e së drejtës ndërkombëtare dhe rajonale, përfshirë ato për mos-diskriminimin, janë të përfshira në legjislacionin kombëtar, ato nuk zbatohen në praktikë. Ligji Kundër Diskriminimit (LKD) i Kosovës i vitit 2004, nuk është vënë plotësisht në funksionim, ka mungesa në zbatim dhe nuk ofron të drejta të mjaftueshme për kompensim apo kërkimin drejtësisë. Më tej, pavarësisht nga miratimi i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në vitin 2006, që synon të mbështesë përdorimin publik të gjuhëve të pakicave dhe ndalon diskriminimin mbi baza të gjuhës, komunitetet jo-shqiptare, përfshirë romët, e kanë të vështirë të kenë shërbime në gjuhën e tyre.⁷²

Masat kundër diskriminimit të romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve janë parashtruar në *Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës, 2009 – 2015*, botuar në dhjetor 2008. Në dhjetor 2009, Kuvendi i Kosovës miratoi një Plan Veprimi për Implementimin e kësaj Strategjie dhe në fillim të qershorit 2010, Kryeministri miratoi një grup punues ndër-ministror, por ende nuk ishte krijuar një komitet ndër-institucional për monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë. Për zbatimin e këtij plani janë bërë angazhime financiare nga Fondacioni Soros në Kosovë (KFOS, që do të kontribuojë 1,2 milion euro) dhe përmes Instrumentit të Asistencës Para-Anëtarësimit të BE-së (IPA).⁷³ Megjithatë, masat e përcaktuara në Strategji- zbatimi i të cilave do të bëhet në një periudhë pesë vjeçare – ende nuk kanë filluar të merren.⁷⁴

Komiteti Këshillues i Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare shprehej kështu në përfundimet e veta të qershorit 2010: “Gjendja e përgjithshme e romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve ngre shqetësime të mëdha. Personat që i përkasin këtyre grupeve janë shumë më të prekur nga varfëria dhe përjashtimi shoqëror se sa personat që u përkasin komuniteteve të tjera. Shumë prej tyre vazhdojnë të përballen me diskriminim për sa i përket qasjes në tregun e punës, banim dhe arsim, dhe shpesh përballen me paragjykimë dhe qëndrime armiqësore.

KDESK-u, në nëntor 2008 mori në shqyrtim një dokument të dorëzuar nga UNMIK-u: *Zbatimi i Konventës Ndërkombëtare të të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, KOSOVA (SERBIA)*, E/C.12/UNK/1, 15 janar 2008, <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G08/410/38/PDF/G0841038.pdf?Element> i Hapur. Shih edhe *Konsiderata të Raporteve të Dorëzuara nga Shtetet Palë sipas Neneve 16 dhe 17 të Dokumentit të Konventës të Dorëzuar nga Misioni i Përkohshëm Administrativ i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), Vëzhgime Përfundimtare të Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*, E/C.12/UNK/CO/1, 1 dhjetor 2008, (këtej e tutje KDESK, *Komentet Përfundimtare*), <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G08/456/24/PDF/G0845624.pdf?OpenElement>

⁷² Shih për shembull, KDESK, *Komentet Përfundimtare*, paragrafi 9: zbatueshmëria e standardeve ndërkombëtare; paragrafi 12: Zbatimi i LKD; *Opinion i Dytë për Kosovën*, paragrafët 172-178, f. 32-33: Ligji për Përdorimin e Gjuhëve; paragrafi 73, f. 15: zbatimi i LKD.

⁷³ Fondet IPA u jepen si vendeve kandidatë për anëtarësim në BE, ashtu edhe vendeve kandidatë potenciale për anëtarësim në BE; një prej objektivave të tyre është “promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe një respektim më i madh i të drejtave të pakicave”.

⁷⁴ Disa nga masat e identifikuar në këtë Strategji përsërisin ato të parashikuara në Strategjinë e Riintegritimit, për shembull, në ofrimin e mësimit të gjuhës shqipe për personat e kthyer. Amnesty International u bën thirrje ministrive përkatëse të bashkërendojnë veprimet e tyre në këtë drejtim.

Vështirësitë në marrjen e dokumenteve të identifikimit dhe dokumenteve të tjera, pengojnë qasjen e tyre në disa prej shërbimeve publike dhe pronave. Cilësia e dobët e arsimit ka çuar në përqindje të larta të braktisjes së shkollës dhe frekuentim të dobët në shkollë të fëmijëve që u përkasin këtyre komuniteteve të pakicave.”⁷⁵

5.2 DOKUMENTACIONI: E DREJTA PËR IDENTITET LIGJOR

“Kam kryer tre vjet studime në fakultet, por diploma dhe të gjitha dokumentet e tjera u dogjën gjatë luftës; nuk ka asnjë shans t’i marr prapë”, i tha Florimi Amnesty International. Ai u kthye vullnetarisht në Kosovë më 17 mars 2010 dhe u ripranua mbi bazën e pasaportës së tij jugosllave. Në qershor 2010, ai ende nuk i kishte dokumentet që i duheshin për të pasur qasje në shërbime dhe punësim. Ai i tha Amnesty International se i kishte kërkuar ndihmë OSBE-së dhe [Zyrës] për Refugjatët dhe Komunitetet për dokumentet, por “askush nuk ishte i interesuar të më ndihmonte”. Sipas Ministrisë së Brendshme, të kthyerit duhet të pajisen me dokumente brenda dhjetë ditësh.

Në mungesë të dokumentacionit, personat e kthyer, për shembull, nuk mund të kthehen dhe të marrin përsëri në pronësi shtëpitë ose tokën e tyre. Po kështu atyre u mohohet qasje në të drejtat bazë, si punësimi, asistenca sociale, shërbimi shëndetësor, dhe arsimi. Fëmijët e paregjistruar nuk pranohen në shkollë. Si rezultat, siç ka thënë edhe UNHCR-ja, “Vlerësimet e UNHCR-së dhe studime të tjera tregojnë se një përqindje e konsiderueshme e popullatës rome të Kosovës përballet me kufizime serioze në ushtrimin e të drejtave të tyre themelore të njeriut dhe në qasjen në përfitime sociale.”⁷⁶

Amnesty International mendon se diskriminimi që hasin personat pa dokumente mund, në fakt, të arrijë pragun për t’u quajtur persekutim ose lëndim serioz, kur rezulton në mohimin e identitetit ligjor dhe mohimin e qasjes në të drejtat bazë, që bashkëlidhet me të.

“Shumë persona të riatdhesuar kanë jetuar për dhjetë ose më shumë vjet në vende të huaja, përpara se t’u refuzohej kërkesa për azil. Shumë lindje dhe martesat janë bërë dhe regjistruar në vende të tjera. Nëse personat e riatdhesuar nuk paraqesin dokumente të huaja për të vërtetuar këto zhvillime, ata nuk do të jenë në gjendje të regjistrojnë fëmijët ose martesat e tyre pas mbërritjes në Kosovë. Kjo çështje duhet të trajtohet gjatë bisedimeve për marrëveshjet dypalëshe me vendet kërkuese.” Strategjia e Ripranimit 2010.

Hulumtimet e Amnesty International kanë identifikuar një pasojë të paqëllimshme, por sidoqoftë serioze, të mënyrës se si po zbatohen kthimet e detyruara në Kosovë. Të pa paralajmëruara dhe shpesh në orët e para të mëngjesit, kthimet e detyruara bëjnë që shpesh personat e kthyer të kenë shumë pak kohë të gjejnë dhe të marrin dokumentet personale, si për shembull, certifikatat e lindjes ose dokumente të tjera, që mund t’i ndihmojnë ata të marrin dokumentet kur arrijnë në Kosovë.

Një numër i konsiderueshëm i popullatës rome, ashkali dhe egjiptase që tashmë jetojnë në Kosovë, nuk i kanë këto dokumente dhe vazhdojnë të jenë pa njohjen e statusit të tyre ligjor.

⁷⁵ *Opinion i Dytë për Kosovën*, paragrafi 18, f. 6.

⁷⁶ UNHCR Kriteret Përzgjedhëse 2009, f. 14, referuar nga http://www.unicef.org/ceecis/UNICEF_Birth_Registration_2009_English.pdf.

Në vitin 2008 afërsisht 30 deri 40 për qind e popullatës ekzistuese rome, ashkali dhe egjiptase, nuk ishin regjistruar në regjistrat e gjendjes civile (të lindjeve, martesave, vdekjeve) dhe as nuk ishin të regjistruar si banorë të përhershëm të Kosovës. Pas një programi për t'u dhënë romëve këshillim dhe ndihmë ligjore falas për regjistrimin, i financuar që nga viti 2007 nga UNHCR-ja dhe organizma të tjerë, si Këshilli i Refugjatëve i Norvegjisë, dhe i zbatuar nga Programi i të Drejtave Civile – Kosovë (PDC-K), në prill 2010 llogaritej që rreth 20 për qind vazhdonin të ishin pa dokumente.⁷⁷

Në studimin e tij të botuar në korrik 2010, UNICEF-i raportonte se përqindja e personave të kthyer që nuk kanë dokumente personale, është më e madhe se sa përqindja e personave pa dokumente në popullatën rezidente.⁷⁸ Dokumentet e kërkuara nga Ministri i Brendshëm për të përcaktuar nëse një individ ka të drejtën e shtetësisë (shih më poshtë), nuk garantojnë automatikisht shtetësinë ose të drejtën e banimit. Këto dokumente duhet të merren nga vetë individët. Ndonëse në teori, qasja në këto dokumente duhet të lehtësohet nga komunat, në praktikë nuk ndodh gjithmonë ashtu. Për më tepër, pavarësisht nga një rekomandim i qeverisë që komunat të mos marrin pagesë ose të marrin pagesë të reduktuar për marrjen e dokumenteve që nevojiten për vërtetimin e shtetësisë dhe vendbanimit në raste të tilla, pak komuna e kanë bërë këtë.

Sipas OSBE-së, në vitin 2009 vetëm në shtatë komuna qendrat e regjistrimit civil ose punonjësit e gjendjes civile ishin në gjendje t'u jepnin informacion të kthyerve për mënyrën se si dhe ku të regjistrojnë gjendjen e tyre civile dhe vendbanimin. Megjithatë, disa prej tyre kishin krijuar një bashkëpunim me UNHCR/PDC-K, të cilët pastaj ofronin ndihmë për plotësimin e formularëve të duhur, marrjen e dokumenteve, dhe në disa raste, gjetjen e dëshmitarëve për të dëshmuar për identitetin e atyre që nuk kishin dokumente personale.⁷⁹

Amnesty International thekson se, duke pasur parasysh numrin e mundshëm të personave të kthyerve me detyrim dhe se shumë prej atyre që detyrohen të kthehen ose nuk kanë dokumente (përveç atij që duhet për të provuar se kanë të drejtën ligjore të jetojnë në Kosovë), autoritetet - përfshirë edhe ata në nivel komunal dhe në veçanti Zyrat Komunale të Regjistrimit Civil - duhet të zhvillojnë kapacitetet e tyre dhe t'i kushtojnë burime më të shumta sigurimit që të gjithë të kthyerit të pajisen menjëherë me "dokumente të gjendjes civile që janë parakusht për qasje në shërbimet e tjera komunale."⁸⁰

Amnesty International është e shqetësuar se duke mos pasur qasje në kotë dokumente, të kthyerit efektivisht mund të mbeten pa shtetësi.

⁷⁷ Intervistë e Amnesty International me UNHCR Prishtina, qershor 2010.

⁷⁸ UNICEF, *Integration unter Vorbehalt* (Integrim me rezerva) .

⁷⁹ OSBE, *Zbatimi i Strategjisë për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në Komunitet e Kosovës*, 2009, f. 9.

⁸⁰ *Strategjia e Riintegrimit 2010*, paragrafi 3.1.a.

5.3 RREZIKU I MBETJES PA SHTETËSI

Amnesty International është e shqetësuar se shumë prej romëve, ashkalinjve dh egjiptasve që vendet anëtare të BE-së duan t'i kthejnë në Kosovë mund të jenë të rrezikuar të mbeten pa shtetësi *de jure* ose *de facto*.⁸¹

Ligji për Ripranim përcakton procedurat për të verifikuar nëse personat, për të cilët kërkohet ripranim në Kosovë nga shtetet dërguese, janë nga Kosova, ose, nëse kanë të drejtë të ligjshme të marrin shtetësinë për arsye të tjera. Kjo përcaktohet në Ligjin për Shtetësinë e Kosovës të vitit 2008, që u njehtë drejtën e shtetësisë personave të regjistruar tek autoritetet civile ose që kanë prova për banim të përhershëm në Kosovë që nga janari 1998.

Ligji për Ripranim u hartua në bazë të rekomandimit të Komisionit Evropian dhe me miratimin e tij, dhe më vonë u miratua nga Kuvendi i Kosovës në qershor 2010, duke inkorporuar parimet bazë të Politikës së Ripranimit të 2007-s në ligj.⁸² Neni 3 i Ligjit për Ripranim të 2010-s thotë se:

“1. Autoriteti kompetent do të ripranojë në territorin e tij shtetasin i cili nuk përmbush ose nuk përmbush më kushtet në fuqi për hyrje apo qëndrim në territorin e shtetit kërkues.

2. Dëshmia për shtetësinë do të vërtetohet ose në mënyrë të arsyeshme prezumohet kur personi ka shtetësinë ose ka të drejtë që të marr shtetësinë e Republikës së Kosovës sipas nenit 28 dhe 29 të Ligjit për Shtetësinë e Kosovës”.⁸³

Procedurat për përcaktimin e të drejtës së shtetësisë përfshijnë verifikimin e dokumenteve të identifikimit (si certifikatat e lindjes, letërnjoftimet, dokumentet e udhëtimit të lëshuara nga UNMIK-u, lejet e vozitjes, etj.) duke i krahasuar ato me regjistrat e gjendjes civile, regjistrat komunalë, ose baza të tjera të dhënash. Nëse identiteti i një personi nuk mund të konfirmohet me anë të këtyre burimeve, Policia e Kosovës (pjesë e Ministrisë së Brendshme) do të kryejë një “verifikim në komunitet”, duke vizituar vendbanimin e përhershëm në Kosovë

⁸¹ Nuk ka statistika të sakta për numrin e romëve pa shtetësi. Këshilli i Evropës ka bërë përlllogaritjet e mëposhtme për Evropën Juglindore: Bosnje Hercegovina: 10 000; Mali i Zi: 1 500; Serbia: 17 000; Sllovenia 4 090 (qytetarë të ish Jugosllavisë, shumë prej të cilëve me etnicitet rom), Këshilli i Evropës: Komisioneri për të Drejtat e Njeriut, *Shumë romë në Evropë janë pa shtetësi dhe jetojnë jashtë mbrojtjes sociale*, 6 korrik 2009.

⁸² Intervistë e bërë nga Amnesty International, Ministria e Brendshme e Kosovës, maj 2010; email nga një zyrtar i Ministrisë së Brendshme, qershor 2010.

⁸³ Paragrafët operativë thonë: “Neni 29, Shtetësia sipas Dokumentit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Republikës së Kosovës, 29.1 Të gjithë personat që me 1 janar 1998 kanë qenë shtetas të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe që me këtë datë e kanë pasur banimin e përhershëm në Republikën e Kosovës konsiderohen shtetas të Republikës së Kosovës dhe regjistrohen si të tillë në regjistrin e shtetasve pa marrë parasysh vendbanimin ose shtetësinë që posedojnë aktualisht. 29.2 Dispozita e paragrafit 1 të këtij neni vlen edhe për pasardhësit e drejtpërdrejt të personave të përcaktuar në atë paragrafë.” [http://eudo-citizenship.eu/NationalDB/docs/KOS%20Law%20on%20Citizenship%20of%20Kosovo%202008%20\(Eng\).pdf](http://eudo-citizenship.eu/NationalDB/docs/KOS%20Law%20on%20Citizenship%20of%20Kosovo%202008%20(Eng).pdf)

të deklaruar nga personi, me qëllim që të vërtetohet nëse ai ose ajo janë të njohur në atë komunitet. Sipas Ministrisë së Brendshme, ky proces nuk duhet të zgjasë më shumë se 28 ditë, por Amnesty International ka dijeni për raste të raportuara nga OJQ-të lokale që kanë zgjatur për më se një vit për të vërtetuar këtë informacion.⁸⁴

Në rastin e personave që e lëshuan Kosovën përpara janarit 1998, edhe kjo procedurë mund të mos arrijë të vërtetojë të drejtën e tyre për të pasur shtetësinë. UNHCR-ja ka përlogaritur në vitin 2006 se 10 000, nga 35 000 deri në 40 000 romë, ashkali, dhe egjiptas në Kosovë, nuk kanë pasur dokumente që konfirmonin gjendjen civile dhe vendbanimin e tyre.⁸⁵ Një numër po aq i madh romësh të zhvendosur nga Kosova kohët e fundit, që jetojnë sot në Serbi, nuk kanë dokumentacion që do t'u lejonte të kërkonin shtetësinë e Kosovës.⁸⁶ Gjendja ndërlikohet më tej sepse pas konfliktit të armatosur në Kosovë, autoritetet serbe i transferuan dokumentet dhe informacionin nga qendrat e qeverisjes lokale në Kosovë në zyra paralele të gjendjes civile që gjenden në shtetin serb. Për shembull, të gjithë regjistrat për banorët e Ferizajt/Uroševac dhe Pejë/Peć u transferuan në Leskovac në Serbinë Jugore. Kështu që, romët e kthyer në Kosovë, duhet të kishin mundësi të udhëtonin në Serbi për të marrë dokumentet e tyre të paraluftës; përveç kësaj, ata duhet edhe të paguanin një tarifë për marrjen e këtyre dokumenteve.⁸⁷

Duke pasur parasysh se regjistrimi i romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve ka munguar historikisht, siç u tha edhe më lart, Amnesty International ka shqetësimin se Ligji për Ripranim nuk është i mjaftueshëm për të penguar rrezikun që personat me origjinë nga Kosova të mbeten pa shtetësi.⁸⁸

⁸⁴ Intervistë e bërë nga Amnesty International, Ministria e Brendshme e Kosovës, qershor 2010; informacion i marrë nga Programi i të Drejtave Civile – Kosovë.

⁸⁵ Që nga viti 2006, UNHCR-ja ka filluar disa programe për ndihmën ligjore dhe regjistrimin civil, të cilat zbatohen nga OJQ-ja Projekti i të Drejtave Civile, Kosovë, e cila nga viti 2006 deri në 2009 ka bërë të mundur regjistrimin e mbi 9 000 personave nga komunitetet rome, ashkali, dhe egjiptase, UNHCR Kosovë, Pasqyrë statistikore, 30 nëntor 2009.

⁸⁶ “Shumë PZHBV që jetojnë në pjesë të ndryshme të Serbisë kanë nevojë për dokumentet bazë të identitetit (si certifikata lindjeje ose certifikata shtetësie) që mund të lëshohen vetëm nga regjistrat që u transferuan nga Kosova në shtatë komunat jugore të Serbisë në vitin 1999. Shumë PZHBV, sidomos RAE [romë, ashkali dhe egjiptas], nuk janë regjistruar asnjëherë në këta regjistra”, UNHCR dhe Praxis, Analysis of the Situation of Internally Displaced Persons from Kosovo in Serbia (Analizë e situatës së personave të zhvendosur brenda vendit nga Kosova në Serbi), mars 2007, f. 11-12, <http://www.unhcr.org/refworld/docid/4704bff72.html>

⁸⁷ Shih, Praxis, *Information about Work of Administrative Bodies in Serbia Administering Registry Books from Kosovo* (Informacion për punën e organeve administrative në Serbi që administrojnë regjistrat nga Kosova), qershor 2010, http://www.praxis.org.rs/index.php?option=com_content&task=view&id=175&Itemid=73.

⁸⁸ Ligji për Ripranim nuk trajton rrezikun e mbetjes pa shtetësi. Ligji për Shtetësinë, i vitit 2008, e përmend mungesën e shtetësisë, dhe trajton të drejtën e marrjes së shtetësisë nga fëmijët me një prind pa shtetësi, shih Nenin 6: *Fitimi i shtetësisë me lindje në bazë të origjinës*: 6.1 Një fëmijë e fiton

Sipas Ministrisë së Brendshme, një numër kërkesash për ripranim janë refuzuar sepse autoritetet nuk kanë qenë në gjendje të vërtetojnë të drejtën e personit për shtetësi ose banim në Kosovë në vitin 1989. Ndonëse numri i këtyre personave që nuk kanë të drejtë ligjore për të qëndruar në vendin dërgues dhe u është refuzuar ripranimi në Kosovë, mbetet i vogël (sipas Ministrisë së Mbrojtjes, vetëm tre raste nga më shumë se 200 kërkesa të proceduara nga janari në qershor 2010), Amnesty International është e shqetësuar se në këto raste, njerëzit do të mbeten pa shtetësi. Ministria e Brendshme i tha Amnesty International gjithashtu se disa shtete po i kthejnë njerëzit me forcë në Kosovë, pa marrë paraprakisht pëlqimin e autoriteteve të Kosovës; në qoftë se nuk është përcaktuar më parë nëse ata i plotësonin kriteret për të hyrë në Kosovë, edhe këta persona mund të rrezikohen të mbeten pa shtetësi.⁸⁹

Amnesty International ka dijeni edhe për një rast në të cilin një familjeje, pasi u miratua për ripranim, më vonë nuk u lejua të hynte në Kosovë. Më 12 tetor 2009, një familje rome u kthye me detyrim nga Holanda, por iu refuzua hyrja në Kosovë në aeroportin e Sllatinës. Pasi u strehuan atë natë, ata u dërguan përsëri në Holandë me avion. Përpara deportimit, autoritetet holandeze kishin kontaktuar me Departamentin e Kosovës për Kufij, Azil dhe Migrim, i cili i kishte informuar se ishte verifikuar se origjina e familjes ishte nga Kosova dhe se Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës nuk kishte ndonjë kundërshtim që ata të ktheheshin. Por, sipas Zyrës Holandeze për Deportim dhe Kthim, zyrtarët e kufirit nuk e lejuan familjen të hynte në Kosovë për shkak të certifikatës së lindjes së babait, që thoshte se ai kishte lindur në Kroaci (në atë kohë një prej republikave të RSFJ-së), ndonëse ai dhe familja e tij kishin jetuar në Kosovë, në Pejë/Peć deri në vitin 2001. Më vonë familja bëri kërkesë për azil në Holandë mbi bazat e mungesës së shtetësisë.

Amnesty International është gjithashtu e brengosur që Marrëveshja e Ripranimit e nënshkruar midis Kosovës dhe Gjermanisë (që diskutohet më poshtë në këtë dokument) lejon mundësinë e kthimit të detyruar edhe atyre personave që konsiderohen se kanë hequr dorë nga shtetësia e Kosovës, dhe që nuk kanë ndonjë shtetësi tjetër.⁹⁰ Amnesty International mendon se në raste të tilla, shteti dërgues ka përgjegjësinë të ndërmarrë hapa për të marrë

shtetësinë e Republikës së Kosovës me lindje në se në ditën e lindjes të dy prindërit e fëmijës janë qytetarë të Republikës së Kosovës ; 6.2 Nëse në ditën e lindjes së fëmijës vetëm njëri nga prindërit e ka shtetësinë e Republikës së Kosovës, fëmija fiton shtetësinë e Republikës së Kosovës me lindje në rastet e mëposhtme: a) fëmija është i lindur në territorin e Republikës së Kosovës; b) fëmija është i lindur jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe prindi tjetër është me shtetësi të panjohur ose pa shtetësi; c) fëmija është lindur jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe prindi tjetër ka shtetësi tjetër, por ë dy prindërit pajtohen me shkrim që fëmija të fitojë shtetësinë e Republikës së Kosovës. Kjo dispozitë duhet të ushtrohet para moshës katërbëdhjetëvjeçare të fëmijut.

http://skupstinakosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L034_en.pdf

⁸⁹ Intervistë e bërë nga Amnesty International me zyrtarë të Ministrisë së Brendshme të Kosovës, qershor 2010.

⁹⁰ Neni 1, Paragrafi 2 i marrëveshjes (për referencë të plotë, shih poshtëshënimin 158 më poshtë), shtetet ku mund të kthehen personat nëse janë “zhveshur” nga shtetësia e vendit ripranues [Kosova] pas hyrjes në shtetin kërkues [Gjermani], dhe që nuk kanë fituar ndonjë shtetësi apo garanci për marrjen e shtetësisë së shtetit kërkues.

garanci nga autoritetet kosovare se individët në fjalë janë shtetas të Kosovës dhe gëzojnë të drejtën e kësaj shtetësie, përpara se t'i kthejnë; përndryshe, këtyre personave duhet të vazhdohet t'u jepet mbrojtje ndërkombëtare edhe më tej.

Duke pasur parasysh se OJQ-të vendore kanë raportuar se në disa raste mund të duhet deri në 1 vit për të përcaktuar të drejtën e rezidencës së një personi, Amnesty International mendon se Ministria e Brendshme duhet të miratojë një procedurë më të thelluar dhe më të shpejtë për të siguruar që kërkesat e personave që thonë se janë me origjinë nga Kosova të mos refuzohen.

Amnesty International është e shqetësuar se shumë prej atyre që kërkojnë të kthehen me vullnetin e tyre, ose i kthejnë me detyrim, mund të mos jenë në gjendje të vërtetojnë të drejtën e tyre për banim në Kosovë përpara vitit 1998, duke u rrezikuar kështu nga mbetja *de facto* pa shtetësi. Rreziku i mbetjes pa shtetësi rezulton si nga Ligji për Ripranim, ashtu edhe nga procedurat që lidhen me të, dhe mund të përbëjë diskriminim të rëndë kumulativ deri në persekutim, kur personave pa dokumente u mohohen të drejtat e tyre bazë. Për këtë arsye, Organizata mendon se, aty ku ekziston rreziku i mbetjes pa shtetësi, shtetet nuk duhet të kërkojnë t'i kthejnë në Kosovë personat që rrezikojnë të mbeten të tillë.

Siç shkruante edhe Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës në gusht 2010: “Shtetet nuk duhet të zbatojnë politika që e përkeqësojnë gjendjen. Shtetet e Evropës Perëndimore duhet të ndalojnë kthimin e detyruar të romëve në Kosovë. Një raport i kohëve të fundit i UNICEF-it tregon se 38% e romëve të kthyer nga Gjermania janë pa shtetësi. Gjendja është edhe më e keqe për sa i përket fëmijëve: 42% e atyre që kanë jetuar dhe që, shpesh, edhe kanë lindur jashtë shtetit gjatë ose pas luftës, sot nuk janë të regjistruar [...]. E drejta për të pasur një shtetësi është një nga të drejtat themelore të njeriut, e mishëruar në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Ajo është “e drejta për të pasur të drejta”. Kjo e drejtë – për të gjithë – duhet të zbatohet me shumë më tepër energji dhe vendosmëri se sa është vepruar deri më tash.”⁹¹

5.4 E DREJTA PËR ARSIM

Ata më dhanë afat një javë për t'u larguar, kështu që shkuam në Zvicër, dhe pastaj zviceranët na kthyen si familje në Kosovë. Një organizatë zvicerane na tha që do të na ndihmonte, por nuk na ndihmuan, kështu që tash po jetojmë tek shtëpia e një shoku. Të gjithë fëmijët ende nuk mund të shkojnë në shkollë; bashkëshortja ime dhe unë i kemi marrë dokumentet në vitin 2008, por ka qenë e vështirë për fëmijët, sepse ata kanë lindur në Gjermani. Vajza ime 17 vjeçare edhe sot vetëm dokumentet e Gjermanisë ka.⁹² Na thanë që ajo mund të regjistrohej brenda një muaji. Fëmijët e tjerë i kanë dokumentet tani dhe mund të shkojnë në shkollë. Besim Ajolli, një burrë ashkali që ka jetuar në Gjermani prej vitit 1993 deri sa e kthyen në vitin 2007.

⁹¹ Këshilli i Evropës, Komisioneri për të Drejtat e Njeriut, “Stateless Roma: no documents – no rights” (Romët pa shtetësi: pa dokumente – pa të drejta”), 17 gusht 2010, http://www.coe.int/t/commissioner/News/2010/100817StatelessRoma_en.asp

⁹² Persona të tjerë të kthyer e kanë informuar Amnesty International se atyre nuk u ishte dhënë kohë as të merrnin nga shkollat e fëmijëve dokumentet që lidheshin me shkollimin e tyre.

Strategjia për Riintegrim parashikon masat që duhet të merren nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Departamentet e Arsimit nëpër komuna, që të sigurojnë qasje në arsim për fëmijët e kthyer me forcë nga vendet anëtare të BE-së. Ndër këto masa përfshihen “organizimi i kurseve të gjuhës, trajnimeve për mësuesit, një numër shtesë mësuesish për nxënësit e riatdhesuar, dhe një numër shtesë të anëtarëve të personelit mbështetës në shkolla, pajisje për shkollat dhe transport për nxënësit”.⁹³

Megjithatë, siç raportonte OSBE-ja në shtator 2009, “Por, deri më sot nuk janë ndërmarrë hapa konkrete për të zbatuar masat e riintegritimit në këtë fushë”, e as nuk ishte bërë ndonjë përparim i mëtejshëm deri në qershor 2010. Madje OSBE-ja pa se pjesa më e madhe e komunave as nuk kishin dijeni për ekzistencën e një politike të qeverisë për integrimin e të kthyerve në sistemin arsimor, dhe asnjë prej tyre nuk kishte marrë udhëzime konkrete për procedurat që duheshin zbatuar dhe as nuk kishin bërë parashikime apo plane konkrete financiare për to. Kështu, asnjë prej elementëve të identifikuar në Strategjinë e vitit 2007 nuk ishte zbatuar. Disa komuna, në mënyrë *ad hoc*, kishin shpërndarë libra dhe materiale të tjera falas. Në komunën e Gjakovës/Đakovica, në shkollat lokale janë krijuar klasa shtesë për të akomoduar fëmijët e kthyer. Megjithatë, sipas informacionit që ka marrë Amnesty International, kjo duhet sikur ka çuar efektivisht në një segregim arsimor të fëmijëve të komunitetit rom.⁹⁴

Sipas një raporti të UNICEF-it në Gjermani, nga 42 deri në 50 për qind e romëve që janë të obliguar me ligj të largohen nga Gjermania, janë fëmijë dhe gati dy të tretat e tyre janë të lindur dhe të arsimuar në Gjermani.⁹⁵ Sipas UNICEF-it, edhe kur i kanë dokumentet e nevojshme, shumë pak fëmijë të kthyer në Kosovë janë në gjendje të vazhdojnë arsimimin e tyre. Sipas Verena Knaus, bashkautore e raportit, “Nga 66 fëmijët e moshës shkollore që kemi intervistuar personalisht, vetëm 17 prej tyre vazhdonin të shkonin në shkollë pasi ishin kthyer në Kosovë. Kjo do të thotë që tre nga katër fëmijë e kanë braktisur shkollën. Arsyeja kryesore për këtë është varfëria e familjes – ata thjesht nuk mund t'i përballojnë financiarisht materialet, teshat, apo kostot e transportit.”⁹⁶

Këto pengesa në arsim i hasin shumica e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptas në Kosovë. Në vitin 2009, sipas OSBE-së, fëmijët romë janë në përgjithësi të përjashtuar nga sistemi arsimor dhe hasin vështirësi të konsiderueshme në integrim; një nga arsyt është edhe mungesa e qartë e masave që duhet të marrin autoritetet komunale, me përjashtim të atyre në Prizren dhe Gjakovë/Đakovica, për të nxitur ndjekjen e shkollës nga këta fëmijë në komunat e tyre. Për shembull, orët e mësimi shtesë ose ato për t'i ndihmuar fëmijët në detyrat e shtëpisë nuk ofrohen nga autoritetet, por nga OJQ-të vendase dhe ato

⁹³ Shih *Strategjia e Riintegritimit, 2010*, f. 18-19.

⁹⁴ Amnesty International është duke i hetuar këto raporte.

⁹⁵ UNICEF, *Integration unter Vorbehalt* (Integrim me rezerva), f. 73. Për një seri filmash 1 minutësh për fëmijët e kthyer nga Gjermania në Kosovë, shih <http://www.unicef.de/blog/category/kosovo/>

⁹⁶ “Një raport i ri i UNICEF-it dënon politikën e Gjermanisë për deportimin e fëmijëve romë, 8 korrik 2010, <http://www.dw-world.de/dw/Neni/0,,5775224,00.html>

ndërkombëtare. Vetëm në komunat serbe jepet mësim gjuha rome, dhe sipas informacionit që na është dhënë, nxënësit e klasës së parë i marrin librat falas nga Ministria e Arsimit e Serbisë. Përveç kësaj, vajzat në veçanti, nuk janë të regjistruara në shkolla. Pavarësisht nga kjo, numri i nxënësve për klasë në komuna si ajo e Fushë Kosovës/Kosovo Polje, që kanë një numër shumë të madh të kthyerish, është shumë i madh.⁹⁷ Megjithatë, niveli i braktisjes së shkollës është jashtëzakonisht i lartë dhe pak prej tyre vazhdojnë arsimin e mesëm.

Në qershor të vitit 2010 përfaqësuesit e Amnesty International u takuan me një të ri 20 vjeçar, Luli Arapi, i cili jetonte në një bllok banesash sociale për romët e zhvendosur brenda vendit (që flisnin gjuhën serbe) në Pletetinë. Ai sapo ishte kthyer me forcë nga Gjermania. Atij i kishin thënë paraprakisht që do ta deportonin, por si shumë të tjerë, ai ishte befasuar kur policia e kishte zgjuar nga gjumi natën dhe i kishin dhënë vetëm dhjetë minuta afat për t'u veshur e për të mbledhur sendet personale. Ishte e qartë që ai nuk ishte i përgatitur për deportimin, dhe madje dukej shumë konfuz dhe i traumatizuar kur Amnesty International bisedoi me të. Ai nuk e fliste as shqipen dhe as serbishten, dinte vetëm pak fjalë të gjuhës romani, dhe nuk ishte në gjendje të komunikonte as me vëllanë e tij më të madh, të cilin e kishin kthyer disa vjet para tij. Luli Arapi ishte vetëm dy vjeç kur familja e tij e lëshoi Kosovën. Familja e tij kishte marrë një "Duldung" [leje të përkohshme qëndrimi] dhe jetonte në Baden-Württemberg. Luli Arapi i ishte dhënë asistencë për pagimin e qirasë së banesës për gjashtë muaj, një grant prej 300 eurosh, dhe 50 euro për nevojat e ngutshme – ngaqë i kishin dhënë vetëm dhjetë minuta kohë për të mbledhur sendet personale. Askush nuk i kishte dhënë ndihmë për të mësuar gjuhën romani, apo ndonjë gjuhë tjetër që flitet në Kosovë.

Deri më sot, autoritetet kosovare nuk u kanë dhënë asnjë ndihmë fëmijëve apo të rriturve që nuk i dinë gjuhët që fliten në Kosovë. Sipas informacioneve, URA2, një projekt i financuar nga qeveria gjermane ofron ndihmë financiare për kurset e gjuhës, por kjo skemë është vetëm për personat që janë kthyer nga Landet e Gjermanisë. Sipas Strategjisë së Riintegritimit të vitit 2010, parashikohet që për të kthyerit do të jetë mësimi i gjuhës amtare. Por nuk është parashikuar ndonjë masë që të ndihmohen të kthyerit të vazhdojnë arsimin e lartë.

5.5 E DREJTA PËR KUJDES SHËNDETËSOR

"Nuk e di se si munden t'i paguajnë këta njerëz [romët] barnat." Shefi i zyrës së UNHCR-së, Prishtinë, qershor 2010

Në shqyrtimin e masave për përmirësimin e shëndetit të romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve në Kosovë, Strategjia për Integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas thotë: "Në këtë kontekst duhet cekur që sistemi shëndetësor në Kosovë është akoma në fazën e tranzicionit jo të gjitha sëmundjet mund të trajtohen ashtu siç duhet. Për më tepër, meqë nuk ekziston sigurimi (i detyrueshëm) shëndetësor, njerëzit duhet të paguajnë për disa shërbime, trajtime ose medikamente. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka botuar një listë të 'medikamenteve themelore' që në përgjithësi duhet të jenë në dispozicion pa pagesë (falas). Megjithatë, në Kosovë, shumica e këtyre 'medikamenteve themelore' nuk mund të gjenden më në farmacitë publike, por vetëm private ose tek shitësit farmaceutikë

⁹⁷ OSBE, Arsimi, shënimi në fund të faqes nr. 58. Numri [maksimal] i nxënësve për klasë është 32. Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje ky numër u ngrit në 37, dhe klasat në përgjithësi kanë 45 nxënës.

me shumicë që i shesin këto medikamente. Prandaj, shumica prej këtyre 'medikamenteve themelore' nuk mund të blihen nga njerëzit me të ardhura mesatare apo më të ulëta se mesatare siç është rasti i shumicës dërrmuese të romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve. Gjatë vitit 2008, Ministria e Shëndetësisë ka arritur që ta rrisë buxhetin për barna dhe deri në fund të vitit 2008 70 për qind e barnave dhe e materialit shpenzues esencial të jenë në dispozicion në institucionet publike. Meqë komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas në Kosovë janë ndër komunitetet më të varfra në krahasim me komunitetet e tjera minoritare dhe me popullatën shumicë, pagesat me para të xhepit për 'medikamente themelore' kanë ndikim joproporcional dhe shumë më të rëndë në këtë segment të shoqërisë."⁹⁸

Amnesty International është e shqetësuar nga informacioni se njerëz me nevoja të ngutshme shëndetësore – disa prej të cilëve, sipas informacionit, po trajtoheshin në spital përpara se t'i kthenin me detyrim – i janë nënshtruar kthimit të detyrueshëm. Në një numër rastesh të tilla, personat e kthyer me detyrim janë çuar drejt e në spital, sepse kishin nevojë për trajtim të menjëhershëm mjekësor.⁹⁹

Deri më sot, masat e parashikuara në Strategjinë për Riintegrim të vitit 2007, për sa i përket garantimit të qasjes në të paktën standardet minimale të kujdesit shëndetësor nuk janë zbatuar nga Ministria e Shëndetësisë, ndër të cilat edhe masat për pritjen e të kthyerve. Tani masat janë parashtruar në Strategjinë për Riintegrim, e rishikuar, të cilat kërkojnë praninë e ekipeve mjekësore në aeroport dhe në pika të tjera kufitare, për të ofruar ndihmë të menjëhershme mjekësore.¹⁰⁰ Amnesty International mendon se askush që është në gjendje të atillë nuk duhet të kthehet.

Po kështu, nuk janë marrë masa as për të siguruar që shërbimi shëndetësor të ofrohet, të jetë i përballeshëm financiarisht dhe i disponueshëm sipas kërkesave të Komitetit për të Drejtat Sociale, Ekonomike dhe Kulturore (KDESK), në komentin e tij të përgjithshëm nr. 14, mbi të Drejtën e Shëndetit.¹⁰¹

⁹⁸ Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, *Strategjia për integrimin e romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve në Republikën e Kosovës 2009-2015*, dhjetor 2008, f. 33-34.

⁹⁹ Intervistë e bërë nga Amnesty International, Ministria e Brendshme e Kosovës, maj 2010.

¹⁰⁰ Sipas Strategjisë së Riintegrit të vitit 2010, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale "lajmëron ekipin mjekësor me qëllim që t'i japë asistencën e menjëhershme mjekësore personit të kthyer që ka nevojë, në aeroport dhe në pikat e tjera kufitare, si dhe të organizojë hapat e tjera të nevojshme. Përveç kësaj, në aeroport dhe në pikat e tjera kufitare të Republikës së Kosovës duhet të jetë i pranishëm një ekip i lëvizshëm mjekësh dhe infermierësh për të ndihmuar ata persona të kthyer që kanë nevojë për kujdes shëndetësor, në bashkërendim të ngushtë me punonjësit e MPMS-së. Në raste konkrete të personave të kthyer që kanë sëmundje serioze, Ministria e Shëndetësisë duhet të informohet paraprakisht nga zyrtarët e MPMS-së, me qëllim që të sigurohet dhënia e asistencës së duhur për këta njerëz. Ministria e Shëndetësisë duhet të caktojë pikat e kontaktit për këtë çështje", *Strategjia e Riintegrit, 2010*, f. 7-8.

¹⁰¹ KDESK, Koment i Përgjithshëm nr. 14, Mbi të drejtën për një gjendje shëndetësore sa më të mirë të mundshme, 11 gusht 2000, paragrafi 12. [http://www.unhcr.ch/tbs/doc.nsf/\(symbol\)/E.C.12.2000.4.En](http://www.unhcr.ch/tbs/doc.nsf/(symbol)/E.C.12.2000.4.En)

Sipas kapitullit 3.2 të Strategjisë së Ripranimit 2007, mbi Qasjen në Kujdesin Shëndetësor, "personat e riatdhesuar duhet të përjashtohen nga pagesat për shërbimet shëndetësore deri në riintegrimin e tyre të plotë". Por intervistat me të kthyerit dhe me UNHCR-në, si dhe raportet e OSBE-së sugjerojnë se në praktikë nuk ndodh kështu.¹⁰² Amnesty International u informua nga disa persona të kthyer se medikamentet ose trajtimet mjekësore për të cilat kishin nevojë ata dhe familjet e tyre, ose nuk gjendeshin në Kosovë, ose ata nuk ishin në gjendje t'i paguanin. Dy të kthyer i thanë Amnesty International se ata nuk kishin mundur të merrnin ndihmë nga autoritetet për fëmijët e tyre me aftësi të kufizuara fizike, ose ta përballonin koston e kësaj ndihme në rastet kur ajo ofrohej.

KDESK-u ka thënë, "Komiteti e interpreton të drejtën për shëndet, siç përkufizohet në Nenin 12.1, si një të drejtë ekskluzive që përfshin jo vetëm një kujdes shëndetësor në kohën e duhur dhe në mënyrën e duhur, por edhe faktorët përcaktues të shëndetit, si qasja në ujë të pijshëm të sigurt për shëndetin dhe kushte higjieno-sanitare të përshtatshme, furnizim të mjaftueshëm me ushqim të sigurt për shëndetin, ushqyerje dhe banim, kushte të shëndetshme të punës dhe të mjedisit, dhe qasje në edukim dhe informacion që lidhet me shëndetin, ndër të cilat edhe edukimi për shëndetin seksual dhe riprodhues."¹⁰³ Amnesty International nuk mendon se në Kosovë ekzistojnë këto kushte për romët dhe ashkalinjtë.

Rasti më diskriminues i shkeljes së të drejtës së shëndetit është ai i rreth 700 romëve dhe ashkalinjve, që vazhdojnë të jenë të zhvendosur në kampe në Mitrovicën e Veriut, u mohohet e drejta e kujdesit shëndetësor, sepse jetojnë ose kanë jetuar në kampe refugjatësh të vendosur në zona të ndotura me plumb, gjë që ka shkaktuar vdekje, sëmundje kongjenitale dhe dëmtime afatgjata të shëndetit të të rriturve dhe fëmijëve, ku, sipas vlerësimeve të bëra nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, më se një e treta e tyre u vlerësuan se kishin nivel të lartë të plumbit në gjak.

Fakti që autoritetet e Kosovës dhe komuniteti ndërkombëtar¹⁰⁴ (me përjashtimin e OBSH-së dhe të OJQ-ve të vogla ndërkombëtare) për 11 vjet nuk i kanë dhënë zgjidhje gjendjes së mjerueshme të këtij grupi relativisht të vogël personash të zhvendosur, dhe nuk kanë siguruar fondet për rindërtimin e mëhallës së romëve në Mitrovicën e Jugut, (nga ku e kanë origjinën këta njerëz) tregon për mungesën e vullnetit politik dhe kapaciteteve për të garantuar të drejtat e komunitetit rom. Ndonëse gurët e themelit për shtëpitë e reja që do të ndërtoheshin në mëhallë u vendosën në maj të vitit 2010, nuk është bërë përparim në marrjen e masave që

¹⁰² Shih edhe OSBE, *Zbatimi i Strategjisë për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në Komunitet e Kosovës*, 2009, f. 10.

¹⁰³ KDESK, Koment i përgjithshëm nr. 14, paragrafi 11.

¹⁰⁴ Më 5 qershor 2009, Paneli Këshillues për të Drejtat e Njeriut i UNMIK-ut e deklaroi pjesërisht të pranueshme një padi të ngritur kundër UNMIK-ut nga 143 romë, ashkalinj dhe egjiptas të zhvendosur brenda vendit, që banonin në kampet e administruara nga UNMIK-u në Mitrovicën e Veriut. Banorët pretendonin se kishin pësuar helmim nga plumbi dhe probleme të tjera shëndetësore nga kompleksi i shkrirjes së metaleve dhe minierat e Trepçës/Trepça, Lënda nr. 26/08: N.M. dhe 142 të tjerë, http://www.unmikonline.org/human_rights/documents/PR/pr-hrap21.pdf

kjo popullatë e prekur nga ky problem të marrë trajtimin e duhur mjekësor, ose që t'i jepet banim i përkohshëm alternativ diku ku shëndeti i tyre nuk do të ishte më në rrezik.¹⁰⁵

Amnesty International është e shqetësuar se duke mos pasur banesa të tjera për të kthyerit me detyrim, disa prej tyre kanë shkuar të banojnë në kampet e ndotura me plumb. Sipas informacionit që ka marrë Amnesty International nga OJQ-të ndërkombëtare dhe nga një delegacion i qeverisë zvicerane, disa romë që i kishin kthyer me forcë në Kosovë në vitin 2009, po jetonin në kampet e ndotura me plumb në Mitrovicë, duke zëvendësuar romët e zhvendosur që i kishin lëshuar kampet. Në korrik të vitit 2010, sipas një OJQ-je tjetër që punon në këto kampe, gjatë tre muajve të mëparshëm, shtatë familje rome (gjithsej 35 individë) të deportuar nga Gjermania, kishin shkuar të banonin në kampet e ndotura me plumb.¹⁰⁶

5.6 E DREJTA PËR BANIM TË PËRSHTATSHËM¹⁰⁷

Shumë persona të kthyer të të gjitha kombësive nuk mund të kthehen në shtëpitë e tyre të para luftës. Në vitin 2008, sipas OSBE-së, për rreth 29 000 kërkesa për marrjen ose kthimin e pronave ende nuk ishte marrë vendim nga Komisioni i Kosovës për Kërkesa Pronësore. Po kështu, ishin rreth 11 000 “kërkesa për të cilat është marrë vendim por nuk janë zbatuar”, ku autoritetet nuk kishin zbatuar vendimet në lidhje me zënien e paligjshme të pronave ose shpronësimin. Në qershor 2008 Agjencia Kosovare e Pronës u vendos nën Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar të BE-së, por deri në qershor 2009, numri i rasteve për të cilat nuk ishte marrë vendim nuk ishte ulur. Rreth 20 000 lëndë të prapambetura kompensimi, si rezultat i shkatërrimit të pronave në vitin 1999 dhe 2000, të ngritura kundër UNMIK-ut, KFOR-it dhe autoriteteve kosovare, vazhdojnë të mbeten në gjykatat e Kosovës.

¹⁰⁵ Për informacion të mëtejshëm, shih për shembull, Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Background Report: Lead contamination in Mitrovicë/Mitrovica affecting the Roma community*, (Raport informues: ndotja me plumb në Mitrovicë prek komunitetin rom http://www.osce.org/documents/mik/2009/02/36378_en.pdf, shkurt 2009; Human Rights Watch, *Kosovo: Poisoned by Lead, A Health and Human Rights Crisis in Mitrovica's Roma Camps* (Kosovë: Të helmuar nga plumbi – krizë e shëndetit dhe e të drejtave të njeriut në kampet rome të Mitrovicës), 23 qershor 2009, <http://www.hrw.org/en/reports/2009/06/23/kosovo-poisoned-lead>

¹⁰⁶ “Gjatë tre muajve të fundit, shtatë familje rome të deportuara nga Gjermania gjatë kësaj kohe kanë shkuar të banojnë në Osterode dhe Cesmin Lug, tek të afërmit e tyre. Ata nuk janë regjistruar tek autoritetet e kampit dhe ndoshta as nuk njihen prej tyre Me qëllim që të mos tërheqin vëmendjen, ata nuk flenë çdo natë në kampe; ndonjëherë rrinë në një ndërtesë të braktisur në Mitrovicën e Veriut”; Ky informacion iu dërgua Amnesty International me email nga Paul Polansky, 20 korrik 2010. Më 22 korrik Paul Polansky na dërgoi një email të shkruar nga një përfaqësues i OJQ-së Shoqata për Njerëzit e Rrezikuar që jetojnë në kampe, i cili thoshte se në kampe kishin arritur edhe familje të tjera. Një kopje e këtij email-i i ishte dërguar edhe Thomas Hammarberg-ut,

¹⁰⁷ Të paktë janë romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit që jetojnë në Kosovë, të cilët gëzojnë të drejtën e banimit të përshtatshëm. Për studimin e kohëve më të fundit, shih për shembull, KFOS, *Gjendja e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptase në Kosovë*, f. 29-30.

Romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit hasin vështirësi më të mëdha në fitimin e së drejtës së tyre pronësore, sepse shpesh prona kalohej nga brezi në brez brenda të njëjtës të familje pa ndonjë dokument pronësie, ose e kanë blerë pa dokumentet e duhura, kështu që shpesh ata nuk mundën të kenë qasje në shtëpitë e tyre pasi kthehen. Të paktë janë ata që mund të marrin pronën që kanë pasur para luftës – kjo ose sepse nuk kanë dokumentet e duhura për të vërtetuar pronësinë, ose sepse prona iu është shkatërruar gjatë luftës së vitit 1999 ose në marsin e vitit 2004, ose sepse atë ua kanë zënë në mënyrë të paligjshme persona të tjerë, ose sepse hasin ndonjë lloj tjetër diskriminimi.¹⁰⁸ Kështu, personave të kthyer shpesh u duhet të shkojnë e të banojnë me të anëtarë të tjerë të familjes, gjë që çon në një mbipopullim të madh të banesave.¹⁰⁹

Personat e kthyer vullnetarisht, që nuk mundën të kenë qasje në pronat e tyre të kohës së paraluftës, mund të plotësojnë kriteret për të marrë fonde për rindërtimin e pronës së tyre, ose, kohët e fundit, për të ndërtuar shtëpi të reja. Për shembull, një program i UNDP-së që ndihmon komunat e vendit dhe që zbatohet në bashkëpunim me Këshillin e Refugjatëve të Holandës, mbështet personat e kthyer vullnetarisht që kanë pronësi tokë për të rindërtuar shtëpitë e tyre (me një paketë deri në 14 4000 euro për familje, 1 500 euro për orënditë shtëpiake, ndihmë financiare për gjashtë muaj dhe qasje në projekte që ndihmojnë në fitimin e të ardhurave).

Sipas UNDP-së, për ata që nuk kanë tokë, si rezultat i trysisë nga donatorët ndërkombëtarë, disa komuna kanë marrë masa të sigurojnë tokë në të cilën mund të jetojnë romët.¹¹⁰ Për shembull në Gjakovë/Djakovica, janë legalizuar sipërfaqe tokë për bërë ndërtime afër vendbanimit ekzistues rom në lagjen Kolonia, me ndihmën e Caritas-it, me një kosto prej 3,4 milion euro. Kështu është krijuar mundësia e përdorimit të tokës për 140 familje romë që ishin kthyer vullnetarisht. Sipas UNDP-së, ndërtimi i banesave sociale për të kthyerit do të bëhej më i mundshëm financiarisht nëse komunat e tjera do të pajtoheshin të jepnin tokë për banim shoqëror.

Megjithatë, ata që kthehen me detyrim, si Irfani, në rom i kthyer nga Gjermania në maj të vitit 2010, nuk e marrin një ndihmë të tillë. Ai e kishte lëshuar Kosovën me familjen e tij në vitin 1992, kur ishte pesë vjeç, dhe kishte jetuar në Gjermani, kishte bërë atje kurse profesionale dhe kishte punuar deri sa e kthyen me detyrim në Kosovë. Kur u takoi me Amnesty International, ai banonte në shtëpinë e disa fqinjëve dhe po mundohet ta bënte të

¹⁰⁸ Në tetor 2009 OJQ-të raportuan se ka pasur akuza për diskriminimin e romëve që kishin bërë kërkesë për banesa "multi-etnike" në fshatin e Llapje Sellës/Llapje Selo, të banuar kryesisht nga serbët.

¹⁰⁹ Për shembull, në Gjakovë, Qendra për Dokumentim e Romëve dhe Ashkalinjve (QDRA) intervistoi një person që i përkiste komunitetit egjiptas, i cili jetonte së bashku me shtatë pjesëtarë të familjes në një shtëpi me sipërfaqe rreth 20-25m². Një familje tjetër nga komuniteti ashkali në Fushë Kosovë me dymbëdhjetë pjesëtarë, që u intervistua, jetonin të gjithë së bashku në një banesë 70m² me tri dhoma, *Helplessness* (Pa shpresë), 2009, f. 14.

¹¹⁰ Intervistë e bërë nga Amnesty International me Alex Standish, UNDP, qershor 2010. Në prill 2010 u mor vendim për disa masa për t'i lejuar komunat të caktojnë tokë për ndërtim mbi bazën e një qiraje tokë për 99 vjet. Projekti do të financohet nga BE-ja (fondet e IPAs – 3,3 milion euro nga fondet e IPAs), qeveria (1,1 milion euro) dhe UNDP-ja (400 000 euro).

banueshme shtëpinë e mëparshme e të shkatërruar të familjes në Plemetinë. Ai e kishte pastruar ndërtesën nga gurët e mbeturinat, por duke mos pasur të holla të vendoste dyert e dritaret dhe për të ndrequr kulmin, ai i bëri Amnesty International pyetjen, “Si t’ia bëj?”¹¹¹

Ndihma për rindërtim ose ndërtim sot për sot është mundshme vetëm për personat e kthyer vullnetarisht, përmes Ministrisë për Kthim dhe Komunitete dhe UNHCR-së (të cilat janë kundër kthimeve të detyruara, kështu që nuk i mbështesin të kthyerit me detyrim). Për këtë arsye, ata nuk plotësojnë kriteret për t’u ndihmuar nga UNHCR-ja dhe nga partnerët e saj zbatues. Megjithatë, edhe në rastin e kthimeve vullnetare, financimet për këto projekte rindërtimi janë të kufizuara, sepse pak donatorë ndërkombëtarë vazhdojnë të japin një asistencë të tillë.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) është ngarkuar me përgjegjësinë e përgjithshme që t’u ofrojë banim personave të kthyer me detyrim. Deri në prill 2010, Ministria nuk kishte fonde për ndërtimin e banesave sociale ose banesave të tjera për të kthyerit me detyrim, por kishte bërë kërkesë pranë Komisionit Evropian për një projekt për përcaktimin e nevojave për banesa.¹¹² Përveç kësaj, asnjë komunë nuk kishte identifikuar një buxhet për banimin e personave të kthyer; një Projektligj për financimin e programeve të veçanta të banimit, që u mundëson si autoriteteve të qeverisë qendrore dhe atyre të komunave që t’i adaptojnë ndërtesat për qëllime banimi, i miratuar në shkurt 2010, nuk përmban dispozita të posaçme për të kthyerit.¹¹³

Gjendja serioze e kësaj situatë duhet të shihet në kontekstin e nevojave të paplotësuara për banim të përshtatshëm në të gjithë Kosovën dhe për të gjitha komunitetet. Në kohën e shkrimit të këtij raporti, Kosova nuk kishte kornizë ligjore për sigurimin e banesave sociale. Deri në prill 2010 ende nuk ishte miratuar Strategjia e Banimit për 2010 – 2014, që do të

¹¹¹ Intervistë e bërë nga Amnesty International, Plemetinë, qershor 2010.

¹¹² “MMPH-ja nuk ka mbështetje nga donatorët për riintegrimin e personave të riatdhesuar. MMPH-ja ka aplikuar për një projekt të IPA-s që ka për qëllim krijimin e një baze të dhënash në nivelin komunal, në të cilin do të regjistrohen kërkesat për banim social si dhe kontratat komunale nga programet e banimit social, që rrjedh si kërkesë nga ligji për financimin e banesave publike të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 15 prill 2010. Përveç kësaj, MMPH-ja po harton një projekt të ri me qëllimin që ai të financohet nga IPF-ja, me titull “Program Lokal për Riintegrimin e Grupeve të Rrezikuara të Popullatës përmes Asistencës në Zgjidhjen e Çështjes së Banimit”. Mbetet për t’u parë nëse këto projekte do të miratohen nga KE-ja si organizata donatore në këtë rast”, *Vlerësimi i Riintegrimit*, prill 2010, f. 18-19, paragrafi 6.

¹¹³ Ligji nr. 03/L-164, *Për Financimin e Programeve të Veçanta të banimit*, miratuar më 25 shkurt 2010, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-164-eng.pdf>. Neni 11 u jep prioritet përfituesve të mposhtëm: “1.1. familjet me shumë fëmijë; 1.2. familjet që në përbërjen e tyre kanë persona me aftësi të kufizuara; 1.3. familjet ku kryefamiljari është grua-mbajtëse e familjes; 1.4. bashkëshorti ose bashkëshortja e divorcuar që ka në përkujdesje fëmijë; 1.5. fëmijët me statusin e jetimit”.

mundësojë rindërtimin e shtëpive për personat pa prona dhe pa burimet financiare për të blerë tokë ose materiale rindërtimi.¹¹⁴

“Mos ktheni njerëz të tjerë nëse doni të zhdukni kampet e PZHBV-ve. Kthejini njerëzit pasi të jetë forcuar shteti”, një ashkali i kthyer.

Sipas UNHCR-së, për arsyt e nënvizuara më lart dhe, në disa raste, për shkak se personat e kthyer kanë frikë të shkojnë të banojnë në shtëpitë e tyre të paraluftës, vetëm rreth 30-40 për qind e të kthyerve me detyrim mund të shkojnë në vendbanimin e tyre të origjinës.¹¹⁵ Statistikat më të fundit që janë botuar, të raportuara nga OSBE-ja në vitin 2009, thonë se në komunën e Istogut/Istok, rreth 70 deri në 80 për qind romë, ashkali, dhe egjiptas nuk mund të ktheheshin në shtëpi të shkatërruara ose të dëmtuara: “personat e riatdhesuar u gjendën të pastrehë dhe, vetëm me ndërhyrjen e KFOR-it dhe të punonjësit të komunitetit në komunë, mundën të strehoheshin përkohësisht në një kamp joformal në Gjurmoc/Djurakovac”.¹¹⁶

Ndonëse romët përbëjnë më pak se dy për qind të popullsisë së Kosovës (shifrat luhaten nga 35 000 deri në 40 000), ata tashmë përbëjnë afërsisht 18 për qind të personave të zhvendosur brenda vendit (PZHBV) në Kosovë. Nuk ekzistojnë statistika për numrin e personave që janë kthyer me forcë ose vullnetarisht në një situatë zhvendosjeje brenda vendit, por sipas OJQ-ve lokale dhe ndërkombëtare, rreth 80 për qind e personave të kthyer me detyrim në Kosovë nuk mundën të kthehen në vendbanimin e origjinës, ose vendosin të mos shkojnë atje. Shumica e tyre shkojnë në komunitete tashmë të krijuara, duke banuar me të afërm e familjarë, por jo të gjithë e kanë këtë mundësi.

Deri në prill 2010 kishte 41 Qendra të Përkohshme Kolektive që ofronin banim për 1 050 familje (ose 4 503 persona);¹¹⁷ pjesa më e madhe e të cilëve ishin romë, ashkali dhe egjiptas. Strategjia e Riintegritit e vitit 2010 pranon se “kushtet e banimit në këto QPK nuk i plotësojnë as standardet minimale të banimit dhe karakterizohen nga mungesa e hapësirës, mungesa e mirëmbajtjes dhe, si rezultat i kësaj, ndërtesat po dëmtohen. [...] edhe kushtet higjienike janë të ulëta dhe ka një mungesë të madhe uji dhe ngrohjeje, etj.” dhe se “fondet buxhetore të qeverisë janë të kufizuara dhe e bëjnë të pamundur sigurimin e banimit për ato grupe njerëzish që nuk mund ta përballojnë [banimin] vetë”.

¹¹⁴ *Vlerësimi i Riintegritit*, f. 18, paragrafi 5. Amnesty International nuk ka mundur të mësojë se cili është statusi i tanishëm i Strategjisë së Banimit.

¹¹⁵ Intervistë e bërë nga Amnesty International, UNHCR Prishtinë, qershor 2010.

¹¹⁶ OSBE, *Zbatimi i Strategjisë për Riintegritin e Personave të Riatdhesuar në Komunitet e Kosovës*, 2009, f. 11, poshtëshënimet 50, 51.

¹¹⁷ *Vlerësimi i Riintegritit*, f. 19.

Është e qartë që Kosova vetë nuk ka kapacitetin të sigurojë banim për personat e kthyer me detyrim. Pa ndihmë ndërkombëtare, të kthyerve nuk mund t'u garantohet e drejta për banim të përshtatshëm.¹¹⁸

5.7 E DREJTA PËR PUNËSIM

“Niveli i papunësinë në Kosovë është shumë i lartë. Për këtë arsye, riatdhesimi do ta bëjë këtë situatë edhe më serioze”. *Strategjia e Riintegritimit, 2010, f. 14.*

“Rreth 45 për qind e njerëzve në Kosovë janë të papunë – këtu në Fushë Kosovë është rreth 99,5 për qind, dhe po bëhet edhe më keq për shkak të njerëzve që po kthehen. Ata kthehen me një familje me pesë apo dhjetë pjesëtarë, dhe kështu kemi edhe pesë apo në dhjetë njerëz të tjerë pa punë e pa asistencë. Çfarë po mendojnë? Këtu janë 736 familje, 564 prej tyre janë PZHBV nga pjesë të tjera të Kosovës dhe ndoshta duhet [të kujdesen] për ata në fillim.” Bekim Sylja, Qendra për Dokumentim e romëve dhe ashkalinjve, qershor 2010.

Sipas UNDP-së 45 për qind e popullatës së aftë për punë në Kosovë janë të papunë; niveli është edhe më i lartë ndër gratë dhe pakicat. Disa burime e vlerësojnë papunësinë ndër romët në nivelin mbi 90 për qind: UNICEF-i, në raportin e tij të fundit shprehej se në kryeqytetin e Prishtinës/Pristina “papunësia ndër romët mund të jetë duke iu afruar 100%”. Më tej, UNICEF-i, në studimin e tij të familjeve që janë kthyer nga Gjermania me forcë ose vullnetarisht, ka vlerësuar se, ndërsa të ardhurat mesatare për familjet rome, që jetonin që më parë në Kosovë, është 120 euro në muaj, kurse në familjet e kthyer ata vlerësojnë që të ardhurat janë 88 euro në muaj.¹¹⁹

Në qershor 2010 Ferdana, një grua rome që punon për OJQ-në Luledielli Ballkan, i tha Amnesty International se asnjë grua rome në Fushë Kosovë/Kosovo Polje nuk kishte punë, madje edhe ato që kishin kryer shkollën e mesme. Sipas një përfaqësuesi lokal të romëve, Qerim Gara, “është katastrofë. Përpara luftës kishte rreth 70 për qind papunësi. Tani ka rreth 5 deri në 6 000 banorë në Fushë Kosovë, dhe vetëm rreth 30 prej tyre janë të punësuar”.¹²⁰

Përpara vitit 1999, shumë romë dhe ashkali punonin në ndërmarrjet shtetërore; në teori, ish punonjësit e atyre ndërmarrjeve plotësojnë kushtet për t'u kthyer në vendet e tyre të punës, ose të marrin një pension. Në praktikë, dhe me kalimin e kohës dhe privatizimin e kompanive ish shtetërore, nuk ka ndodhur kështu. Termocentralet e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) afër vendbanimeve rome në Obiliq/Obilić dhe Plemetinë, për shembull, dikur punësonin një përqindje të madhe romësh dhe ashkalinjsh; dhe pavarësisht nga masat e marra në vitin 2003 për t'u mundësuar personave që dikur punonin në ndërmarrjet që ishin pronë shoqërore që të merrnin vendin e mëparshëm të punës pas privatizimit, në vitin 2009 vetëm tre nga 7 654 (0,04%) e punonjësve ishin nga këto komunitete.¹²¹ Përveç kësaj,

¹¹⁸ Shih *Strategjia e Riintegritimit*, f. 24-28

¹¹⁹ UNICEF, *Integration unter Vorbehalt* (Integritim me rezerva), f. 95, Tabelle 17: Monatliches Durchschnittseinkommen von RAE (KFOS 2009).

¹²⁰ Të gjitha citimet në këtë seksion janë nga intervistat e bëra nga Amnesty International, qershor 2010.

¹²¹ Qendra për Dokumentim e Romëve dhe Ashkalinjve, *Pa shpresë*, f. 17. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/13, e amenduar me Rregulloren Nr. 45/2004, thotë se “një punonjës plotëson kushtet [për t'u ripunësuar] në qoftë se ky punonjës është (...) i regjistruar si punonjës në ndërmarrjen me pronësi

pavarësisht nga kuotat etnike, pak romë, ashkalinj dhe egjiptas janë të punësuar në organet e qeverisjes lokale ose komunale.¹²²

“Mundohemi të gjejmë ndonjë punë ditore, por të gjitha kompanitë [shtetërore] janë shitur dhe nuk ka ekonomi. Disa [romë] kryejnë akte kriminale vetëm sa për të mbijetuar. Mund të kemi lirinë e lëvizjes, po – ta them thjesht – na duhet të mbushim barkun”, Halil Cerimi, i intervistuar nga Amnesty International, qershor 2010.

Ndonëse disa romë arrijnë të mbijetojnë duke mbledhur dhe shitur, ose ricikluar, ose ri-përdorur mbeturina metalesh dhe çka gjejnë nëpër kazanët e mbeturinave, dhe mund të ketë të tjerë që gjejnë punë të rastësishme si punëtorë mëditës, perspektiva të vërteta punësimi nuk ka. Edhe ata që kthehen vullnetarisht, vetëm ndonjëherë ndihmohen me punësimin, përmes projekteve që gjenerojnë të ardhura.¹²³ Një ndihmë e tillë mund t'u japë të kthyerve të ardhura për një kohë të shkurtër, por nuk u japin atyre punësim të qëndrueshëm apo afatgjatë.

Sipas Strategjisë për Riintegrim, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale ka vendosur “politika dhe masa përmes së cilave do të mundë të ofrojë shërbimet e duhura personave të riadhesuar përmes shërbimeve të punësimi dhe kurseve profesionale. Komunave u kërkohet të identifikojnë donatorët e mundshëm dhe të hartojnë projektet e përshtatshme në përfitim të personave të riadhesuar, sidomos për sa i përket mundësive të punësimi”.¹²⁴ Por, deri në prill 2010, këto masa ende nuk ishin vënë në zbatim dhe, sipas vlerësimit të Ministrisë së Brendshme të Strategjisë për Integrim në vitin 2010, ishte identifikuar vetëm një projekt komunal, i financuar nga një donator zviceran, dhe i vënë në zbatim nga ONM-ja.¹²⁵

Për ata që kanë dokumentacion të mjaftueshëm dhe që i plotësojnë kriteret, i vetmi burim i rregullt i të ardhurave janë ndihmat sociale. Sipas UNHCR-së, këto ndihma të mirëqenies sociale “janë të pamjaftueshme për t'u siguruar përfituesve një standard të mjaftueshëm jetese.”¹²⁶ Pagesa standarde mujore luhet nga 40 euro në muaj për një individ që jeton vetëm, deri në 80 euro në muaj për një familje me shtatë persona.¹²⁷ Amnesty International nuk ka mundur të mësojë se cila është përqindja e të kthyerve që marrin ndihma sociale.

shoqërore në kohën e privatizimit të saj”. Amnesty International në 2002-4 ka punuar, pa sukses, për të kthyer një burrë ashkali në vendin e tij të punës në KEK, por pa sukses.

¹²² Në vitin 2009, 10 për qind e punonjësve të sektorit shtetëror në Kosovë ishin nga popullatat e pakicave, nën cakun 16 për qind që ka caktuar qeveria.

¹²³ Projektet për gjenerimin e të ardhurave për personat e kthyer vullnetarisht, ofrohen nga financues ndërkombëtarë, si për shembull nga UNDP-ja (shih më lart) dhe *Mercy Corps*, shih <http://www.osce.org/item/30136.html>

¹²⁴ *Strategjia e Riintegrit, 2010*, f. 14-15.

¹²⁵ *Vlerësimi i Riintegrit, f. 10*, paragrafi 6.

¹²⁶ UNHCR, *Kriteret Përzgjedhëse*, f. 13.

¹²⁷ *Zyra e Statistikave e Kosovës, Statistika të Mirëqenies Sociale 2009*, qershor 2010, f. 11-12; në vitin 2009 merrnin ndihma sociale 35 000 deri në 38 000 familje – këto statistika nuk janë të ndara

Në mungesë të një politike sociale gjithëpërfshirëse, përfshirë edhe politikën për punësimin dhe asistencën sociale, Kosova po ndihmohet nga Komisioni Evropian, mbi bazën e një marrëveshjeje për Partneritetin Evropian, që parashikon prioritizimin e fondeve për përmirësimin e të drejtave ekonomike dhe shoqërore, ndër të cilat edhe zbatimin e “strategjive dhe i planeve të veprimit përkitazi integritetit të romëve, përfshirë edhe të kthyerit”.¹²⁸ Në studimin e tij për Kosovën, Komisioni Evropian propozon që të jepet një asistencë specifike për të “ndihmuar përpjekjet për përfshirjen e komuniteteve të pakicave në masat e mbrojtjes dhe të përfshirjes sociale”.¹²⁹ Megjithatë, organizata nuk ka mundur të identifikojë ndonjë program ekzistues punësimi që të jetë hartuar posaçërisht për plotësimin e nevojave të punësimit të personave të kthyer me detyrim.

5.8 KTHIME TË QËNDRUESHME?

Në mungesë të ndonjë mekanizmi efektiv për monitorimin e kthimeve të detyruara, informacioni për qëndrueshmërinë e këtyre kthimeve nuk ekziston. Sipas UNHCR-së, që nga janari 2000 deri në prill 2009, në Kosovë janë kthyer 7 490 romë, ashkali dhe egjiptas , por një “numër i panjohur” është larguar përsëri nga Kosova “për shkak të shkaqeve ekonomike”.¹³⁰ Zyra e UNHCR-së në Prishtinë sugjeronte se në qershor 2010 gati 70 për

sipas origjinës etnike të personave që përfitojnë prej tyre. <http://www.ks.gov.net/ESK/eng/dmdocuments/Social%20Welfare%20Statistics%202009.pdf> Sipas QDRA-së, “Llogaritur mbi një shumë mesatare prej 50 euro në muaj, qeverisë së Kosovës do t’i duhej të parashikonte një buxhet prej 500 000 euro në muaj ose 6,0 milion euro në vit vetëm për ndihma sociale për personat e kthyer – dhe këto kosto nuk përfshijnë sigurimin e banimit dhe çështje të tjera”, QDRA, *Pa shpresë*, f. 15.

¹²⁸ 2008/213/EC: Vendim i Këshillit i datës 18 shkurt 2008 mbi parimet, përparësitë dhe kushtet e përmbajtura në Partneritetin Evropian me Serbinë përfshirë Kosovën sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të datës 10 qershor 1999, dhe Vendimi i ri-apelimit 2006/56/EC , Gazeta Zyrtare L 080 , 19/03/2008 f. 0046 – 0070, <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2008:080:0046:01:EN:HTML>

¹²⁹ “BE-ja mund ta ndihmojë Kosovën duke e lidhur atë me përpjekjet e veta për të promovuar qasje në punësim për të gjithë, përmirësim të dialogut me partnerët socialë dhe shoqërinë civile dhe fokusim më të mirë të politikave të punësimit dhe ato sociale. Përkitazi me këtë, Komisioni do të paraqesë një studim për “mbrojtjen Sociale dhe Përfshirjen Sociale në Kosovë”, që do të ndihmojë ta përgatisin Kosovën për një bashkërendim më të avancuar të politikave sociale dhe të punësimit. Komisioni propozon ta përfshijë Kosovën në Programin e Progresit, i cili është i hapur për vendet e Ballkanit Perëndimor. Ai do të përkrahë pjesëmarrjen e Kosovës në përpjekjet për bashkëpunim rajonal për politikën e punësimit dhe ato sociale, brenda kornizës së Rrjetit të Politikave Sociale dhe të Punësimit të Evropës Juglindore dhe Rrjetit të Shëndetësisë SHIH. Komisioni propozon të angazhohet me sekretariatit e Dekadës së Romëve për të zhvilluar shoqatën e Kosovës dhe për të përkrahur përpjekjet për përfshirjen e komuniteteve të pakicave në masat e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale” ,COM(2009) 5343, *Communication from the Commission to the European Parliament and the Council, Kosovo - Fulfilling its European Perspective* (Komunikatë e Këshillit të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, Kosova – Plotësimi i Perspektivës së saj Evropiane) , 14 tetor 2009, paragrafi 7.4, f. 10, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/kosovo_study_en.pdf

¹³⁰ Qeveria e Kosovës, *Strategjia për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptase në Republikën e Kosovës, 2009 – 2015*.

qind e të kthyerve romë mund ta kenë lëshuar Kosovën përsëri. Sipas Qendrës për Dokumentim të romëve dhe ashkalinjve, të paktën 50 për qind e romëve të kthyer me detyrim, u larguan menjëherë nga Kosova dhe u vendosën në Serbi, Malin e Zi, ose në vendet e Evropës Perëndimore..¹³¹

Për shkak të asociimit të tyre historik me komunitetin serb, shumë romë, në veçanti, shkojnë të jetojnë në pjesën serbe të veriut të Kosovës, ose edhe në Serbi. Të thëna gojore sugjerojnë se edhe persona të tjerë të kthyer, shpesh përpiqen, dhe ndonjëherë arrijnë, të kthehen në vendet e BE-së, shpesh pikërisht në vendin nga i cili u deportuan me forcë. Ashtu siç shprehet edhe Projekti për Marrëdhëniet Etnike, i drejtuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, “politikat e kthimit të detyruar nga vendet pritëse nuk janë efektive dhe të qëndrueshme, sepse shumë prej atyre që kthehen me forcë, largohen nga vendi përsëri shumë pak kohë pasi kanë mbërritur”.¹³²

¹³¹ Intervistë e bërë nga Amnesty International me UNHCR-në dhe QDRA-në, qershor 2010.

¹³² Përfundime të nxjerra nga Tryezat e Rrumbullakëta Ndërkombëtare për sfidat dhe perspektivat e integritit të qëndrueshëm të romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve në vendet pritëse dhe në vetë Kosovën, të organizuara në Vjenë në tetor 2008 dhe në Prishtinë në shkurt 2009 nga Projekti për Marrëdhëniet Etnike (PME) me përkrahjen e Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, cituar në *Updated Opinion of MG-S-ROM on the Return of Roma to Kosovo and South Eastern Europe; International Roundtable on Roma, Ashkali, and Egyptians of Kosovo: Challenges and Prospects of Sustainable Integration* (Opinion i përditësuar i MG-S-ROM për kthimin e romëve në Kosovë dhe në Evropën Juglindore; Tryezë e Rrumbullakët Ndërkombëtare për romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit e Kosovës: Sfida dhe perspektiva të integritit të qëndrueshëm <http://www.per-usa.org/1997-2007/announcements.htm>

6. KRITIKA NDËRKOMBËTARE

Mungesa e kapaciteteve, e vullnetit politik dhe e burimeve për riintegrim në Kosovë janë bërë objekti i një shqetësimi të përsëritur dhe në rritje, si dhe i kritikave nga organizatat dhe institucionet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Më 9 korrik 2009, në një raport për vizitën e tij në Kosovë, Komisioneri i të Drejtave të Njeriut i Këshillit të Evropës, Thomas Hammarberg, u bëri thirrje qeverive evropiane që të shmangin kthimet e detyruara të pakicave në Kosovë dhe të rregullojnë me ligj statusin e atyre që janë në vendin pritës deri sa të përmirësohen kushtet për kthimin e tyre. Komisioneri u shpreh se: "Gjendja ekonomike dhe sociale vazhdon të jetë një pengesë për procesin e kthimit të qëndrueshëm. Ndonëse çështjet e sigurisë janë përmirësuar, gjendja në Kosovë vazhdon të jetë e tensionuar, me raste sporadike të dhunës ndër-etnike."¹³³

Më 20 qershor, në një deklaratë me rastin e Ditës Botërore të Refugjatëve, Shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadori Werner Althofer, theksoi se "Kthimi dhe riintegrimi i personave të zhvendosur duhet të trajtohet si një çështje prioritare." Ai i bëri thirrje autoriteteve qeveritare dhe atyre komunale që të shtojnë angazhimin dhe të zbatojnë projektet që lidhen me personat e kthyer, dhe i përshkroi kthimin e qëndrueshëm dhe riintegrimin e personave të zhvendosur nga Kosova si një "sfidë të madhe të të drejtave të njeriut".¹³⁴

¹³³ "Paragrafi 162. Procesi i kthimit mbetet një nga sfidat më kryesore për autoritetet e Kosovës. Komisioneri mendon se ata persona që dëshirojnë të kthehen në Kosovë duhet të mbështeten nga autoritetet e Kosovës dhe se procesi i kthimit duhet të jetë i planifikuar, i informuar dhe i qëndrueshëm. Autoritetet e Kosovës duhet t'u ë sigurojnë atyre që vendosin të kthehen me dëshirën e tyre një mjedis të sigurt, banim, arsim dhe mundësi për të fituar jetesën.

Paragrafi 163. Komisioneri u bëri thirrje qeverive në Evropë që të shmangin kthimet e detyruara të pakicave në Kosovë dhe të rregullojnë me ligj statusin e atyre në vendin pritës evropian deri sa kushtet në Kosovë të lejojnë kthimin e tyre të sigurt. Sipas vlerësimit të Komisionerit sot për sot autoritetet nuk i kanë kapacitete të përshtatshme për të pritur dhe integruar kthime masive në Kosovë. Gjendja ekonomike dhe sociale është një pengesë shumë e madhe për një proces kthimi të qëndrueshëm. Ndonëse çështjet e sigurisë janë përmirësuar, sipas mendimit të Komisionerit, gjendja vazhdon të jetë e tensionuar, me raste sporadike të dhunës ndër-etnike.", *Report of the Council of Europe Commissioner for Human Rights' Special Mission to Kosovo, 23 – 27 mars 2009* (Raport i Komisionerit të Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut), CommDH(2009)23, Strasbourg, 2 korrik 2009, shih https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1466279&Site=CommDH&BackColorInternet=FEC65B&BackColorIntanet=FEC65B&BackColorLogged=FFC679#P468_89578

¹³⁴ Misioni i OSBE-së në Kosovë është përgjegjës për monitorimi e të drejtave të njeriut dhe të çështjeve të shtetit ligjor në fushat që kanë lidhje me të drejtën për t'u kthyer, si të drejtat e banimit dhe të pronës, qasje pa diskriminim në shërbimet publike, dhe mundësitë për punësim, regjistrimi civil i anëtarëve të komuniteteve, siguria dhe liria e lëvizjes dhe qasja në drejtësi. Misioni i OSBE-së në Kosovë

Në një deklaratë publike më 7 korrik 2009, pas vizitës së tij në Kosovë, Walter Kälin, Përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut të Personave të Zhvendosur Brenda Vendit, u shpreh se: "Personat që u zhvendosën brenda vendit nga Kosova dhe brenda Kosovës, ende përballen me pengesa serioze ndaj kthimit dhe integritetit të tyre në vend ". Ai identifikoi "modele të rrënjësura të diskriminimit, mungesë të qasjes në punësim dhe mjete jetese, numrin shumë të paktë të shkollave për pakicat dhe vështirësitë për rimarrjen e pronave dhe për rindërtimin e shtëpive [janë] ndër pengesat kryesore ndaj kthimit".¹³⁵ Në raportin që vijoi pas vizitës së tij Walter Kälin theksoi, "[Indonëse] ende nuk janë vendosur masat të forta për t'u dhënë këtyre njerëzve perspektiva të vërteta integrimi dhe diskriminimi vazhdon të jetë i përhapur, qeveritë duhet të shmangin kthimin e detyruar të pakicave në Kosovë dhe të rregullojnë me ligj statusin e atyre që janë në vendet pritëse deri sa kushtet në Kosovë të lejojnë kthimin e tyre të sigurt."¹³⁶

Më 15 korrik, në një intervistë dhënë gazetës gjermane Frankfurter Rundschau, Thomas Hammarberg theksoi edhe një herë qëndrimin e tij, duke thënë: "Ajo që vendet tona duhet se e harrojnë është se refugjatët shumë shpejt do të kthehen përsëri në qoftë se nuk ka integrim në vendin e origjinës." Ai përsëri u bëri thirrje qeverive të BE-së që të mos kthejnë pakicat me forcë në Kosovë, duke u shprehur kështu: "Kosova ende nuk i ka kapacitetet për të ripranuar një numër të madh personash të kthyer".¹³⁷ Qëndrimi i Këshillit të Evropës më vonë u parashtrua edhe nga Komisioni i Ekspertëve për Romët dhe Nomadët i Këshillit të Evropës.¹³⁸

Në dhjetor 2009, Qendra për Dokumentim e Romëve dhe Ashkalinjve (QDRA, një OJQ vendore) botoi një raport, të mbështetur në intervistat e bëra me personat e kthyer, i cili përshkruante "rrethanat dhe kushtet e vështira të jetesës për personat RAE (romët,

gjithashtu nxit dhe monitoron zhvillimin e politikave dhe procedurave që kanë për qëllim krijimin e kushteve për një kthim të qëndrueshëm.

¹³⁵ Zyra e KB-së në Gjenevë, *Serious Obstacles Remain For Internally Displaced në Balkans, Warns United Nations Special Representative* (Vazhdon të ekzistojnë pengesa serioze për personat e zhvendosur brenda vendit në Ballkan, paralajmëron Përfaqësuesi i Posaçëm i Kombeve të Bashkuara), 7 korrik 2009,

http://www.unog.ch/unog/website/news_media.nsf/%28httpNewsByYear_en%29/B1F49E564CFE7319C12575EC00327CF5?OpenDocument

¹³⁶ Raport i Përfaqësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të [Kombeve të Bashkuara] mbi të drejtat e njeriut të personave të zhvendosur brenda vendit, Walter Kälin, A/HRC/13/21.Add.1, 11 dhjetor 2009.

¹³⁷ http://www.fr-online.de/in_und_ausland/politik/aktuell/1836888_Menschenrechtskommissar-Hammarberg-im-Interview-Endstation-Kosovo.html.

¹³⁸ SMG-S-ROM (2009)3, *Updated Opinion of MG-S-ROM on the Return of Roma to Kosovo and South Eastern Europe* (Opinion i përditësuar i MG-S-ROM për kthimin e romëve në Kosovë dhe në Evropën Juglindore; Tryezë e Rrumbullakët Ndërkombëtare për romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit e Kosovës: Sfidat dhe perspektiva të integritetit të qëndrueshëm); miratuar nga MG-S-ROM në mbledhjen e tij të 27-të në Sevilje, Spanjë, më 26-27 mars 2009; miratuar nga CDMG në mbledhjen e tij të 57-të në Strasbourg më 28-29 maj 2009. Komiteti i Zëvendës Ministrave e mbajti shënim këtë opinion të përditësuar në mbledhjen e tyre të 1062-të më 1 korrik 2009.

ashkalinjtë dhe egjiptasit) që janë kthyer” dhe identifikonte “mungesën e një sistemi të bashkërenduar mirë për ofrimin e një ndihme të qëndrueshme, e cila mund t'i përgjigjej më mirë problemeve të riatdhesimit”.¹³⁹

Po kështu, në dhjetor 2009, Thomas Hammarberg, Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, në një letër që i dërgonte Kancelarit të Gjermanisë, theksonte se Kosovës i mungon infrastruktura që do të lejonte riintegrimin e qëndrueshëm të refugjatëve: “Kthimi nuk është thjesht një akt teknik administrativ. Ai do të thotë që njerëzit, ndër ta edhe familjet, që kthehen, të priten dhe të riintegrohen me dinjitet dhe siguri. I kërkoj autoriteteve gjermane që të mos lejojnë kthime të tjera të detyruara në Kosovë, sidomos të romëve, për sa kohë që situata atje nuk garanton një jetë të sigurt dhe të qëndrueshme për të kthyerit.” I intervistuar pas kësaj nga mediumi gjerman Deutsche Welle në prill 2010 ai u shpreh se, “Një deportim i shpejtë nga vendet evropiane tani në Kosovë është papërgjegjshëm.”¹⁴⁰ Komisioneri shprehu shqetësime të ngjashme edhe në qershor 2010.¹⁴¹

Po kështu në prill 2010, Sekretari i Përgjithshëm i KB-së në raportin që i paraqiti Këshillit të Sigurimit për Misionin e KB-së në Kosovë, u shpreh: “Vazhdimi i kthimeve me forcë nga vendet pritëse mund të ketë ndikim negativ në aftësinë e autoriteteve të Kosovës për të mbështetur kthimet e qëndrueshme dhe mund të përkeqësojë tensionet ekzistuese”. Ai shtoi se vetëm 19 komuna kishin miratuar strategjitë e kthimit në vitin 2009, dhe se vetëm katër komuna në Kosovë “janë sot në procesin e hartimit të strategjive të tyre të kthimit për vitin 2010”.¹⁴²

“Përkritazi me procesin e riintegrimin të të kthyerve, nevojiten masa më të vendosura për t’iu përgjigjur shqetësimeve të tyre për sigurinë dhe duhet të bëhen përpjekje më të mëdha në fusha si punësimi, banimi, arsimit, dhe qasja në prona, për të siguruar kushtet e përshtatshme për kthime të sigurt dhe të qëndrueshme. Personat që i përkasin komuniteteve të pakicave, të cilët janë kthyer me forcë, janë në një gjendje veçanërisht të rrezikuar, duke pasur parasysht kushtet e vështira sociale dhe ekonomike në të cilat jetojnë, shpesh pa qasje në shërbimin shëndetësor dhe shërbimet sociale, punësim dhe arsim. Pavarësisht se përgjegjësinë për marrjen e vendimeve për zbatimin e kthimeve të detyruara i takon qeverive ose shteteve nga janë kthyer këta

¹³⁹ Qendra për Dokumentim e Romëve dhe Ashkalinjve, *Helplessness - Roma, Ashkalia and Egyptian Forced Returnees in Kosovo* (Pa shpresë – Romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit e kthyer me detyrim në Kosovë), 3 dhjetor 2009, <http://tinyurl.com/vidqo69>.

¹⁴⁰ The Commissioner - CommDH(2009)42, 15 dhjetor 2009, letër nga Komisioneri për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës zonjës Angela MERKEL, Kancelare e Republikës Federale të Gjermanisë, në lidhje me kthimet e detyruara në Kosovë, (25 nëntor 2009); “Council of Europe calls deporting refugees back to Kosovo irresponsible” (Këshilli i Evropës e quan deportimin e refugjatëve në Kosovë si të papërgjegjshëm), 15 prill 2010, www.dw-world.de/dw/Neni/0,,5469539,00.html

¹⁴¹ “Children victimised when families are forced to return” (Fëmijët viktimizohen kur kthehen familjet), 9 qershor 2010; http://commissioner.cws.coe.int/tiki-view_blog_post.php?postId=56

¹⁴² *Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo* (Raport i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë), S/2010/169, 6 prill 2010, paragrafi 25.

persona, autoritetet në Kosovë duhet t'u përgjigjen në mënyrë më rigorozë nevojave të personave në fjalë, duke pasur parasysh gjendjen e tyre të cenueshme.” Komiteti Këshillues për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, 31 maj 2010.¹⁴³

Këto shqetësime u pasqyruan edhe në një Rezolutë për Kosovën, të miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE) më 22 qershor 2010, e cila u bënte thirrje autoriteteve të Kosovës, ndër të tjera, që të “[krijojnë] kushtet sociale dhe ekonomike për integrimin e plotë të individëve nga komunitetet e pakicave në shoqëri, përfshirë edhe personat e zhvendosur dhe të kthyerit”.¹⁴⁴

Kohët e fundit, në korrik 2010, Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), ka botuar një raport i cili kritikon ashpër kthimet me forcë të fëmijëve romani nga Gjermania në Kosovë. Ky raport fokusohet si në mënyrën se si i kanë larguar këta fëmijë nga Gjermania, ashtu edhe në problemet që ata hasin në riintegrim, me një fokus të veçantë në qasjen e tyre në arsim.¹⁴⁵ Studimi konfirmon se autoritetet e Kosovës sot nuk janë në gjendje të sigurojnë banim, shërbim shëndetësor dhe shkollim të përshtatshëm për fëmijët e kthyer me forcë në Kosovë. Më shumë se 70 për qind e fëmijëve të intervistuar nga UNICEF-i nuk kishin shkuar në shkollë qysh prej kthimit të tyre të detyruar në Kosovë.

¹⁴³ Komiteti Këshillues për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Opinioni i Dytë për Kosovën, miratuar më 5 nëntor 2009, 31 maj 2010, ACFC/OP/II(2009)004, http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/3_FCNMdocs/PDF_2nd_OP_Kosovo_en.pdf.

¹⁴⁴ Botim i përkohshëm, Rezoluta 1739 (2010), *The situation in Kosovo and the role of the Council of Europe (Gjendja në Kosovë dhe roli i Këshillit të Evropës)*, paragrafi 14.4.3. <http://assembly.coe.int/Main.asp?link=/Documents/AdoptedText/ta10/ERES1739.htm>

¹⁴⁵ Verena Knaus & Peter Widmann, *Integration unter Vorbehalt: Zur Situation von Kindern kosovarischer Roma, Ashkali und Ägypter in Deutschland und nach ihrer Rückführung in den Kosovo* (Integrim me rezerva: Mbi gjendjen e fëmijëve kosovarë romë, ashkali dhe egjiptas në Gjermani dhe pas kthimit të tyre në Kosovë), UNICEF, korrik 2010.

7. KOSOVA DHE BE-JA

Në prill të vitit 2009 Jacques Barrot, zëvendës president i Komisionit Evropian (KE) shpalli publikisht se Kosova mund të përfshihej në procesin e liberalizimit të vizave, me kusht që Kosova të pranonte angazhimet që e shoqëronin atë.¹⁴⁶ Këto angazhime u parashtruan në Studimin e KE-së për Kosovën, tetor 2009, i cili bën të qartë “nevojën” e BE-së për të kthyer me forcë ish shtetasit jugosllave në shtetet e tyre të reja¹⁴⁷: “Një numër vendesh në rajon kanë bërë një përparim të konsiderueshëm në fushën e lirisë së lëvizjes. Në shkëmbim të marrëveshjeve të ripranimit, ata kanë mundur të përfitojnë nga marrëveshjet e lehtësimit të vizave me BE-në.”¹⁴⁸

Paragrafi vazhdon: “Qytetarët e Kosovës duhet të kenë më shumë pjesë në përfitimet që sjell përafrimi me BE-në, ndër të cilët edhe mundësia për të udhëtuar pa viza në BE. Kjo bëhet e mundur vetëm nëse Kosova mund të sigurojë zbatimin e reformave përkatëse dhe respektimin e rregulloreve dhe procedurave, në mënyrë që të minimizohen rreziqet për vendet anëtare të BE-së. Pika e fillimit për këto reforma është ekzistenca e marrëveshjeve funksionale të ripranimit. Kosova duhet të përshtatë legjislacionin e saj, të forcojë kapacitetet administrative për procedimin e kërkesave të ripranimit, dhe të vërë në zbatim një strategji efektive të riintegritimit. Ajo duhet gjithashtu të forcojë sigurinë e kufijve të saj dhe të sigurojë menaxhimin e regjistrave civilë dhe lëshimin e dokumenteve.”¹⁴⁹

Nën trysinë e BE-së, me premtimin e liberalizimit të vizave, Kosova ka rishikuar dhe ripunuar politikën e saj të ripranimit dhe strategjinë e riintegritimit. Në këtë kontekst, Amnesty International vëren se në të gjitha intervistat që ka bërë organizata me zyrtarë të Ministrisë së Brendshme përgjegjës për kthimet, këta vazhdimisht e diskutonin procesin e kthimit dhe të ripranimit në kontekstin e synimit të liberalizimit të vizave dhe aspiratave afatgjata të anëtarësimit në BE.

¹⁴⁶ “Kosovo Can Join Visa Liberalisation” (Kosova mund të përfshihet në liberalizimin e vizave), <http://www.balkaninsight.com/en/main/news/18516/>, 29 prill 2009.

¹⁴⁷ Pesë shtete anëtare të BE-së nuk e njohin Kosovën si shtet; po kështu ajo nuk njihet as nga KB-ja.

¹⁴⁸ COM(2009) 5343, , Communication from the Commission to the European Parliament and the Council, Kosovo - Fulfilling its European Perspective (Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, Kosova – Plotësimi i perspektivës së saj evropiane), 14 tetor 2009, paragrafi 6, f. 5 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/kosovo_study_en.pdf

¹⁴⁹ COM(2009) 5343, Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, Kosova – Plotësimi i perspektivës së saj evropiane, 14 tetor 2009, paragrafi 6, f. 5-6.

7.1 MARRËVESHJET E RIPRANIMIT¹⁵⁰

Siç është theksuar në të gjithë raportin, Amnesty International mendon se romët, ashkalinjtë dhe pakicat e tjera etnike nuk duhet të kthehen në Kosovë në kundërshtim me parimin e mos-kthimit mbrapsht (*non-refoulement*). Përveç kësaj, siç ka treguar raporti, Kosova sot për sot nuk është në gjendje të ofrojë kushtet për kthimin e qëndrueshëm dhe riintegrimin e personave nga komunitetet e pakicave dhe nga grupet e tjera të cenueshme.

Megjithatë, organizata është plotësisht e vetëdijshme se vendet anëtare të BE-së, dhe vende të tjera, kanë kthyer dhe po vazhdojnë të kthejnë me forcë shumë individë nga këto grupe nën ombrellën e marrëveshjeve dypalëshe të ripranimit me Kosovën. Nën dritën e kësaj, dhe ndërkohë që vazhdon të jetë kundër këtyre kthimeve të detyruara, Amnesty International rekomandon me forcë që në këto marrëveshje ripranimi të përfshihen standardet minimale, që ajo mendon se shtetet duhet t'i zbatojnë në kryerjen e kthimeve të detyruara.

Një Politikë paraprake e Ripranimit, e cila u nënshkrua midis Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ) dhe UNMIK-ut në vitin 2007, parashtronte procedurat për kthimin e personave “që e kanë origjinën nga Kosova dhe që jetojnë pa status ligjor në vendet pritëse”.¹⁵¹

Në fund të vitit 2008 Ministria e Brendshme e Kosovës, Departamenti për Menaxhimin e Kufijve dhe Migracion (sot Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion) ka marrë përsipër procedimin e ripranimeve. Ndryshe nga Memorandumet e Mirëkuptimit të nënshkruara midis UNMIK-ut dhe vendeve anëtare të BE-së, Politika e Ripranimit nuk vendos asnjë kufi në numrin e personave që mund të kthehen çdo vit, dhe as nuk përjashton kthimin e personave që i përkasin grupeve të pakicave etnike që në atë kohë konsideroheshin nga UNHCR-ja si persona që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.¹⁵²

¹⁵⁰ “Marrëveshjet e ripranimit ritheksojnë dhe përkufizojnë detyrimin që një vend të ripranojë qytetarët e vet dhe parashtrajnë kushtet sipas të cilave shtetet palë të këtyre marrëveshjeve janë të detyruara të ripranojnë qytetarë të shteteve të treta që kanë kaluar përmes territorit të tyre. Ato lehtësojnë dhe përshejtojnë zbatimin e vendimeve për kthimin e emigrantëve të parregullt dhe mund të shërbejnë edhe si një shtytës për vendet e origjinës, ose vendet transit, që të forcojnë kontrollin e tyre mbi migracionin. Në varësi të këndvështrimit, marrëveshjet e ripranimit mund të konsiderohen ose si një element i rëndësishëm në strategjitë e menaxhimit të migracionit të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, ose si lehtësuese e vendimeve të diskutueshme për kthimin e personave dhe pjesë e “eksternalizimit të kontrollit të migracionit” nga vendet evropiane, që është kritikuar mjaft.” APKE, Rezoluta 1741 (2010), *Readmission agreements: a mechanism for returning irregular migrants* (Marrëveshjet e ripranimit: një mekanizëm për kthimin e emigrantëve të parregullt), paragrafi 1, http://assembly.coe.int/ASP/Doc/ATListingDetails_E.asp?ATID=11211

¹⁵¹ UNMIK & IPVQ, Politika e Ripranimit, 28 nëntor 2007, www.unhcr.org/refworld/pdfid/49997afb1f.pdf

¹⁵² Mbështetur tek “Kërkesa për Ripranim e Kosovës: Për përdorim nga autoritetet qeveritare që kërkojnë riatdhesimin e personave nga Kosova pa status ligjor në territoret e tyre”. Shtetet që kërkojnë ripranimin e individëve në Kosovë nuk janë të detyruara të japin informacion nëse personat që do të kthehen me

NUMRI I TË KTHYERVE

Numri i përgjithshëm i personave që do të kthehen me detyrim sipas Marrëveshjeve të Ripranimit ende mbetet i paqartë. Burime të KB-së kanë sugjeruar se më shumë se 50 000 mund të kthehen me forcë, por Amnesty International nuk ka mundur ta verifikojë këtë informacion.¹⁵³ Vetëm në Gjermani, për shembull, pothuaj 10 000 romë kanë detyrimin ligjor që ta lëshojnë vendin pritës, duke qenë kështu nën rrezikun e kthimit me detyrim. Rreth 2 000 romë pritet të kthehen nga Zvicra.

Nuk dihet numri i saktë i personave tashmë të kthyer në Kosovë sipas këtyre Marrëveshjeve të Ripranimit. Disa vende i bëjnë publike numrat e personave të kthyer me detyrim, ndërsa disa të tjera jo, ose botojnë vetëm shifrat e përgjithshme të të gjitha deportimeve, pa bërë ndarje sipas vendit destinacion ose kombësisë së personit të kthyer.

Sipas Ministrisë së Brendshme të Kosovës, gjatë vitit 2009 janë kthyer afërsisht 4 067 persona përmes procedurës së ripranimit. Zyrtarët e ministrisë i thanë Amnesty International se nga 1 janari deri në 30 prill 2010 kishin marrë rreth 1 000 kërkesa për ripranime dhe se, deri në fillim të qershorit 2010, ishte vërtetuar identiteti dhe origjina e rreth 211 personave, gjë që bënte të mundur ripranimin e tyre; nga këta 135 ishin me kombësi shqiptare, 19 ashkali, dy egjiptas, 52 romë, dy serbë dhe një “tjetër”.¹⁵⁴

detyrim bëjnë pjesë në ndonjë prej kategorive të identifikuar nga UNHCR-ja si persona që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare të mëtejshme. Kjo mbështetet në paragrafin s. 4.1 të Marrëveshjes së Ripranimit midis UNMIK-ut dhe IPVQ-së, ku thuhet “IPVQ-ve të Kosovës dhe UNMIK-ut nuk do t’u jepet asnjë informacion për statusin e azilit të personit subjekt i ripranimit, në përputhje me standardet evropiane dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave në Kosovë dhe në vendet pritëse”. Për standardet rajonale, shih për shembull, Komiteti *ad hoc* i Ekspertëve për Aspektet Ligjore të Azilit Territorial, Refugjatët dhe Personat pa Shtetësi (Committee of Experts on the Legal Aspects of Territorial Asylum, Refugees dhe Stateless Persons - CAHAR), *Twenty guidelines on forced return* (Njëzet udhëzime për kthimin e detyruar), (CM (2005) 40 përfundimtar, 9 maj 2005). Amnesty International vëren se *Strategjia e Ripranimit* e ripunuar, është amenduar dhe thotë kështu: Vendet kërkuese duhet të japin sa më shumë informacion që është e mundur për numrin e personave që do të riatdhesohen, gjininë e tyre, origjinën etnike, grupmoshën, komunën e origjinës, të dhënat për të shkuarën kriminale, t’u japin atyre dokumente civile sidomos për fëmijët që kanë lindur në vendet kërkuese dhe për ata që ndjekin shkollën, etj., f. 5.

¹⁵³ Në mars 2007 Sekretari i Përgjithshëm i KB-së raportoi se rreth 3 598 persona ishin kthyer me detyrim në Kosovë në vitin 2006, dhe paralajmërim se rreth 90 000 persona mbeten “në pritje të deportimit në Kosovë”, S/2007/134, *Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Mission in Kosovo* (Raport i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë), 9 mars 2007.

¹⁵⁴ Pavarësisht nga kjo, sipas Bordit të Migracionit të Suedisë, nga janari deri në qershor 2010, Suedia ktheu 306 azil kërkuar të pasuksesshëm në Kosovë, 31 “me ndihmën e policisë”; ndër ta kishte romë dhe ashkalinj. Sipas Ministrisë së Brendshme të Kosovës, ndër personat e kthyer nga Suedia ishin edhe tre persona të mitur të pashoqëruar.

MARRËVESHJET E RIPRANIMIT ME VENDET ANËTARE TË BE-SË

Bisedimet për Marrëveshjet dypalëshe të ripranimit kanë filluar pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë nga ana e Kosovës në shkurt 2008 dhe transferimit të përgjegjësisë për kthimet nga Misioni i Përkohshëm Administrativ i KB-së në Kosovë (UNMIK) tek Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës. Këto marrëveshje bëjnë të mundur kthimin e detyruar të personave me origjinë nga Kosova (ose që mendohet se e kanë origjinën nga Kosova), të cilëve u është hequr statusi i përkohshëm i mbrojtjes ose leja e qëndrimit në këto vende. Këto kthime bëhen me kërkesën e shtetit kërkues dhe kryhen pasi Ministria e Brendshme e Kosovës konfirmon të drejtën e individit në fjalë për të pasur shtetësinë e Kosovës.

Deri më sot janë përfunduar (ose po përfundohen) marrëveshjet dypalëshe përkitazi me ripranimet e detyruara ose vullnetare midis qeverisë së Kosovës dhe vendet anëtare të BE-së, si me Austrinë,¹⁵⁵ Belgjikën (shih edhe kuadratin më poshtë),¹⁵⁶ Danimarkën, Francën,¹⁵⁷ Gjermaninë (shih edhe kuadratin më poshtë), Hungarinë, Holandën,¹⁵⁸ Suedinë dhe vende të tjera të BE-së, si dhe me Zvicrën¹⁵⁹ - e cila nuk është anëtare e BE-së. Po bëhen bisedime për marrëveshje të tjera me vende të tjera të BE-së.

¹⁵⁵ Në kohën e shkrimit të këtij raporti, Austria ende ishte në proces të negocimit të një marrëveshjeje ripranimi. Më 19 qershor 2009, në gazetën e përditshme *Die Presse*, Roland Schönbauer, zëdhënës i UNHCR-së në Austri, kritikoi vendimin e qeverisë austriake për t'i quajtur [Kosovën dhe Serbinë] si “vende të treta të sigurta” dhe vuri në dukje se romët dhe pakicat e tjera vazhdojnë të përballen me “situata të vështira të të drejtave të njeriut”, http://diepresse.com/home/politik/innenpolitik/488714/index.do?_vl_backlink=/home/politik/innenpolitik/index.do

¹⁵⁶ Rreth 70 shtetas të Kosovës janë deportuar nga Belgjika që nga nëntori i vitit 2009 - 25 prej të cilëve i kthyen në Kosovë mbi bazën e Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar me autoritetet e Kosovës më 20 tetor 2009, ndërsa 45 u deportuan në vende të tjera anëtare të BE-së sipas Rregullores Dublin II (Rregullore e Këshillit (KE) Nr 343/2003 e datës 18 shkurt 2003, që përcakton kriteret dhe mekanizmat për përcaktimin e Vendit Anëtar përgjegjës për marrjen në shqyrtim të një kërkesë për azil të bërë në një prej Vendeve Anëtare nga një shtetas i një vendi të tretë). Email i dërguar Amnesty International nga Ministria e Migracionit dhe Azilit, 26 gusht 2010.

¹⁵⁷ Marrëveshje e nënshkruar më 2 dhjetor 2009; ende nuk është ratifikuar.

¹⁵⁸ Në vitin 2009 u përfundua një marrëveshje me Holandën, që rezultoi në rifillimin e kthimeve të detyruara të pjesëtarëve të komuniteteve etnike. Ashtu si edhe marrëveshjet e tjera që i ka parë organizata, kjo marrëveshje nuk u kërkon autoriteteve holandeze që t'u japin autoriteteve të Kosovës detajet e etnicitetit të personit që do të kthehet. Kjo politikë u konfirmua nga Këshilli i Shtetit Holandez (gjykata më e lartë me juridiksion mbi çështjet e azilit) në rastin e padisë së ngritur nga një rom.

¹⁵⁹ Marrëveshje e nënshkruar më 3 shkurt 2010, Policia dhe Drejtësia Federale, “Marrëveshja e ripranimit e nënshkruar me Kosovën”, Njoftim për Shtyp (Medienmitteilungen, EJP, 03.02.2010, Eidgenössisches Justiz- und Polizeidepartement, “Rückübernahmeabkommen mit Kosovo unterzeichnet”, http://www.bfm.admin.ch/bfm/de/home/dokumentation/medienmitteilungen/2010/ref_2010-02-03.html. Sipas informacionit që ka marrë Amnesty International nga Zyra Federale e Migracionit, Marrëveshja e Ripranimit do të prekë konkretisht rreth 2 000 romë [shifrat e vitit 2009], që vazhdojnë të jenë në Zvicër, ose me qëndrim të përkohshëm, ose ata që janë në procesin e kërkimit të azilit. Romët që

BELGJIKA

Në shtator 2009 Amnesty International pati mundësinë të shqyrtonte një projekt marrëveshje midis Kosovës dhe autoriteteve të Belgjikës. Marrëveshja përfundimisht u nënshkrua më 20 tetor 2009. Ndonëse ajo mban titullin “Memorandum Mirëkuptimi midis Shërbimit të Brendshëm Publik Federal të Mbretërisë së Belgjikës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës”, Amnesty International mendon se kjo është një marrëveshje ripranimi që, me plot kuptimin e fjalës, ka të bëjë me kthimet e detyruara nga Belgjika në Kosovë. Organizata ia ka dorëzuar shqetësimet e veta për projekt marrëveshjen Zyrës për të Huajt (*Office des étrangers*) të qeverisë belge.

Amnesty International vazhdon të jetë e brengosur se teksti përfundimtar i marrëveshjes nuk përmban masa të mjaftueshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë, sidomos, mbrojtjen nga kthimi mbrapsht (*refoulement*). Për shembull, ndonëse përmend të drejtën bazë njerëzore që “të gjithë qytetarët të largohen dhe të shkojnë në vendin e tyre”, preambula nuk cek të drejtën për të kërkuar dhe për të gëzuar azil, ose forma të tjera të mbrojtjes ndërkombëtare. Më tej, ndonëse i referohet Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, dhe Konventën e Refugjatëve të vitit 1951, ajo nuk cek Protokollin e saj të vitit 1967; po kështu, as nuk i referohet parimit të ‘Moskthimit mbrapsht’ (*non-refoulement*) dhe lë krejtësisht pa cekur Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) dhe jurisprudencën e fushës nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, dhe sidomos Nenin 3 të saj.

Për më tepër, marrëveshja nuk cek aspak kategoritë e personave që UNHCR-ja i konsideron se përmbushin kushtet për mbrojtje të metutjeshme ndërkombëtare, ndër të cilët, për shembull, edhe romët. Po kështu, marrëveshja nuk siguron në mënyrë të shprehur qartë se askush nuk duhet të dërgohet me forcë në Kosovë kur është duke pritur një vendim përfundimtar nëse i plotëson kushtet apo jo për të pasur mbrojtje ndërkombëtare, qoftë për arsye azili, dhe/ose për arsye të tjera të të drejtave të njeriut. Për më tepër, marrëveshja nuk mishëron e as nuk cek ndonjë masë mbrojtëse që ndalon largimin me detyrim të personave që u është hequr statusi i përkohshëm i mbrojtjes; për shembull, ajo nuk thekson se çdo person, të cilit i është hequr statusi i mbrojtjes, ka të drejtë ta kundërshtojë largimin e vet, nëse dëshiron ta bëjë këtë, mbi baza të mbrojtjes ndërkombëtare, përfshirë të drejtën për azil dhe/ose arsye të tjera për mbrojtje dhe/ose arsye që lidhen me të drejta të tjera e njeriut. Nën dritën e sa më sipër, Amnesty International vazhdon të jetë e brengosur se, sipas kushteve të kësaj marrëveshjeje ripranimi (pra të memorandumit të mirëkuptimit midis Belgjikës dhe Kosovës), njerëzit që mund të plotësojnë kushtet për të pasur mbrojtje ndërkombëtare, ose largimi i të cilëve do të ishte i paligjshëm për shkaqe të tjera, sipas të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, mund të rrezikohen t’i kthejnë me detyrim në Kosovë, përfshirë edhe rastet që çojnë në ndonjë shkelje të parimit të moskthimit mbrapsht (*non-refoulement*).

Sipas informacionit që ka organizata, deri në 25 gusht 2010, 25 persona ishin kthyer në Kosovë në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit midis Belgjikës dhe Kosovës. Duke cituar mos-diskriminimin si arsye, autoritetet belge iu përgjigjën Amnesty International se statistikat e nxjerra nga *l'Office des étrangers* nuk specifikojnë origjinën etnike të personave të kthyer.

Sipas këtyre marrëveshjeve të ripranimit, çdo person me origjinë nga Kosova (ose që besohet se e ka origjinën nga Kosova), mund të kthehet. Amnesty International është e shqetësuar se

kthehen vullnetarisht do të marrin ndihmë financiare; kjo nuk u jepet ashkalinje dhe egjiptasve, që mendohet se kanë rrjete të mira sociale dhe mundësinë e kthimit në shtëpitë e tyre.

në mungesë të masave mbrojtëse për të mos lejuar kthimin me forcë të individëve dhe anëtarëve të grupeve të identifikuar nga UNHCR si grupe që plotësojnë kushtet për mbrojtje të mëtejshme ndërkombëtare, ekziston rreziku që këta persona të rrezikohen nga kthimi mbrapsht (*refoulement*).

Amnesty International mendon se marrëveshjet e ripranimit nuk i çlirojnë shtetet palë të këtyre marrëveshjeve nga detyrimet që burojnë prej së drejtës dhe standardeve ndërkombëtare humanitare, përfshirë edhe parimin e moskthimit mbrapsht (*non-refoulement*).

Pavarësisht nga detyrimet e përgjithshme për të drejtat e njeriut, të parashtruara, për shembull, në marrëveshjen e ripranimit midis Gjermanisë dhe Kosovës,¹⁶⁰ dhe detyrimi që shtetet t'i përmbahen plotësisht atyre obligimeve në kontekstin e zbatimit të marrëveshjeve të ripranimit, organizata rekomandon që këto marrëveshje duhet të kenë referenca të qarta të obligimeve që kanë palët kontraktuese për sa u përket të drejtave të njeriut, përfshirë, sidomos, vëzhgimin e plotë të parimit të moskthimit mbrapsht (*non-refoulement*).

Për më tepër, për të siguruar zbatimin e parimit të mos-kthimit mbrapsht dhe me të drejtën për të kërkuar dhe për të gëzuar mbrojtje ndërkombëtare, përfshirë edhe azilin, shtetet mund të pezullojnë çdo veprim zbatues që ndërmerret në bazë të një marrëveshjeje ripranimi, nëse individët në fjalë dëshirojnë të kundërshtojnë largimin e tyre mbi bazat e kërkimit të mbrojtjes ndërkombëtare, përfshirë edhe mbi baza të kërkimit të azilit dhe/ose të të drejtave të njeriut.

Këshilli i Evropës ka theksuar gjithashtu se marrëveshjet e ripranimit duhet të “marrin parasysh plotësisht të drejtat e njeriut” të personave që do të kthehen. Në një rezolutë të miratuar në qershor 2010, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE) vendosi se shtetet duhet të “përfshijnë në marrëveshjet e ripranimit një dispozitë që kërkon që, vendi kërkues, përpara se të kërkojë ripranimin nga një vend i tretë, të verifikojë se vendi i tretë do t'i japë personit në fjalë qasje në të drejtat minimale sociale [theksimi nga Amnesty International]. Nëse kjo nuk mund të verifikohet, ripranimi nuk duhet të kryhet dhe vendi kërkues duhet t'i japë personit në fjalë qasje në këto të drejta për sa kohë që ai ose ajo të qëndrojnë në atë vend.”¹⁶¹

¹⁶⁰ Në marrëveshjen e nënshkruar me Gjermaninë, Neni 15 parashikon se (1) zbatimi i Konventës së Refugjatëve mbetet i pacenuar, (2) detyrimet e palëve kontraktuese mbi bazën e konventave të tjera ndërkombëtare mbeten të pacenuara dhe (3) detyrimet e Gjermanisë, që rrjedhin nga anëtarësia e saj në BE mbeten të pacenuara, *Bekanntmachung des Abkommens zwischen der Regierung der Bundesrepublik Deutschland und der Regierung der Republik Kosovo über die Übernahme und Durchbeförderung von Personen (Rückübernahmeabkommen) vom 21. April 2010*, (Njoftim i Marrëveshjes midis Qeverisë së Republikës Federative të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për marrjen dhe tranzitimin e personave (Marrëveshja e Ripranimit). nga 21 prill 2010).

¹⁶¹ *Readmission agreements: a mechanism for returning irregular migrants* (Marrëveshjet e Ripranimit: një mekanizëm për kthimin e imigrantëve të parregullt), Rezolutë e APKE-s 1741 (2010), paragrafi 6.8, <http://assembly.coe.int/Main.asp?link=/Documents/AdoptedText/ta10/ERES1741.htm>

Amnesty International është e shqetësuar se mungesa e klauzolave që flasin shprehimisht për të drejtat e njeriut në marrëveshjet e ripranimit, kontribuon në krijimin e rrezikut që personat nga Kosova, që vazhdojnë të kenë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, (përfshirë edhe individët dhe pjesëtarët e grupeve të identifikuar nga UNHCR-ja si grupe që përmbushin kushtet për mbrojtje të mëtejshme ndërkombëtare), mund të largohen me detyrim nga vendet anëtare të BE-së dhe nga Zvicra, në kundërshtim me parimin e *non-refoulement*.¹⁶² Organizata vëren se barra e përgjegjesisë për sa i përket moslejimit të *refoulement* i takon shtetit dërgues.

SHEMBULLI I GJERMANISË

Kthime të detyruara në Kosovë kanë disa vite që po kryhen. Deri në vitin 2005 shumica e atyre që ktheheshin me detyrim ishin me kombësi shqiptare. Megjithatë, në përputhje me politikën e UNMIK-ut (e cila në përgjithësi i respektonte udhëzimet e UNHCR-së), Gjermania nuk i ka kthyer me forcë pjesëtarët e pakicave etnike, si romët, ashkalinjtë, egjiptasit dhe serbët. Memorandumi i Mirëkuptimit deri në mars të vitit 2003, dhe disa Shënime të Miratuara¹⁶³ të nënshkruara me UNMIK-un në qershor 2004, shtator 2004, prill 2005 dhe janar 2006, nuk lejonin kthimin me forcë të romëve dhe serbëve, me përjashtim të romëve që ishin dënuar për një vepër penale që nga korriku i vitit 2005. Për deportimin e ashkalinjve dhe egjiptasve marrëveshja u arrit nga maji i vitit 2005.¹⁶⁴

Memorandumi i Mirëkuptimit dhe Shënimet e Miratuara u shfuqizuan kur hyri në fuqi Politika e Ripranimit e qeverisë së Kosovës më 1 janar 2008. Megjithatë, me kërkesën e UNMIK-ut, kthimi me detyrim i romëve në përgjithësi ishte i ndaluar.¹⁶⁵ Gjermania filloi të kërkojë nga qeveria e Kosovës ripranimin e anëtarëve të pakicës romë pasi autoritetet e Kosovës morën kompetencat e mëparshme të UNMIK-ut për ripranimet, në nëntor 2008. Në vitin 2009, deportimet e romëve në Kosovë filluan gjatë bisedimeve për një Marrëveshje Dypalëshe Ripranimi me Kosovën, e cila u nënshkrua përfundimisht më 14 prill 2010 dhe hyri në fuqi më 1 shtator 2010.

¹⁶² Parimi i moskthimit mbrapsht (*non-refoulement*) ndalon dëbimin, heqjen, ekstradimit, deportimin ose çdo kthim tjetër të një personi në çfarëdo mënyre, në një vend ose territor ku ai ose ajo përballet me një rrezik real persekutimi ose lëndimi fizik. Ky parim përvijohet në Konventën e vitit 1951, që lidhet me Statusin e Refugjatëve (Konventa e KB-së) dhe në shumë instrumente të tjera ndërkombëtare. Përveç kësaj, parimi i moskthimit mbrapsht konsiderohet gjerësisht si një normë e së drejtës ndërkombëtare në përgjithësi.

¹⁶³ Një Memorandum Mirëkuptimi fillestar, që nga 17 nëntori i vitit 1999, lejonte kthimin me forcë të personave me kombësi shqiptare. Një memorandum i dytë, që hyri në fuqi më 31 mars 2003, lejonte kthimin e detyruar të personave turq, boshnjakë, gorani, dhe torbeshi dhe – pas një shqyrtimit të individualizuar – edhe ashkali dhe egjiptas. Kthimi i detyruar i ashkalinjve dhe egjiptasve ndaloj pas dhunës ndëretnike të marsit të vitit 2004, por rifilluan në maj 2005, mbi bazën e Shënimit të Miratuara të prillit 2005. Kushtet e Memorandumit të Mirëkuptimit u ndryshuan ose u përditësuan më vonë me anë të disa Shënimeve të tjera të Miratuara.

¹⁶⁴ Mbi bazat e Shënimeve të Miratuara të prillit 2005, numri i ashkalinjve dhe egjiptasve që do të ktheheshin ishte i kufizuar dhe vendimi për deportimin e tyre varej nga rezultati i një shqyrtimi individual.

¹⁶⁵ Qarkore e Ministrisë së Brendshme Federale, Ministrive të Landeve, dërguar më 17 dhjetor 2007.

Llogaritet se shumica e romëve nga Kosova kanë jetuar në Gjermani për më se 10 vjet. Një numër i panjohur i tyre përfituan nga një dispozitë ligjore që kishte hyrë në fuqi në gusht 2007. Sipas kësaj dispozite, personave që jetonin në Gjermani pa leje banimi, iu dha leja e banimit nëse plotësonin disa kritere të caktuara,¹⁶⁶ dhe nëse kishin jetuar në vend për më shumë se tetë vjet, ore pas gjashtë vjetësh, nëse kishin fëmijë. Megjithatë, sipas informacionit, vetëm një pakicë e vogël i plotësonte kushtet sipas kësaj politike.¹⁶⁷

Sipas statistikave qeveritare, më 30 qershor 2009 në Gjermani jetonin 12 539 pjesëtarë të grupeve të pakicave nga Kosova (ndër ta 9 842 romë), të cilët kishin detyrimin ligjor ta lëshonin vendin. Sipas UNICEF-it, rreth gjysma e këtyre romëve ishin në moshë të mitur.¹⁶⁸ Rreth 3 776 persona, grupi më i madh i romëve të Kosovës me leje të përkohshme qëndrimi, jetonin në zonën e Rhine-Westfalia-s së Veriut.

Në një letër të Ministrisë së Brendshme Federale, të datës 20 prill 2010, Amnesty International u informua se kthimi i detyruar i romëve do të bëhej "gradualisht" dhe se qeveria gjermane kishte rënë dakord me qeverinë e Kosovës të mos kërkonte ripranimin e më shumë se 2 500 personave në vit.

Në vitin 2009 Gjermania ktheu me detyrim 541 persona s në Kosovë, ndër ta 76 romë. Deri në 30 maj 2010 ishin kthyer me detyrim rreth 66 romë. Amnesty International është informuar nga OJQ-të, përfshirë edhe këshillat rajonale të refugjatëve, ndër personat e kthyer me detyrim kishte edhe njerëz me probleme shëndetësore.

Me sa ka dijeni Amnesty International, vetëm në një numër të vogël rastesh janë ndaluar deportimet me detyrim pas apeleve. Për shembull, në Göttingen në Saksoninë e Poshtme, në qershor 2010 gjykatat vendosën se në 17 raste romët nuk mund të ktheheshin me detyrim, përfshirë edhe për arsye të problemeve shëndetësore.¹⁶⁹

Vetëm në një Bundesland ka një politikë, që ka hyrë në fuqi në bazë të një dekreti të 27 majit 2010, të Ministrisë së Brendshme të Bundeslandit të Saxony-Anhalt (ku, deri më 30 qershor 2009, 362 romë ishin të detyruar ligjërisht të largoheshin), i cili parashikonte të drejtën e një vlerësimi të detyrueshëm individual për familjet e romëve të Kosovës dhe për gratë e pamartuara. Po kështu më 14 korrik 2010, qeveria e re në Rhine-

¹⁶⁶ Kriteret përshkruhen në Nenin 104a të Ligjit për Rezidencën (Aufenthaltsgesetz). Për shembull, personi në fjalë duhet të plotësojë kriteret kumulative si më poshtë: të jetë kryesisht në gjendje të kujdeset për mbijetesën e vet (dhe të familjes!) së vet pa u mbështetur në ndihma sociale, personi në fjalë duhet të ketë aftësi të mjaftueshme të përdorimit të gjuhës gjermane me gojë, duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme jetese, fëmijët duhet të plotësojnë obligimet e veta për të ndjekur shkollën, dhe personi në fjalë nuk duhet të ketë dënime të mëparshme penale (me disa përjashtime të rralla).

¹⁶⁷ UNICEF, *Integration unter Vorbehalt* (Integrim me rezerva), f. 32, marrë nga http://www.unicef.de/fileadmin/content_media/presse/Roma-Studie_2010/UNICEF-Studie_Roma_2010neu.pdf

¹⁶⁸ UNICEF, *Integration unter Vorbehalt* (Integrim me rezerva), f. 12.

¹⁶⁹ Shih edhe, Göttinger Tageblatt, "Drei jugendliche Roma flüchten ins Kirchenasyl", 22 qershor 2010, <http://www.goettinger-tageblatt.de/Nachrichten/Goettingen/Uebersicht/Drei-jugendliche-Roma-fluechten-ins-Kirchenasyl>

Westphalia-n e Veriut shpalli se do t'i rishikonte politikat e veta të kthimit të pakicave nga Kosova, për sa i takon mbrojtjes së familjeve dhe grave të pamartuara.¹⁷⁰

Të përballur me këtë mundësi të rritjes së numrit të kthimeve, në vitin 2009, 1 902 persona nga Kosova bënë kërkesa për azil, nga të cilat 1 400 ishin aplikime për herë të parë. Nga janari deri në maj 2010 ishin bërë rreth 855 aplikime, 605 prej tyre kërkesa për herë të parë. Sipas informacionit që i është vënë në dispozicion Amnesty International, shumica e tyre ishin kërkesa prej romëve të Kosovës. Në vitin 2009 vetëm në 0,6 për qind të vendimeve të marra nga Zyra Federale e Migracionit dhe Refugjatëve aplikantëve iu dha statusi i refugjatit, ndërsa rreth 4,2 për qind fituan mbrojtje dytësore.¹⁷¹ Statistikat për pesë muajt e parë të vitit 2010 tregojnë shifra të ngjashme.

¹⁷⁰ Më 15 korrik 2010, pas botimit të raportit të UNICEF-it (shih më lart) , disa anëtarë të partive qeverisëse paraqitën një mocion në parlamentin e Rhine-Westphalia-s së Veriut (RWV), ku kërkohet, ndër të tjera, që familjet nuk duhet të deportoheshin deri sa fëmijët të kishin mbaruar arsimin [e mesëm] ose arsimin profesional, *Entschließungsantrag: NRW wird der schwierigen Situation der Roma und anderer Minderheiten aus dem Kosovo Rechnung tragen* (Mocion: Shqyrtim nga RWV i situatës së vështirë të romëve dhe pakicave nga Kosova), Drucksache 15/45, 15 korrik 2010.

¹⁷¹ Përkufizuar në Nenet 15-19, të Direktivës së Këshillit të BE-së 2004/83/EC, të 29 prillit 2004, për standardet minimale për kualifikim dhe statusin e shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi si refugjatë ose si persona që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare për arsye të tjera dhe përmbajtja e mbrojtjes së dhënë (Direktiva e Kualifikimit e BE-së).

8. KTHIMET E DETYRUARA NË SERBI

Vendet Anëtare nuk duhet të krijojnë një zhvendosje të dytë duke i dërguar romët e Kosovës në pjesë të tjera të Evropës Juglindore, sidomos duke pasur parasysh burimet e kufizuara që janë në dispozicion aktualisht për integrimin e suksesshëm të personave të kthyer rishtazi. Kthime të reja në këtë rajon do të vinin në rrezik përpjekjet e autoriteteve të tanishme për integrimin e popullatës rome në vend, dhe azilkërkuesit romë të Kosovës dhe refugjatët që tashmë janë të pranishëm në territorin e tyre. Këshilli i Evropës, Opinion i përditësuar i MG-S-ROM për kthimin e romëve në Kosovë dhe në Evropën Juglindore, 1 korrik 2009.

Në shqyrtimin e saj të mundësisë së banimit diku tjetër në brenda vendit, ose të alternativës së banimit në Serbi, UNHCR-ja u shpreh në nëntor 2009 se “Dërgimi i serbëve të Kosovës për të banuar në Serbi, në disa raste mund të plotësojë kushtet e arsyeshmërisë, në varësi të rrethanave të tyre individuale. Kjo do të mund të bëhej nëse ata janë në gjendje të sigurojnë banim dhe të regjistrojnë zyrtarisht vendbanimin e tyre, kur kanë në Serbi anëtarë të familjes të cilët mund t’i ndihmojnë ose mbajnë, dhe/ose kanë aftësitë dhe kualifikimet që do t’u mundësonin gjetjen e një pune në tregun e tanishëm”. Por, sipas UNHCR-së, “Ndonëse qasja fizike dhe ligjore në Serbi është e mundshme dhe personat nga komunitetet serbe, rome, ashkali dhe egjiptase të Kosovës zakonisht nuk përballen me ndonjë rrezik persekutimi në Serbi, kthimi i tyre atje mund të mos i plotësojë kushtet e testit të arsyeshmërisë, sidomos në rastin e romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve”.¹⁷²

Më 1 janar 2008 hyri në fuqi marrëveshja e ripranimit midis Komunitetit Evropian dhe Serbisë.¹⁷³ Ajo parashtron kushtet për kthimin e detyruar në Serbi të personave që, ose janë me origjinë nga Serbia, ose kanë kaluar tranzit nëpër Serbi për të shkuar në vendet e BE-së. Mendohet se marrëveshja do të prekë nga 50 000 deri në 100 000 njerëz nga Serbia që banojnë në BE, ndër të cilët edhe azilkërkuesit e pasuksesshëm dhe refugjatët, shumica e të cilëve romë.

Shumë prej personave të kthyer në Serbi nga vendet anëtare të BE-së, sipas marrëveshjeve të ndryshme dypalëshe të nënshkruara përpara marrëveshjes së ripranimit të vitit 2008, e kishin origjinën nga Kosova. Sipas OJQ-së Grupa 484, për shembull, rreth 40 për qind e personave të kthyer në Serbi në vitin 2007 ishin me origjinë nga Kosova, shumica prej të cilëve romë; mbi 1000 persona ishin kthyer “vullnetarisht”, dhe rreth 600 të tjerë i kishin kthyer me detyrim; rreth 3 324 persona u kthyen në shtatë muajt e parë të vitit 2009.¹⁷⁴

¹⁷² UNHCR, *Kriteret Përzgjedhëse*, f. 22-23.

¹⁷³ 22007A1219(03), *Agreement between the European Community dhe the Republic of Serbia on the readmission of persons residing without authorisation* (Marrëveshje midis Komunitetit Evropian dhe Republikës së Serbisë për ripranimin e personave pa leje qëndrimi), Official Journal L 334 , 19/12/2007 F. 0046 – 0064, <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:22007A1219%2803%29:EN:HTML>

¹⁷⁴ Sipas Koordinatorit të Zyrës së Ripranimeve, Zoran Panjković, shumica ishin kthyer nga Gjermania (60 deri në 70 për qind) dhe nga Zvicra, dhe rreth 30 për qind të personave të kthyer nën moshën 18

Në një intervistë që ka bërë Amnesty International me Komisaratin Serb për Refugjatët në shkurt 2010, Zëvendës Komisioneri tha se Serbia nuk kishte as kapacitetet e as burimet për t'iu përgjigjur nevojave të riintegrit të personave që po ktheheshin. Me gjithë hartimin e një Strategjie për Riintegrimin e Personave të Kthyer mbi Bazën e Marrëveshjes së Ripranimit¹⁷⁵ Komisarati nuk i është caktuar ndonjë fond buxhetor nga qeveria për t'i mundësuar të ndihmojë personat e kthyer ose për të lehtësuar riintegrimin e tyre. Po kështu, Serbia ende nuk ka marrë ndonjë asistencë nga Komisioni Evropian në kornizën e procesit të para-anëtarësimit. Kështu, ndihma për personat e kthyer sipas marrëveshjes së ripranimit, jepet mbi baza *ad hoc*.¹⁷⁶ Kjo u konfirmua edhe nga intervistat me zyrën e UNHCR-së në Beograd, OJQ-të vendase dhe PZHBV-të romë.

Serbia ka më se 97 700 refugjatë nga Kroacia dhe Bosnje Hercegovina dhe 210 146 PZHBV serbë dhe romë nga Kosova (statistika të janarit 2010). Komisarati Serb i Refugjatëve nuk ka ndonjë mandat konkret për PZHBV-të, po kështu nuk ka asnjë përkufizim në ligj për PZHBV-të dhe se cilat janë detyrimet e shtetit për t'u dhënë atyre mbrojtje dhe asistencë. Kjo shkel Parimin 3 (2) 2, të Parimeve Udhëzuese të Kombeve të Bashkuara për Zhvendosjet Brenda Vendit, të cilat thonë, "Autoritetet shtetërore kanë detyrën dhe përgjegjësinë parësore për t'u ofruar mbrojtje dhe asistencë humanitare PZHBV-ve brenda juridiksionit të tyre".

Në praktikë, Komisarati Serb për Refugjatët pak ndihmë u jep PZHBV-ve ekzistues; ndihma konsiston në dhënien e kartave PZHBV dhe administrimin e një numri gjithnjë e më të vogël qendrash akomodimi kolektive, në gjendje gjithnjë e më të rrënuar.¹⁷⁷

Shumë romë që e kanë origjinën nga Serbia kthehen në situatë personash të zhvendosur; po kështu, është pothuaj krejtësisht e sigurt që edhe romët me origjinë nga Kosova, që kthehen në Serbi, do të gjenden në të njëjtat pozita. Në këto kushte, ekziston nevoja të vlerësohet nëse ata kanë të drejtën e mbrojtjes së mëtejshme ndërkombëtare, sepse gjasat janë që pasi të kthehen, ata do të jenë persona të zhvendosur brenda vendit (PZHBV). Për më tepër, PZHBV-të nga Kosova, të cilët janë kthyer nga vende të tjera në Serbi, nuk marrin karta të

vjeç. Rreth 67 për qind e personave të ripranuar ishin romë. *Glas javnosti*, 5 janar 2009 f. 6, *Politika* f. 7, *Press* f. 11, 5 janar 2009.

¹⁷⁵ http://www.kirs.gov.rs/docs/Readmission_strategy.pdf

¹⁷⁶ Intervistë e bërë nga Amnesty International me Ministrinë e të Drejtave të Njeriut dhe Pakicave dhe UNHCR-së, Beograd, shkurt 2009 dhe shkurt 2010; Grupa 484, *Raporti Vjetor 2008*, <http://www.grupa484.org.rs/index.php?lang=english>

¹⁷⁷ Amnesty International i pa këto qendra kolektive në Beograd në shkurt 2010. Në janar të vitit 2002, kishte 388 qendra kolektive ku banonin rreth 26 863 njerëz. Në janar 2010 kishte 60 qendra kolektive ku banonin 1 105 refugjatë dhe 3 792 persona të zhvendosur brenda vendit (përfshirë edhe 17 qendra kolektive ku strehoheshin 105 refugjatë dhe 558 PZHBV në zonat serbe të Kosovës), http://www.kirs.gov.rs/docs/The_condition_and_the_needs_of_IDPs_in_cc.pdf

PZHBV-ve, gjë që shpesh u sjell probleme për sa i takon qasjes në ndihma apo shërbime bazë, përfshirë shërbimin shëndetësor, asistencën sociale, punësimin dhe arsimin.¹⁷⁸

¹⁷⁸ Amnesty International ka nënvizuar kohët e fundit shqetësimet e saj për PZHBV-të romë nga Kosova në kontekstin e së drejtës për banim të përshtatshëm në raportin e saj, "Serbia: Ndaloni dëbimin me forcë të banorëve në vendbanimet romani", botuar në qershor 2010, <http://www.amnesty.org/en/library/info/EUR70/003/2010/en>

9. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Amnesty International mendon se tani për tani në Kosovë nuk ekzistojnë kushte të pranueshme për kthimin – të detyruar apo jo – të njerëzve që bëjnë pjesë në komunitetet e pakicave (ose ata që janë të cenueshëm për arsyet e cekura në këtë raport). Organizata nuk mendon se kushtet në terren në Kosovë kanë ndryshuar aq sa duhet për të krijuar ndryshim themelor (të madh, të thellë dhe të qëndrueshëm) dhe afatgjatë të rrethanave. Gjendja tani dhe në periudhën afatgjatë është e paqëndrueshme dhe e pasigurt.

Nën dritën e kësaj, Amnesty International mendon se ekziston nevoja e një mbrojtjeje të mëtutjeshme ndërkombëtare, ndër të tjerë, për romët, ashkalinjtë, egjiptasit, serbët dhe shqiptarët (kur këta kthehen në një situatë ku përbëjnë pakicë) dhe individët e tjerë të cenueshëm.

Vendimet e vendeve anëtare të BE-së dh Zvicrës për t'u hequr ose për të ndërprerë në ndonjë mënyrë tjetër mbrojtjen ndërkombëtare për romët dhe pakicat e tjera, janë të parakohshme dhe kthimi i tyre me detyrim mund të përbëjë shkelje të parimit të moskthimit mbrapsht (*non-refoulement*).

Për më tepër, Amnesty International mendon se autoritetet kosovare sot për sot nuk i kanë kapacitetet, vullnetin politik dhe burimet për të siguruar riintegrimin dhe kthimin e qëndrueshëm të individëve nga komunitetet e pakicave ose ata që janë të cenueshëm për arsye të tjera.

Përpos kësaj, personave që janë objekt i kthimeve të detyruara u mohohet asistenca dhe përkrahja që u jepet të kthyerve vullnetarë nga Ministria për Kthim dhe Komunitete, UNHCR-ja dhe partnerët e tyre. Përveç kësaj, në mungesë të masave për të siguruar riintegrimin e tyre në Kosovë, të kthyerit me detyrim mund të pësojnë shkelje të tjera të të drejtave të tyre, përfshirë edhe mohimin e të drejtave të tyre sociale dhe ekonomike.¹⁷⁹

Amnesty International është e mendimit se, të gjithë ata që kthehen me detyrim – pasi një shqyrtimi të duhur dhe të plotë të të gjitha kërkesave të tyre – kanë të drejtën të kthehen në siguri dhe me dinjitet, dhe duke iu respektuar të drejtat e tyre të njeriut. Edhe ata duhet të kenë të drejtën e një kthimi të qëndrueshëm dhe duhet të kenë qasje në asistencën që u siguron të drejtat e tyre ekonomike dhe sociale.

Për këto arsye Amnesty International u bën thirrje vendeve anëtare të BE-së dhe çdo vendi tjetër që ka ndërmend të kthejë njerëz në Kosovë që:

- Menjëherë të heqin dorë nga kthimi i detyruar i të gjithë personave nga komunitetet e pakicave – sidomos të serbëve dhe romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve, (dhe shqiptarëve në situata ku ata përbëjnë pakicë) në Kosovë, duke pasur parasysh që gjasat janë se ata mund të pësojnë persekutim ose lëndim serioz kur të kthehen; t'u japin atyre mbrojtje të mëtejshme ndërkombëtare (ose përmes dhënies së azilit ose përmes një mbrojtjeje dytësore, sipas rastit konkret);
- Të sigurojnë që të gjithë personat të cilët kanë ndërmend t'i kthejnë në Kosovë, të kenë qasje në një procedurë të shpejtë, të drejtë dhe efektive për të përcaktuar nëse i plotësojnë ose jo kushtet për mbrojtje të mëtejshme ndërkombëtare, përfshirë edhe mbi bazat e kërkesës për azil. Individët në fjalë duhet gjithashtu të kenë të drejtën të kundërshtojnë vendimet për deportim edhe mbi bazën e të drejtave të tyre të njeriut – përveç kërkesës mbi baza të mbrojtjes ndërkombëtare, nëse e dëshirojnë një gjë të tillë. Çdo kundërshtim (me anë të një procedure gjyqësore) ndaj deportimit duhet të ketë efekt pezullues dhe personave në fjalë duhet t'u jepet asistencë ligjore dhe të kenë përfaqësim ligjor në proces.
- Përveç kësaj, nevojat për mbrojtje ndërkombëtare të partnerëve/fëmijëve në martesë të përziera; të personave të asociuar me autoritetet serbe deri në vitin 1999; viktimave të trafikimit dhe të dhunës në familje; viktimave të shkeljeve të së drejtës humanitare ndërkombëtare; dhe të atyre me sëmundje kronike që nuk mund të trajtohen në Kosovë, duhet të shqyrtohen në mënyrë individuale dhe me shumë kujdes, nën dritën e faktit se, pasi të kthehen, ata mund të përballen me persekutim, përfshirë edhe përmes diskriminimit kumulativ, ose me lëndim serioz. Çdo nevojë e mëtejshme për mbrojtje duhet të shqyrtohet dhe vlerësohet qartë, me qëllim që të jetë në përputhje me parimin e moskthimit mbrapsht (non-refoulement).
- Asnjë person që rrezikohet të mbetet pa shtetësi *de facto* ose *de jure* nuk duhet të kthehet në Kosovë. Plotësimi i kritereve për mbrojtje ndërkombëtare nga ana e tyre duhet të shqyrtohet me kujdes;
- Nëse ka persona që, pas një procedure të drejtë dhe efektive për përcaktimin e të drejtës për azil, mendohet se nuk kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe kur këtyre personave u ka përfunduar afati i mbrojtjes së përkohshme, kthimi i tyre i detyruar duhet të bëhet vetëm në një mënyrë që respekton të drejtat e tyre, në siguri dhe me dinjitet;
- Të sigurojnë se ata persona, të cilët po mendojnë t'i kthejnë në Kosovë, të lajmërohen paraprakisht dhe t'u jepet kohë dhe informacion për të drejtën e tyre për ta kundërshtuar largimin;
- Të rishikojnë marrëveshjet ekzistuese dypalëshe të ripranimit me Kosovën, për të siguruar që ato të jenë në përputhje me të drejtën dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, sidomos për sa i përket nevojave për mbrojtje të mëtejshme ndërkombëtare dhe të sigurojnë se të klauzolat e të drejtave të njeriut janë përfshirë në mënyrë të hapur e të qartë në këto marrëveshje;
- Të mos marrin masa që mund të dëmtojnë pëlqimin që qëndron në themel të çdo vendimi për kthim. Shtetet duhet të jenë të kujdesshme të sigurojnë që kthimi të jetë vërtet vullnetar – dhe i bërë mbi bazat e një pëlqimi të informuar dhe të vërtetë;

- UNHCR-ja dhe parterët e saj zbatues duhet të vazhdojnë të lehtësojnë kthimin vullnetar të atyre anëtarëve të komuniteteve të pakicave që duan të kthehen në shtëpinë e tyre.

Amnesty International gjithashtu u bën thirrje Komisionit Evropian dhe vendeve anëtare të BE-së që:

- T'u japin autoriteteve Kosovare të gjithë asistencën e nevojshme, përfshirë edhe asistencën financiare, që të sigurojnë zbatimin e plotë të strategjisë së kthimit dhe riintegrit;
- Të marrin masa që personat nga pakicat dhe nga grupe të tjera të cënueshme të mos kthehen me detyrim në Kosovë, përpara se të jenë krijuar kushtet për kthimin e tyre vullnetar dhe integrimin e tyre në siguri dhe me dinjitet.

Amnesty International i bën thirrje qeverisë së Kosovës që:

- Të marrë masa të menjëhershme që sigurojë se në të gjitha pikat kufitare, përfshirë edhe në Aeroportin e Prishtinës (Sllatinë) të ekzistojnë lehtësitë e duhura të pritjes për personat e kthyer me detyrim në Kosovë, në mënyrë që këta të jenë plotësisht të informuar për të drejtën e tyre për të marrë ndihmë gjatë riintegrit në Kosovë; të marrë masa për të siguruar monitorimin e progresit të riintegrit të të gjithë personave të kthyer, për të siguruar që ata të kenë të gjithë mbështetjen e duhur në sigurimin e qasjes në dokumente dhe të drejta të tjera bazë;
- Të marrë masa për të plotësuar obligimet e saj ndaj personave të kthyer, duke siguruar që të gjitha ministritë relevante të kenë kapacitetin dhe burimet e nevojshme për zbatimin e Strategjisë së vitit 2010 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, duke siguruar krijimin e kushteve për kthimin e qëndrueshëm të komuniteteve të pakicave në siguri dhe me dinjitet;
- Të ofrojë një mbështetje më të madhe për riintegrimin e personave të kthyer në nivelin e komunave dhe për qasje pa diskriminim në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, si punësimi, shërbimi shëndetësor dhe shërbimet sociale, arsim dhe banim të përshtatshëm;
- Të zbatojë pa vonesë të mëtejshme Planin e Veprimit të vitit 2010 për Strategjinë për Integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptase, si dhe të sigurojë fondet e nevojshme dhe burimet e tjera për zbatimin e tij;
- Të marrë masa që asnjë person me origjinë nga Kosova i kthyer me detyrim, të mos jetë në rrezik të mbetet pa shtetësi.



**DËSHIROJ
TË NDIHMOJ**

QOFTË NË NJË KONFLIKT TË NJOHUR APO
NË NJË QOSHE TË HUMBUR TË GLOBIT,
AMNESTY INTERNATIONAL ZHVILLON
FUSHATA PËR DREJTËSI, LIRI DHE
DINJITET PËR TË GJITHË DHE SYNON TË
GALVANIZOJË MBËSHTETJEN E PUBLIKUT
PËR NDËRTIMIN E NJË BOTE MË TË MIRË

ÇFARË MUND TË BËNI JU?

Aktivistët anekënd botës kanë demonstruar se është e mundur t'i rezistohet forcave të rrezikshme që dëmtojnë të drejtat e njeriut. Bëhuni pjesë e kësaj lëvizjeje. Luftoni ata që nxisin frikë dhe urrejtje.

- Bashkohuni me Amnesty International dhe bëhuni pjesë e një lëvizje mbarëbotërore që zhvillon një fushatë për t'i dhënë fund dhunimeve të të drejtave të njeriut. Na ndihmoni të kemi rezultat.
- Dhuroni për të mbështetur veprimtarinë e Amnesty International.

Së bashku mund t'ia dalim të na dëgjohet zëri.

Jam i/e interesuar të marr informacion të mëtejshëm për t'u bërë anëtar/e i/e Amnesty International.

Emri

Adresa

Shteti

adresa e postës elektronike (e-mail)

Dëshiroj t'i dhuroj Amnesty International (dhurimet pranohen në UK£, US\$ apo €)

Shuma

ju lutem debitoni

Visa

Mastercard

Numri

data e skadimit të afatit

Nënshkrimi

Ju lutem dorëzoni këtë formë zyrës së Amnesty International në vendin tuaj.
Për zyrat e Amnesty International nëpër botë, vizitoni: www.amnesty.org/en/worldwide-sites

Nëse në vendin tuaj nuk ka zyrë të Amnesty International, ju lutem dërgojeni këtë formular me postë në adresën:

Amnesty International, International Secretariat, Peter Benenson House,
1 Easton Street, London WC1X 0DW, United Kingdom

www.amnesty.org





ASKUND TË MIRËPRITUR NDALONI KTHIMIN ME FORCË TË ROMËVE NË KOSOVË

Një numër gjithnjë e më i madh romësh dhe anëtarësh të komuniteteve të tjera të pakicës po kthehen me forcë në Kosovë nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE), në kundërshtim me rekomandimet e Agjencisë për Refugjatët të Kombeve të Bashkuara për përfshirjen e tyre në kategoritë që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. Në Kosovë nuk ekzistojnë ende kushtet për një kthim të sigurt dhe të qëndrueshëm të romëve, ashkalive, serbëve dhe shqiptarëve, që kthehen në situata ku ata përbëjnë pakicë, përfshirë edhe për shkak të diskriminimit kumulativ që përbën persekutim.

Amnesty International i konsideron vendimet e vendeve të BE-së për të hequr mbrojtjen ndërkombëtare, si të parakohshme, dhe që mund t'i bëjnë romët dhe individët e tjerë të cenueshëm, të rrezikohen nga persekutimi ose ndonjë lëndim tjetër serioz, ose të rrezikohen të mbeten pa shtetësi.

Ky raport dokumenton diskriminimin e vazhdueshëm dhe shkeljet kumulative të të drejtave të njeriut që përjetohej nga Romët dhe pakicat e tjera të kthyera, përfshirë edhe faktin që autoritetet e Kosovës nuk u sigurojnë të kthyerve me forcë mundësinë për të pasur dokumentacion dhe nuk u garantojnë atyre të drejtën për arsim, përkujdes shëndetësor, punësim dhe strehim.

Amnesty International u bën thirrje vendeve anëtare të BE-së dhe Zvicrës që të mos bëjnë kthime me forcë, deri sa të ketë një ndryshim themelor dhe të qëndrueshëm të rrethanave për romët dhe pakicat e tjera. Amnesty International gjithashtu i bën thirrje qeverisë së Kosovës të garantojë të drejtat e komuniteteve të pakicave dhe të zbatojë plotësisht masat që mundësojnë kthimin e qëndrueshëm dhe ri-integrimin e të kthyerve nga komunitetet e pakicave – në mënyrë që ata të mund të kthehen në Kosovë vullnetarisht, të sigurt dhe me dinjitet.

www.amnesty.org

Indeks: EUR 70/011/2010
Shtator 2010

AMNESTY
INTERNATIONAL

